




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI QARKUT SHKODËR**

RAPORT

Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2025

MIRATON

PREFEKTI  
Holta DUDA





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**PREFEKTI QARKUT SHKODËR**


Qëllimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2025, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kërkesat e Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*” i ndryshuar.

**Hartuar nga:** Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara  
**Adresa:** Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel /faks. 0035522242705, e-mail:prefekti.shkoder@mb.gov.al

Shkodër, Shkurt 2026



*Misioni i Prefektit është garantimi i zbatimit, në nivel qarku, të programit politik të Këshillit të Ministrave, i cili synon një rritje të qëndrueshme ekonomike, me rezultate konkrete në punësim dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, duke u mbështetur në forcimin e stabilitetit makroekonomik si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm.*



**Qarku i Shkodrës** ka një popullsi prej **348,631 banorë**, i ndarë administrativisht në **5 - Bashki, 32 – Njësi Administrative** dhe **272 - fshatra**, me një sipërfaqe totale rreth **3.562km<sup>2</sup>**

Bashkia Shkodër	(215,262 banorë)	<b>11 - NJA. 92-fshatra</b>
Bashkia Malësi e Madhe	(56,098 banorë)	<b>6 - NJA. 56-fshatra</b>
Bashkia Vau Dejës	(52,675 banorë)	<b>5 - NJA. 48-fshatra</b>
Bashkia Vau Pukë	(14,123 banorë)	<b>5 - NJA. 41-fshatra</b>
Bashkia Fushë Arrëz	(10,473 banorë)	<b>5 - NJA. 35-fshatra</b>

- Dendësia e popullsisë është mesatarisht rreth **60 banorë/km<sup>2</sup>**.
- Struktura gjinore është relativisht e balancuar, me përqindje të ngjashme meshkujsh dhe femrash.
- Të dhënat e mëparshme tregojnë se popullsia e qarkut ka pasur rënie në disa periudha, për shkak të emigracionit dhe lëvizjeve të brendshme demografike

# Përmbajtja

<b>I.</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>II.</b>	<b>PËRMBLEDHJE.....</b>	<b>8</b>
<b>III.</b>	<b>REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË .....</b>	<b>14</b>
III.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave .....	14
III.1.a.	Njësitë e vetëqeverisjes vendore .....	14
III.1.b.	Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore) .....	15
III.2.	Realizimi i Investimeve .....	15
III.2.a.	Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.....	15
III.2.b.	Investime me fondet e qeverisë nga FShZh .....	16
III.2.c.	Investime nga ARRSH.....	17
III.2.d.	Investimet në proces realizimi .....	17
<b>IV.</b>	<b>MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor).....</b>	<b>18</b>
IV.1.	INSTITUCIONET QENDRORE NË NIVEL VENDOR DHE VEPRIMTARIA E TYRE.....	19
IV.1.1.	Drejtoria Tatimore Rajonale dhe Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Verior).....	19
IV.1.2.	Dega e Doganës Shkodër.....	20
IV.1.3.	Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore.....	20
IV.1.4.	Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit .....	21
IV.1.5.	Drejtoria e Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive .....	23
IV.1.6.	Drejtoria Rajonale e Ofritit Formimit Profesional Publik.....	24
IV.1.7.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (Seksioni i Ekstensionit Bujqësor Shkodër).....	25
IV.1.8.	Drejtoria e ujitjes dhe kullimit Lezhë (Sektori Shkodër) .....	26
IV.1.9.	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bune.....	27
IV.1.10.	Administrata e Zonave të Mbrojtura .....	30
IV.1.11.	Arsimi .....	31
IV.1.12.	Shërbimi Shëndetësor .....	37
IV.1.13.	Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.....	38
IV.1.14.	Dega Rajonale e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor .....	39
IV.1.15.	Drejtoria Rajonale e IKMT .....	39

IV.2	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim .....	41
IV.3.	Grupet ndërinstitucionale të punës (task-forcat) .....	43
IV.3.1.	Task Forca Vendore Antikanabis.....	43
IV.3.2.	Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave .....	47
IV.3.3.	Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.....	48
IV.3.4.	Këshilli Vendorë i Sigurisë Publike dhe Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal .....	50
IV.4.	Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat .....	54
<b>V.</b>	<b>MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE .....</b>	<b>56</b>
V.1.	Kyerja e funksioneve të transferuara njësisive të vetëqeverisjes vendore.....	57
V.2.	Për verifikimin e ligjshmerisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore 2025 .....	65
V.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor68	
<b>VI.</b>	<b>FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE.....</b>	<b>69</b>
VI.1.	Shërbimet sociale.....	69
VI.2.	Zhvillimi i territorit.....	70
VI.3.	Zhvillimi i turizmit (sezoni turistik Maj-Nëntor).....	71
VI.4.	Shërbimi i gjendjes civile .....	80
<b>VII.</b>	<b>ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS .....</b>	<b>80</b>
VII.1.	Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë .....	80
VII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	82
VII.3.	Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	82
VII.4.	Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	83
VII.5.	Veprimtaria e N/Prefektit .....	84
<b>VIII.</b>	<b>VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT .....</b>	<b>84</b>
<b>IX.</b>	<b>OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026.....</b>	<b>85</b>
<b>X.</b>	<b>BAZA LIGJORE .....</b>	<b>86</b>

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër gjatë vitit 2025

#### I. HYRJE

Raporti paraqet në mënyrë të përmblëdhur dhe të qartë veprimtarinë e institucionit dhe rezultatet e arritura, duke reflektuar angazhimin për respektimin e standardeve të profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe transparencës në administratën publike.

Në përmbajtjen e tij pasqyrohet niveli i zbatimit të detyrave dhe objektivave të përcaktuara në programin qeveritar, si dhe planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga strukturat e vetëqeverisjes vendore, përfshirë Këshillin e Qarkut dhe Bashkitë, si edhe nga institucionet qendrore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në nivel vendor.

Dokumenti vlerëson performancën institucionale përmes analizës së treguesve kryesorë të veprimtarisë, duke evidentuar bashkëpunimin dhe ndërveprimin e Prefektit me organet qendrore dhe rajonale, si dhe marrëdhëniet me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Njëkohësisht, theksohet roli koordinues i Prefektit në realizimin e funksioneve të deleguara dhe në ushtrimin e kontrollit të ligjshmërisë mbi aktet normative të nxjerra nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar masave të rmarra në funksion të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, duke përfshirë masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e kultivimit të bimëve narkotike, si dhe veprimtaritë për parandalimin dhe adresimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Raporti përmban gjithashtu rekomandime konkrete për forcimin e mëtejshëm të praktikave institucionale në këto fusha.

Raporti trajton gjithashtu zbatimin e funksioneve të deleguara nga institucionet qendrore te njësitë e vetëqeverisjes vendore, si Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri, administrimi i pyjeve, sistemi i ujitjes dhe kullimit, menaxhimi i rrjetit të rrugëve rurale dhe sistemi i arsimit parashkollor. Rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit të turizmit, menaxhimit të emergjencave civile dhe përmeshjes së përgjegjësive të deleguara nga autoritetet qendrore.

Në përmbajtje përfshihet gjithashtu shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, analizimi i urdhrave të nxjerra nga Prefekti dhe niveli i zbatimit të tyre, si dhe përfundimet e nxjerra nga analizat vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor.

Për hartimin e këtij raporti janë shfrytëzuar burime të brendshme institucionale, të dhëna të mbledhura nga proceset e monitorimit, si dhe informacionet e siguruar nga institucionet vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## II. PËRMBLEDHJE

- Sezoni turistik ka pasur një rol vendimtar në nxitjen e rritjes ekonomike, veçanërisht në qarkun Shkodër, ku është shënuar një sukses i dukshëm. Ky sukses vjen si rezultat i masave të ndërmarra nga qeveria për investime publike, përmirësimin e shërbimeve në destinacionet turistike. Po ashtu, janë forcuar bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve vendore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, nën drejtimin e Prefektit të Qarkut, duke përmirësuar profesionalizmin dhe përgjegjshmërinë e administratës publike.
- Prefekti i Qarkut ka luajtur një rol kyç në koordinimin e punës së institucioneve dhe njësive vendore, për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe përmbushjen e misionit të tyre. Disa prej veprimtarive të realizuara përfshijnë:
  - Takime periodike dhe të posaçme për të analizuar sfidat dhe për të përcaktuar zgjidhje konkrete në fusha të ndryshme, si menaxhimi i mbetjeve, funksionimi i tregjeve dhe mbrojtja e pyjeve.
  - Aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut dhe forcimin e masave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, luftën kundër trafikimit të personave, sigurinë publike dhe rendin.
  - Monitorimi i sezonit turistik dhe përballimi i situatave emergjente, si përmbytjet, zjarret dhe reshjet e dendura.
  - Mbështetja për fillimin e vitit shkollor, duke siguruar kushte të përshtatshme, si ngrohja dhe siguria në shkolla.
  - Takime me drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes dhe institucioneve vendore për të siguruar zbatimin e detyrave të përbashkëta dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Nga ana e Prefektit në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve ligjore, sipas kompetencave dhe fushave të përgjegjësisë.
- Janë organizuar takime të vazhdueshme periodike dhe sipas rasteve, për analizimin e veprimtarisë, problemeve të hasura, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e detyrave të ngarkuara, duke përcaktuar dhe marrjen e masave, për zgjidhjen e tyre (*Menaxhimi i mbetjeve, Funksionimi i tregjeve; Dëmtimet në pyje, etj*) Janë organizuar takime, lidhur me analizimin dhe ecurinë e zbatimit të detyrave, siç është rasti i takimeve të vazhdueshme për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në parandalimin dhe eliminimin e kultivimit të bimëve narkotike; Në Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Për çështjet e rendit dhe sigurisë publike; Për mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën emergjente të krijuar nga reshjet, përmbytjet, zjarret; Për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në sistemin arsimor parauniversitar, përfshi sigurimin e ngrohjes në shkolla; Mbi “Paketën e Sigurisë” në shkolla; etj.
- Janë organizuar, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore takime me drejtues të ketyre

njësive dhe të institucioneve vendore, për zbatimin e detyrave të përbashkëta.

- Janë organizuar takime në institucionet vendore (Degët Territoriale), lidhur veprimtarinë e ushtruar, gjatë periudhave të ndryshme të vitit, duke u përqendruar tek institucionet e ofrimit të shërbimeve dhe inspektoratet shtetërore.

- *Të ardhurat e realizuara në nivel qarku*

Për vitin 2025 janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 9,811,037 mijë lekë, ose 99,8 % e të ardhurave të programuara. Në vitin 2024, DRT ka realizuar të ardhura në vlerën 8,808,964 mijë lekë. Në qoftë se bëjmë një krahasim me këtë vit, shohim se të ardhurat janë rritur me vlerën 1,002,073 mijë lekë ndërsa shprehur në realizim plani kemi rënie me 2.2% nga viti 2024.

Të ardhurat e realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2025 kanë arritur në vlerën **1,614,938** mijë lekë, që përfaqëson **93.8%** të të ardhurave të programuara, duke rezultuar në një mosrealizim prej **105,630** mijë lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, kur të ardhurat e realizuara ishin 1,329,773 mijë lekë, vihet re një rritje në vlerë arkëtimesh prej 285,162 mijë lekë ndërsa shikuar në raport me parashikimin kemi një rënie në realizim të planit krahasuar me vitin 2024 që ishte 96%.

- *Investimet*

Në bashkitë e qarkut Shkodër, janë kryer investime nëpërmjet FSHZH ku ndër projektet prioritare të qarkut Shkodër të cilat janë në vazhdim mund të përmendim: Ndërhyrje në hyrje të Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perendimor të Liqenit të Shkodrës (Faza I) me vlerë 478,819 mijë lekë. Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë – Zogaj-Kufi me Malin e Zi dhe rikonstruksioni i ujësjellësit të Shirokës me vlerë 514,273 mijë lekë, Investime për infrastrukturën e tregjeve dhe hapësirave tregtare, multifunkionale në zona model zhvillimi "Zdrallë-Rijetëzimi urban i Pazarit të Shkodrës, Lot A – Rr.Hamz Kazazi me vlerë 328,361 mijë lekë. Transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional në bashkinë Shkodër me vlerë 639,062 mijë lekë. Site natyrore, ndërtimi i hyrjes së Liqenit të Shkodrës, Faza 2, Parku i Ligatinave me vlerë 564,960 mijë lekë. Zhvillimi i potencialit turistik, Muzeu i navigimit Shkodër me vlerë 271,153 mijë lekë, Rikonstruksioni dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën turistike të Velipojës, Shkodër (Rruga Pulaj-Ura e Bunës) me vlerë 226,779 mijë lekë, Rehabilitimi i aksit Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) me vlerë 1,575,107 mijë lekë, Transformimi urban në hapësira publike kryesore Rajoni 1 (Rikualifikimi i zonës turistike të hyrjes Shirokë-Shkodër Faza 2) me vlerë 354,342 mijë lekë.

Në Bashkinë Malësi e Madhe janë kryer këto investime nga FSHZH :Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II, Ndërtim Ura në rrugën Tamare-Vukel me vlerë 50,000 mijë lekë dhe Rrjeti i Ri shpërndarës për zhvillimin e aksit të ne elektrikist në Alpet e Shqipërisë me vlerë 302,809 mijë lekë ndërsa në total nga Bashkia Malësi e Madhe në vlerën 310,774 mijë lekë ndër kryesoret kemi: Sistemim asfaltim rruga Koplík -Sterbeq-Jubice-Kamice, Sistemim asfaltim rruga Grude Fushe poshte drejtim Liqenit, Sistemim rruga Rrash Vorfe –Vorfe, Sistemim asfaltim rruga Syri i Gjonit, Sistemim asfaltim rruga Shen Pali e Shen

Pjetri ( Bajze),Sistemim asfaltim rruga Çulaj Skaq,Sistemim asfaltim rruga Drekaç,Sistemim asfaltim rruga per tek varrezat Kopluk.

Në Bashkinë Vau Dejës janë kryer 296,978 mijë lekë investime dhe ndër investimet kryesore kemi: Sistemim asfaltim rruga Curke Nenshat+ Mbikqyrje+kolaudim, Sistemim asfaltim rruget e brendshme Stajke+Mbikqyrje+Kolaudim, Sistemim asfaltim rruget e brendshme Bushat+ Mbikqyrje+kolaudim,Sistemim asfaltim rruget e brendshme Shkjeze+ Mbikqyrje+kolaudim, Rikonstruksion Rruga e Malesoreve Nj a.Bushat,Mbikqyrje punimesh ne objektin" Rikonstruksion Rruga e Malesoreve Nj a.Bushat",Rikonstruksion i rruges Shen Pali-Qershia njesia administrative Hajmel+ Mbikqyrje+kolaudim,Rikonstruksion i rruges Shen Pali-Qershia njesia administrative Hajmel+ Mbikqyrje+kolaudim.

Në Bashkinë Pukë janë kryer 51,637 mijë lekë investime ndër të cilat më kryesoret mund të përmendim Ujësjellesi Gjegjan, Rikonstruksion Tregu, Ndricim Publik Gjegjan Qerret.Nga ana e ARRSH me fondet e buxhetit të shtetit ka përfunduar zbatimin e projektit “Ndërhyrje emergjence në km 5+500 dhe km 13+000, rehabilitimi i argjinaturave të Përroit të Thatë në segmentin Dedaj-Bogë” me vlerë kontrate prej 77,342,989 lekë.Qëllimi i projektit në segmentet rrugore, (Dedaj-Bogë-Theth) lokalizuar në progresivat 5+500 dhe 13+000 ka të bëjë me ndërtimin e veprave të artit në këto zona, ku pjesa kaluese e rrugës intersekon pothuajse në nivel me shtratin e përroit. Prurjet e mëdha dhe plotat me raste kapërderdheshin mbi pjesën kaluese të rrugës duka shkaktuar bllokim dhe padituri në qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.Ka përfunduar rruga Shkodër-Hani i Hotit dhe Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Mes.Aktualisht po zbatohet projekti, “Ndërtim rruga kthesa e Bërdicës – Ura e Bahçallekut”, ndërtimi i një segmenti që lidh nyjen e Shkodrës me Tiranën dhe Velipojën që përfshin ndërtimin e Urës së re të Bahçallekut mbi lumin Drin.Parashikimin e nyjes në nivel që bën shpërndarjen e trafikut në mënyrë të sigurtë. Parashikimin e mbikalimeve të këmbësorëve në qoftë se gjykohet e nevojshme.Parashikimin e ndriçimit urban për të rritur sigurinë rrugore.Aktualisht po punohet me pusetat dhe tombinot e betonit.Kanë filluar pilotat e këmbëve të urës. Po punohet me prodhimin e tratëve të urës dhe ka filluar asfaltimi.

- *Arsimi parauniversitar*

Nga ana e bashkive në zbatim të detyrimeve ligjore dhe përmbushjes së detyrave funksionale, në fillim të vitit shkollor 2025-2026, janë marrë masat për rikonstruksionin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ambienteve shkollore, si dhe krijimin e kushteve infrastrukturore për fillimin, vijimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjendja e infrastrukturës së shkollave në prag të fillimit të procesit mësimor në përgjithësi paraqitej e mirë dhe plotëson kushtet higjieno-sanitare dhe të sigurisë.

Numri i nxënësve në Qarkun Shkodër për vitin shkollor 2025-2026 është **19.504 nxënës** (14.459 nxënës në Bashkinë Shkodër, 1.962 në Bashkinë Vau i Dejës, 2.082 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 572 në Bashkinë Pukë dhe 429 në Bashkinë Fushë Arrëz). Ky numër rezulton të jetë më i lartë sesa vitin e kaluar (16.394 nxënës), me një diferencë prej 3.110 nxënës më shumë, ose 19% më shumë.

- *Numri i të punësuarve*

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2025 është **31,903**. Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2024 ka qenë 31,420. Numri i të punësuarve është rritur lehtësisht krahasur me vitin e kaluar (+483 të punësuar, ose rreth 1.5% më shumë), rritje e cila ka ardhur nga masat e marra nga qeveria për mbështetjen e zhvillimit të turizmit dhe kryerjen e investimeve dhe nga puna dhe performanca e Drejtorisë Rajonale Tatimore.

- *Turizmi*

Viti 2025, ka shënuar një sukses në këndvështrimin e menaxhimit të sektorit të turizmit, i cili ka ardhur edhe falë masave të qeverisë për kryerjen e investimeve publike dhe orfrimin e shërbimeve në destinacioniut turistike

Objektivat e sezonit turistik veror 2025, të parashikuara në politikat rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm, ashtu edhe në ato në nivel strategjie sektoriale, megjithë problematikat e hasura, në tërësi e tyre janë tejkaluar;

Gjatë sezonit është garantuar siguria publike (Janë parandaluar aktet kriminale, duke mos u evidentuar asnjë ngjarje kriminale; Është mirëmenaxhuar trafikku, duke garantuar sigurinë rrugore; Si rezultat i kontrolleve dhe masave të marra ka patur një menaxhim të mirë të mjeteve ujore, duke mos shënuar asnjë problem; Janë marrë masa parandaluese ndaj zhurmave, duke eliminuar ndotjen akustike dhe duke krijuar qetësi tek pushuesit; Ka patur një menaxhim më të mirë dhe përpunim të shpejtë të turistëve dhe mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar);

Është rritur numri i turistëve, të cilët kanë vizituar Zonat e Mbrojtura, krahasuar me vitin e kaluar. Numri i vizitorëve në zonat e mbrojtura gjatë vitit 2025 ka qenë 1.298.200 përkundrejt 1.277.267 të vitit 2024 duke shënuar një rritje të lehtë (20.933) e përqendruar kryesisht gjatë sezonit veror. Numri i vizitorëve në kalanë “Rozafa” gjatë sezonit ka qenë mbi 131.090 vizitorë (vendas dhe të huaj), me një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2024, dhe 37% krahasuar me vitin 2023.

Në 3 vitet e fundit Bashkia Shkodër, si shtylla kryesore e turizmit në qark, ka përjetuar një transformim të jashtëzakonshëm në fushën e turizmit. Nga një potencial i njohur prej dekadash, gjatë vitit 2025 është kthyer në një realitet ekonomik dhe social që ka ndikuar drejtpërdrejt në mirëqënien financiare të qytetarëve.

Arritjet në zhvillimin e turizmit kanë ardhur nga përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisive për këtë sektor.

- *Emergjencat Civile*

Numri i zjarreve në nivel qarku për periudhën **Janar – Dhjetor 2025 është 1.111 raste** të raportuara nga drejtoria/sectorët MZSH dhe sektoret MC të bashkive të qarkut Shkodër, i ndarë sipas sipas bashkive është si më poshtë:

1. Bashkia Shkodër 572 raste zjarresh.
2. Bashkia Malësi e Madhe 295 raste zjarresh.

3. Bashkia Vau Dejës 176 raste zjarresh.
4. Bashkia Puke 52 raste zjarresh.
5. Bashkia Fushe Arrëz 16 raste zjarresh.

- *Urdhërat e brendshëm, takimet dhe kërkesë ankesat*

Nga ana e Prefektit në përmbushje të misionit, ushtrimit të përgjegjesive dhe veprimtarisë janë nxjerrë **90 Urdhra**; Janë zhvilluar mbi **22 takime** si me grupin këshillues pranë Prefektit, ashtu edhe me drejtues të institucioneve qendrore në nivel vendor, të njësive të vetëqeverisjes vendore, etj., për zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në planin e veprimit antikanabis, për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, problemet e emergjencave civile, menaxhimin e mbetjeve, mbarëvajtjen e sezonit turistik, ligjshmerinë e akteve të nxjerra nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, etj., Janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke u kthyer përgjigje, 70 kërkesë-ankesa të ndryshme të qytetarëve, subjekteve publike e private.

- *Depozitimi i akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore*

Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër (në sekretari-arkiv) gjatë vitit 2025, nga **6 njësi të qeverisjes vendore- 5 bashki** dhe Këshilli i Qarkut Shkodër si njësi e dytë e qeverisjes vendore-, janë depozituar gjithsej **277** akte, nga të cilat **263** akte normative kanë qenë në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore, ndërsa për **14** akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm sipas argumentave ligjor.

Gjatë vitit, po ashtu, është kryer procesi i verifikimit në vend i akteve normative në të gjitha NJQV sipas Urdhërit të Prefektit, nga ku është konstatuar se është përmirësuar puna krahasuar me vitet e kaluara.

- *Komitete Rajonale, Task Forca dhe Këshilla Vendore*

Institucioni i Prefektit gjatë vitit 2025 ka qenë pjesë përbërëse e grupit ndërinstitucional (Task Forcës), të ngritur, lidhur me: Kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Komitetit Rajonal të Luftës kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm; Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar "Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025"; Monitorimin e zbatimit të masave të parashikuara në "Paketën e Sigurisë në Shkollë"; Menaxhimin e mbetjeve dhe krijimin e një mjedisi të pastër, Menaxhimin e situatës së emergjencave të shkaktuar nga reshjet, përmytjet, zjarret, etj., Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje.

- *Task Forca Vendore Antikanabis*

Në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit nga ana e Task Forcës Vendore Antikanabis është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të tjera pjesë përbërëse të Task Forcës, në mënyrë të veçantë e strukturave të policisë së shtetit, për parandalimin e kultivimit dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

- *Komititeti Rajonal i Antitrafikimit*

Për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave është rritur niveli i bashkëpunimit të Komitetit Rajonal, strukturave të policisë së shtetit, njërive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit, në menyrë të veçantë sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, ku janë zhvilluar aktivitete, me qëllim parandalimin e kësaj veprimtarie kriminale.

- *Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*

Një organizëm kolegjal për koordinimin dhe bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve qendrore, duke përfshirë edhe degët e tyre territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për çështjet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Gjatë periudhës viti 2025, Komiteti ka planifikuar dhe zbatuar aktivitete të fokusuara në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, me theks të veçantë në ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e komunitetit, veçanërisht të të rinjve, përfshirë edhe miratimin e Planit të Masave për vitin 2025. Institucionet përgjegjëse kanë prezantuar dhe zbatuar masat përkatëse për rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave sensibilizuese në shkolla, universitete dhe komunitete, si dhe përmes forcimit të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe programeve edukative që synojnë identifikimin e hershëm të radikalizmit dhe promovimin e tolerancës, respektit për diversitetin dhe dialogut ndërfaqor.

- *Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal*

Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Këshilli Konsultativ Trepalësh Rajonal është kryesuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër, i cili ka siguruar drejtimin, koordinimin dhe funksionimin e rregullt të Këshillit, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, përfaqësimit të barabartë dhe transparencës. KKTR ka zhvilluar konsultime, marrë vendime dhe ka formuluar rekomandime që i janë përcilljellë institucioneve përgjegjëse në nivel vendor. Këshilli gjatë vitit 2025, në takimet e organizuara sipas Rregullores për funksionimin e tij, ka trajtuar çështje që lidhen me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, sigurinë dhe higjienën në punë, arsimin, mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik rajonal.

- *Këshilli Vendor të Sigurisë Publike*

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, Prefekti i Qarkut Shkodër ka iniciuar procedurën e ngritjes së Këshillave Vendore të Sigurisë Publike pranë NJVV-ve të qarkut. Po ashtu, Prefekti është angazhuar në gjetjen dhe përfshirjen e mekanizmave mbështetës për funksionimin e Këshillave pranë cdo bashkie, duke hartuar Marrveshje Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve vendore dhe shoqatave të shoqërisë civile për mbështetje ekspertize mbi rolin funksional të anëtarëve të Këshillit. Në këtë kuadër, janë organizuar aktivitete me qëllim krijimin, mbështetjen dhe rritjen e qëndrueshmërisë së veprimtarisë të KVSP-ve, në adresimin e problematikave lokale të sigurisë publike duke rritur ndërveprimin ndërmjet institucioneve dhe komunitetit në qarkun e Shkodrës dhe duke përdorur Sistemin e Matjes së Sigurisë në Komunitet (SMSK) për të rritur transparencën

- *Paketa Sigurisë në Shkolla*

Në zbatim të detyrave funksionale dhe përgjegjësi, Prefekti i Qarkut Shkodër ka bashkërenduar veprimtaria me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore në nivel vendor dhe rajonal, inspektoratet përgjegjëse për monitorimin e kushteve higjieno-sanitare, shërbimit ushqimor dhe kontrollit të perimetrave rrethues të institucioneve arsimore, si dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë. Ky koordinim është realizuar me qëllim zbatimin e detyrimeve ligjore përkatëse sipas fushave të përgjegjësive, garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor, si dhe sigurimin e një informacioni të përditësuar në funksion të rritjes së sigurisë dhe parandalimit të kriminalitetit në mjediset shkollore dhe hapësirat përreth tyre, në kuadër të zbatimit të “Paketës së Sigurisë në Shkolla”.

- *Nga ana e Prefektit të qarkut, në cilësinë e drejtuesit të KRZHT;*

Është hartuar e miratuar plani i veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025” duke u mbështetur në planet e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësi të vetëqeverisjes vendore. Është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me drejtuesit e përfaqësues të Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësi të vetëqeverisjes vendore, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit (*Urdhër i Prefektit Nr. 41, datë 29.05.2025*) grup i cili ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e plan veprimit “Për menaxhimin, mbarëvajtjen e sezonit turistik veror dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2025”. Është bërë promovimi i destinacioneve, ofertave turistike nëpërmjet organizimit të panairove dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe të traditës, sipas bashkive dhe njësi administrative të këtyre bashkive.

### III. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË

#### III.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave

##### III.1.a. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Janë realizuar të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2025 me një vlerë prej **1,614,938** mijë lekë, me një mosrealizim prej **105,630** mijë lekë.

Krahasuar me vitin e kaluar, kur të ardhurat e realizuara ishin 1,329,773 mijë lekë, vihet re një rritje në vlerë arkëtimeve prej 285,162 mijë lekë ndërsa shikuar në raport me parashikimin kemi një rënie në realizim të planit krahasuar me vitin 2024 që ishte 96%.

Ecuria e treguesve fiskale të Bashkisë Shkodër ka rezultuar pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit dhe ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertave të buxhetit qendror 2025 krijoi

kushtet e favorshme për Bashkinë Shkodër për të nxitur politika të reja në drejtim të cilësisë së shërbimeve publike.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2025 dhe 2024, paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat gjithsej				
		Viti 2025			Viti 2024	
		Program	Fakt	%	Program	Fakt
1	Keshilli i Qarkut	2,140	2,040	95	2,090	2,034
2	Bashkia M. Madhe	161,329	95,774	59	158,166	93,309
3	Bashkia Shkodër	1,265,812	1,264,813	99.9	956,087	1,008,685
4	Bashkia Vau i Dejes	176,186	160,949	91	173,820	144,132
5	Bashkia Puke	58,506	34,767	59	56,161	36,060
6	Bashkia Fushe-Arrez	56,595	56,595	100	28,555	45,553
	<b>Totali</b>	<b>1,705,711</b>	<b>1,614,938</b>	<b>93.8</b>	<b>1,374,879</b>	<b>1,329,773</b>

### III.1.b. Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 9,811,037 mijë lekë krahasuar me 8,808,964 vitin e kaluar (2024), ku vihet re një rritje arkëtimesh prej 1,002,073 lekë, ose 11.3% më shumë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas zërave për vitin 2025 dhe 2024 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2024			2025	
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt
1	Tatim mbi vlerën e shtuar	920,000	1,040,129	113	1,150,000	1,180,966
2	Ttim-fitimi	750,000	681,065	91	750,001	652,587
3	T/ardh. Pers.+ dënime admin	1,200,000	1,350,735	113	1,600,002	1,687,164
4	Taksa nacionale	38,000	30,856	81	33,001	26,141
	<b>Totali Tatime</b>	<b>2,908,000</b>	<b>3,102,785</b>	<b>107</b>	<b>3,533,004</b>	<b>3,546,858</b>
5	Kontribut sig.shoq. e shënd.	5,700,037	5,706,179	100	6,300,001	6,264,179
	<b>Gjithsej</b>	<b>8,608,037</b>	<b>8,808,964</b>	<b>102</b>	<b>9,833,005</b>	<b>9,811,037</b>

## III.2. Realizimi i Investimeve

### III.2.a. Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Janë në zbatim projekte për vitin 2024-2026 nëpërmjet FSHZH, me një vlerë prej

4,952,856 mijë lekë për Bashkinë Shkodër dhe 352,809 mijë lekë për Bashkinë Malësi e Madhe ku ndër projektet prioritare të qarkut Shkodër të cilat janë në vazhdim mund të përmendim: Ndërhyrje në hyrje të Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës (Faza I) me vlerë 478,819 mijë lekë. Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë – Zogaj-Kufi me Malin e Zi dhe rikonstruksioni i ujësjellësit të Shirokës me vlerë 514,273 mijë lekë, Investime për infrastrukturën e tregjeve dhe hapësirave tregtare, multifunkionale në zona model zhvillimi "Zdrale-Rijetëzimi urban i Pazarit të Shkodrës, Lot A – Rr. Hamz Kazazi me vlerë 328,361 mijë lekë. Transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional në bashkinë Shkodër me vlerë 639,062 mijë lekë. Site natyrore, ndërtimi i hyrjes së Liqenit të Shkodrës, Faza 2, Parku i Ligatinave me vlerë 564,960 mijë lekë. Zhvillimi i potencialit turistik, Muzeu i navigimit Shkodër me vlerë 271,153 mijë lekë, Rikonstruksioni dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën turistike të Velipojës, Shkodër (Rruga Pulaj-Ura e Bunës) me vlerë 226,779 mijë lekë, Rehabilitimi i aksit Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) me vlerë 1,575,107 mijë lekë, Transformimi urban në hapësira publike kryesore Rajoni 1 (Rikualifikimi i zonës turistike të hyrjes Shirokë-Shkodër Faza 2).

Në Bashkinë Malësi e Madhe janë kryer këto investime nga FSHZH :Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II, Ndërtim Ura në rrugën Tamare-Vukel me vlerë 50,000 mijë lekë dhe Rrjeti i Ri shpërndarës për zhvillimin e aksit të ne elektrikist në Alpet e Shqipërisë me vlerë 354,342 mijë lekë ndërsa në total nga Bashkia Malësi e Madhe në vlerën **310,774 mijë lekë** ndër kryesoret kemi: Sistemim asfaltim rruga Koplík -Sterbeq-Jubice-Kamice, Sistemim asfaltim rruga Grude Fushe poshte drejtim Liqenit, Sistemim rruga Rrash Vorfe –Vorfe, Sistemim asfaltim rruga Syri i Gjonit, Sistemim asfaltim rruga Shen Pali e Shen Pjetri ( Bajze), Sistemim asfaltim rruga Çulaj Skaq, Sistemim asfaltim rruga Dreka, Sistemim asfaltim rruga per tek varrezat Koplík.

Në Bashkinë Vau Dejës janë kryer **296,978 mijë lekë** investime dhe ndër investimet kryesore kemi: Sistemim asfaltim rruga Curke Nenshat+ Mbikqyrje+kolaudim, Sistemim asfaltim rruget e brendshme Stajke+Mbikqyrje+Kolaudim, Sistemim asfaltim rruget e brendshme Bushat+ Mbikqyrje+kolaudim, Sistemim asfaltim rruget e brendshme Shkjeze+ Mbikqyrje+kolaudim, Rikonstruksion Rruga e Malesoreve Nj a. Bushat, Mbikqyrje punimesh ne objektin" Rikonstruksion Rruga e Malesoreve Nj a. Bushat", Rikonstruksion i rruges Shen Pali-Qershia njesia administrative Hajmel+ Mbikqyrje+kolaudim, Rikonstruksion i rruges Shen Pali-Qershia njesia administrative Hajmel+ Mbikqyrje+kolaudim.

Në Bashkinë Pukë janë kryer **51,637 mijë lekë investime** ndër të cilat më kryesoret mund të përmendim Ujësjellesi Gjegan, Rikonstruksion Tregu, Ndricim Publik Gjegan Qerret.

### III.2.b. Investime me fondet e qeverisë nga FShZh

Janë në zbatim projekte për vitin 2024-2026 nëpërmjet FSHZH, me një vlerë prej 4,952,856 mijë lekë për Bashkinë Shkodër dhe 352,809 mijë lekë për Bashkinë Malësi e Madhe.

Në bashkitë e qarkut Shkodër, janë kryer investime nëpërmjet FSHZH ku ndër projektet prioritare të qarkut Shkodër të cilat janë në vazhdim mund të përmendim: Ndërhyrje

në hyrje të Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perendimor të Liqenit të Shkodrës (Faza I) me vlerë 478,819 mijë lekë. Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë – Zogaj-Kufi me Malin e Zi dhe rikonstruksioni i ujësjellësit të Shirokës me vlerë 514,273 mijë lekë, Investime për infrastrukturën e tregjeve dhe hapësirave tregtare, multifunkionale në zona model zhvillimi”Zdrale-Rijetëzimi urban i Pazarit të Shkodrës, Lot A – Rr.Hamz Kazazi me vlerë 328,361 mijë lekë.Transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional në bashkinë Shkodër me vlerë 639,062 mijë lekë.Site natyrore, ndërtimi i hyrjes së Liqenit të Shkodrës, Faza 2, Parku i Ligatinave me vlerë 564,960 mijë lekë.Zhvillimi i potencialit turistik, Muzeu i navigimit Shkodër me vlerë 271,153 mijë lekë, Rikonstruksioni dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën turistike të Velipojës, Shkodër (Rruga Pulaj-Ura e Bunës) me vlerë 226,779 mijë lekë, Rehabilitimi i aksit Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) me vlerë 1,575,107 mijë lekë, Transformimi urban në hapësira publike kryesore Rajoni 1 (Rikualifikimi i zonës turistike të hyrjes Shirokë-Shkodër Faza 2).

Në Bashkinë Malësi e Madhe janë kryer këto investime nga FSHZH :Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II, Ndërtim Ura në rrugën Tamare-Vukel me vlerë 50,000 mijë lekë dhe Rrjeti i Ri shpërndarës për zhvillimin e aksit të ne elektrikist në Alpet e Shqipërisë me vlerë 354,342 mijë lekë

### **III.2.c. Investime nga ARRSH**

Nga ana e ARRSH me fondet e buxhetit të shtetit ka përfunduar zbatimin e projektit “Ndërhyrje emergjence në km 5+500 dhe km 13+000, rehabilitimi i argjinaturave të Përroit të Thatë në segmentin Dedaj-Bogë” me vlerë kontrate prej 77,342,989 lekë.Qëllimi i projektit në segmentet rrugore, (Dedaj-Bogë-Theth) lokalizuar në progresivat 5+500 dhe 13+000 ka të bëjë me ndërtimin e veprave të artit në këto zona, ku pjesa kaluese e rrugës intersekon pothuajse në nivel me shtratin e përroit. Prurjet e mëdha dhe plotat me raste kapërderdheshin mbi pjesën kaluese të rrugës duka shkaktuar bllokim dhe padituri në qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.Ka përfunduar rruga Shkodër-Hani i Hotit dhe Rikonstruksioni i rrugës Shkodër-Mes.Aktualisht po zbatohet projekti, “Ndërtim rruga kthesa e Bërdicës – Ura e Bahçallekut”, ndërtimi i një segmenti që lidh nyjen e Shkodrës me Tiranën dhe Velipojën që përfshin ndërtimin e Urës së re të Bahçallekut mbi lumin Drin.Parashikimin e nyjes në nivel që bën shpërndarjen e trafikut në mënyrë të sigurtë. Parashikimin e mbikalimeve të këmbësorëve në qoftë se gjykohet e nevojshme.Parashikimin e ndriçimit urban për të rritur sigurinë rrugore.Aktualisht po punohet me pusetat dhe tombinot e betonit.Kanë filluar pilotat e këmbëve të urës. Po punohet me prodhimin e tratëve të urës dhe ka filluar asfaltimi.

### **III.2.d. Investimet në proces realizimi**

Janë në zbatim projekte për vitin 2024-2026 nëpërmjet FSHZH, me një vlerë prej 4,952,856 mijë lekë për Bashkinë Shkodër dhe 352,809 mijë lekë për Bashkinë Malësi e Madhe ndër të cilat mund të përmendim:

- Ndërhyrje në hyrje të Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perendimor të Liqenit të Shkodrës (Faza I) me vlerë 478,819 mijë lekë.
- Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë – Zogaj-Kufi me Malin e Zi dhe rikonstruksioni i ujësjellësit të Shirokës me vlerë 514,273 mijë lekë,
- Investime për infrastrukturën e tregjeve dhe hapësirave tregtare, multifunksionale në zona model zhvillimi” Zdrale-Rijetëzimi urban i Pazarit të Shkodrës, Lot A – Rr.Hamz Kazazi me vlerë 328,361 mijë lekë.
- Transformimi i infrastrukturës akomoduese në kampuset rajonale të arsimit profesional në bashkinë Shkodër me vlerë 639,062 mijë lekë.
- Site natyrore, ndërtimi i hyrjes së Liqenit të Shkodrës, Faza 2, Parku i Ligatinave me vlerë 564,960 mijë lekë.
- Zhvillimi i potencialit turistik, Muzeu i navigimit Shkodër me vlerë 271,153 mijë lekë,
- Rikonstruksioni dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore në zonën turistike të Velipojës, Shkodër (Rruga Pulaj-Ura e Bunës) me vlerë 226,779 mijë lekë,
- Rehabilitimi i aksit Shëngjin-Baks-Rrjoll (13km) me vlerë 1,575,107 mijë lekë,
- Transformimi urban në hapësira publike kryesore Rajoni 1 (Rikualifikimi i zonës turistike të hyrjes Shirokë-Shkodër Faza 2) me vlerë 354,342 mijë lekë.
- Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II, Ndërtim Ura në rrugën Tamare-Vukel me vlerë 50,000 mijë lekë
- Rrjeti i Ri shpërndarës për zhvillimin e aksit të ne elektrikist në Alpet e Shqipërisë me vlerë 302,809 mijë lekë

#### **IV. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministritë, Institucionet qendrore në nivel vendor)**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive ka shqyrtuar veprimtarinë e institucionëve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkëpunimin me institucionët qendrore në nivel vendor, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e institucionëve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionët në nivel Qarku.

Prefekti ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionët qendrore, Degët Territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe veprimtaritë e tyre në nivel qarku, lidhur me menaxhimin e mbetjeve; Menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit; Goditjen e informalitetit në ushtrimin e veprimtarisë së biznesit; Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të personave; Ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike; etjer.

Gjatë vitit në ushtrimin e veprimtarisë së tij Institucioni ka patur një bashkëpunim

shumë të mirë dhe është mbështetur nga Ministria e Punëve Brendshme (Drejtorinë e Politikave dhe Koordinimit për Menaxhimin e Territorit), përfshirë drejtuesit kryesor, të cilët gjatë vitit kanë organizuar e zhvilluar takime për probleme të zhvillimit të turizmit e territorit; Çështjet e Luftës kundër trafikimit të personave; Zbatimin e planit kombëtar në luftën ndaj kultivimit të bimëve narkotike; etj. Me ministrinë e Brendshme është bashkëpunuar në zgjidhjen e të gjitha problemeve në nivel qarku edhe me institucionët e tjera qendrore, përfshirë problemet e mbrojtjes civile.

#### **IV.1. INSTITUCIONET QENDRORE NË NIVEL VENDOR DHE VEPRIMTARIA E TYRE**

##### **IV.1.1. Drejtoria Tatimore Rajonale dhe Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Verior)**

Drejtoria Rajonale Tatimore është strukturë e Administratës Tatimore Qendrore, që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve.

Njësitë përbërëse të Drejtorive Rajonale Tatimore (Drejtoritë Funktionale, Sektorët, Zyrat apo punonjësit që zbatojnë një funksion të caktuar) operojnë mbi bazën e manualeve procedurale të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku përshkruhen me hollësi veprimet që këto njësi ndërmarrin sipas funksioneve të administrimit tatimor.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër përbëhet nga 3 drejtori dhe një sektor: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Shërbimit të tatimpaguesve dhe Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse dhe sektori I Analizës dhe Kontabilitetit të të ardhurave.

Objektivat strategjikë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për vitin 2025 kanë qenë:

1. Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare
2. Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor
3. Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerzore

Për vitin 2025 janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 9,811,037 mijë lekë ose 100% e të ardhurave të programuara. Nqs bëjmë një krahasim shohim se të ardhurat janë rritur me vlerën 1,001,773 mijë lekë nga viti 2024 ku të ardhurat nga tatimet janë realizuar 8,808,964 mijë lekë, ose 102 % e të ardhurave të programuara, me një tejkallim prej 200,927 mijë lekë. Në vitin 2023, DRT ka realizuar të ardhura në vlerën 7,767,723 mijë lekë.

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2025, është 31,903 nga 31,420 gjatë vitit 2024. Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2023 ka qenë 30,534. Numri i të punësuarve është rritur krahasur me vitin e kaluar, rritje e cila ka ardhur nga masat e marra nga qeveria për mbështetjen e zhvillimit të turizmit, kryerjen e investimeve dhe nga puna dhe performanca e Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, për kontribuesit, numri i të punësuarve për vitin 2025 paraqitet:

Të dhëna mbi numrin e subjekteve dhe të punonjësve

Nr.	EMERTIMI	Sipas Tatimeve		SHKODRA		MALESIA E MADHE		PUKE	
		Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës
1	Aktiviteti Gjithsejt	7,012	31,903	6,188	26,544	516	3,281	308	2,078
2	Në sektorin Shtetëror	109	10,471	76	7321	13	1924	20	1226
2.1	Shtetëror buxhetor	100	9,938	72	7,263	12	1467	16	1,208
2.2	Shtetëror jobuxhetor	9	533	4	58	1	457	4	18
3	Në sektorin privat	6,903	21,432	6,112	19,223	503	1,357	288	852
3.1	Të rregjistruar si person fizik	5,530	9,493	4,964	8,628	398	664	168	201
3.2	Të rregjistruar si person juridik	1,373	11,939	1,148	10,595	105	693	120	651
3.2	Firma vendase	1,257	10,567	1,035	9,238	102	678	120	651
3.2	Ndërmarrje të përbashkëta	40	224	39	213	1	11	0	0
3.2	Firma të huaja	76	1,148	74	1,144	2	4	0	0

#### IV.1.2. Dega e Doganës Shkodër

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej **5,858,926 lekë** nga **5,391,737 leke** të planifikuara duke tejkaluar kështu të ardhurat e planifikuara me **109%**.

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për goditjen e fenomenit të fshehjes së detyrimeve doganore nga subjektet gjatë importit të mallrave.

#### IV.1.3. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore

Në zbatim ligjit Nr.7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregulloreve të miratuara nga ISSH-ja dhe rregulloreve të brendshme të DRSSH-së,

institucioni është angazhuar në realizimin e detyrave të planifikuara vjetore dhe detyrave të paparashikuara, të dala gjatë vitit në ushtrim. Për vitin 2025, DRSSH Shkodër ka realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi me tejkallim të planit vjetor, realizuar në masën 108%, kontributet vullnetare me tejkallim të planit vjetor, realizuar në masën 118% si dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private, mbledhja e të ardhurave nga të cilat është përgjegjësi e Drejtorisë së Tatim Taksave.

Për vitin 2025 DRSSH Shkodër ka realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi në vlerën 332,644 mijë lekë nga 309,000 mijë lekë të planifikuara, pra me tejkallim të planit vjetor në masën 108%. Ka realizuar të ardhura nga kontributet vullnetare në masën 42,448 mijë lekë nga 36,000 mijë lekë të planifikuara, pra me tejkallim të planit vjetor në masën 118%, si dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private, mbledhja e të ardhurave nga të cilat është përgjegjësi e Drejtorisë së Tatim Taksave.

Dega e përfitimeve, gjatë vitit 2025, është përballur me një volum të konsiderueshëm pune duke shqyrtuar kërkesa të ndryshme nga e-albania, për përfitime, nga ligji 7703 datë 11.05.1993 ( i ndryshuar) dhe shërbime të ndryshme për 19,890 shtetas, po ashtu dhe dega e arkivës ka shqyrtuar 5,750 kërkesa on-line për nxjerrje të vjetërsisë në punë për;

1. ish koop bujqësore,
2. ndërmrrjet shtetërore para 1994,
3. kontributet pas vitit 1994,
4. kontributet për të vetpunësuarit në bujqësi.

Janë caktuar 4,509 pensione të reja (pleqeri, invalid, familjar), 9 pensione të reja sociale, 66 rihapje pensioni dhe 5 ndryshim grupi. Pensione të mbyllura 1956 pensione (pleqeri, invalid, familjar), 67 pensione sociale dhe 242 transferime.

Gjithashtu janë trajtuar kërkesat sipas Ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ku përfitues deri tani kanë rezultuar 16 pensionistë. Për të gjitha rastet janë bërë llogaritjet dhe rillogaritjet, vendimet, kartelatat financiare si dhe pasqyrimi dhe gjenerimi I pagesës në sistemin PCAMS.

DRSSH Shkodër, ploteson të gjitha kërkesat e ardhura on-line dhe poste për pensione të reja pleqeri, invaliditet, familjar, të gjithë llojet e tjere të përfitimeve suplementare, trajtimeve të ndryshme financiare, pafesive të perkohshme në punë, barre lindjeve, nxjerrje vjetërsie në punë, korespondenca të ndryshme etjer. Pranë DRSSH-së Shkodër funksionon edhe Komisioni Rajonal i Ankimit (pjese e procedurave administrative të ankimit), i cili trajton kërkesat, kompetence e tij. Po kështu pranë DRSSH-se Shkodër dhe Agjensive të saj, ekzistojnë kutite e ankesave për pretendimet e cdo njerit.

#### **IV.1.4. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**

Puna e drejtorisë është përqendruar në realizimin e planeve të Inspektimit të miratuara nga DPAKU; Në realizimin e detyrimeve të planifikuara të treguesve financiar; Në zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit (Ligji Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në

R.Sh” me ndryshime; Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, me ndryshime; VKM Nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, me ndryshime), si dhe sipas planit kombëtar të kontrolleve (miratuar me Udhëzimit Nr. 2, datë 24.02.2020, me ndryshime). Gjate vitit 2025, aktiviteti i inspektimit është fokusuar në:

- Kontrollin e subjekteve të prodhimit, përpunimit, magazinimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore
- Monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për sigurinë ushqimore
- Mbrojtjen e interesit të konsumatorit dhe parandalimin e rreziqeve për shëndetin publik
- Bashkëpunimin nderinstitucional me strukturat kryesisht qëndrore dhe ato vendore

*Spektori i kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për kafshë dhe OBU-ve, gjatë vitit 2025, ka vijuar inspektimet dhe kontrollin në terren për të garantuar sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.*

- **Inspektimet:** Janë planifikuar 1033 inspektime dhe janë realizuar 1889 (1033 të planifikuara dhe 856 jashtë planifikimit).
- **Mostrat:** Janë marrë 210 mostra për analiza (32 mostra nga sektori SMIB nga ku 17 mostra per tu analizuar në laboratorin e QTTB, 9 mostra ESHFF Tiranë; 139 mostra të marra për laboratorin e AKU me 246 tregues të analizuar dhe 39 mostra të marra për laboratorin ISUV Tiranë me 43 tregues të analizuar). Krahas analizave të planifikuara për në laboratorët përkatëse AKU ka kryer dhe monitorim te pesticideve tek fruta-perimet si dhe eshte kryer monitorimi I qumështit ne nivel Qarku. Monitorim pesticidesh sipas planit vjetor janë përcaktuar 40 mostra ndërsa janë marrë 33 mostra në mungesë të shërbimeve nga laboratorin ISUV Tiranë. Monitorim I “qumështit të freskët” janë marrë rreth 588 mostra.
- **Masat administrative:** Janë vendosur 98 paralajmërime për shkelje të lehta dhe 44 gjoba me vlerë totale 4,400,000 lekë (29 masa “Gjobe” me vlerë 2 950 000 lekë (sektori UOSH) në total dhe 15 masa “Gjobe” me vlerë 1 450 000 lekë (sektori UOJSH) .
- **Produktet e ndaluara dhe asgjësimet:** Janë bllokuar 97.7 ton produkte dhe janë asgjësuar 28.23 ton produkte në 2 raste me kërkesë të subjekteve (sektori UOJSH) ndërsa nga (sektori UOSH) janë bllokuar gjithsej 2.327 ton produkte të ngurta dhe 1.880 litra leng .
- **Certifikimet:** Janë realizuar 116 certifikime për eksport (sektori UOSH) dhe 743 për eksport të gjitha me destinacion Kosovën (sektori UOJSH).
- **Ankesat e konsumatorëve:** Janë shqyrtuar dhe inspektuar 10 raste të ardhura nga konsumatorët dhe 8 raste kanë rezultuar në bllokim produkti me destinacion asgjësimin apo kthim në origjinë.

*Spektori i Kontrollit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Imputeve Bujqësore realizoi 275 inspektime (236 të planifikuara dhe 39 jashtë planifikimit) gjatë vitit 2025. U morën 32 mostra për analiza në laboratorë të ndryshëm. U vendosën 10 paralajmërime dhe janë shqyrtuar gjithsej 7*

kerkesa per licensa nga të cilat 6 kërkesa për licensa nga të cilat 6 kërkesa janë mosmiratim dhe 1 kërkesë për liçensim është miratuar.

Pjesë strukturale administrative e AKU është edhe *Pika e Inspektimit Kufitar Hani Hotit* (përgjegjëse për kontrollin e importit të bimëve origjinë shtazore dhe jo shtazore, kafshëve të gjalla, bimëve dhe produkte bimore si dhe inputeve bujqësore). Për periudhën Janar-Dhjetor, pika kufitare e Hanit të Hotit ka kryer:

- Për sektorin e OSH-2137 kalime doganore (importe)
- Për sektorin OJSH- 9438 kalime doganore (importe)
- Për sektorin Fitosanitar- 5802 kalime doganore (importe)

DRAKU Shkodër, Sektori i Shërbimeve Laboratorike, kryen analiza të llojit mikrobiologjik (kriteret e sigurisë së produkteve ushqimore dhe ato të proceseve të higjenes), fiziko-kimike (si disa treguesanalitikë të sigurisë ushqimore) dhe të gjitha llojet e analizave organo-leptike (në lidhje me treguesit cilësorë të produkteve ushqimore). AKUDRSH në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Shkodër kanë ndjekur vazhdimisht rastet ALERT të ardhura në lidhje me rezultatet positive të analizat në produkte të tipit lëndë e parë si qumësht edhe mish mbi problematikat e hasura në ferma bujqësore dhe blegtoral. Për vitin 2025 numri I rasteve është rreth 11 dhe këto ferma mbahen në monitorim të vazhdueshëm. Ndërsa në zbatim të Urdhërave të veçantë apo emaileve nga Drejtoria e Përgjithshme AKU Tirane dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025 janë kryer rreth 82 kontrolle të tipit ndjekje gjurmueshmërie në bazë të sezonit turistik apo sezonit të festive të fundvitit.

#### **IV.1.5. Drejtoria e Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive**

Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare për Punësim e Aftësim, Shkodër, (AKPA), gjatë vitit 2025 ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje të misionit dhe kryerjes së detyrave funksionale. Fokusi kryesor është punësimi dhe mbështetja e grupeve vulnerabel, për rritjen e mundësive të punësimit, ka bashkëpunuar dhe organizuar tryeza të rrumbullakëta me pjesëmarrje nga grupet e interesit (të organizuara këto në ambientet e DRAKPA, apo edhe në bashki, Universitet, SHSSH dhe OJF të ndryshme, me të cilat është bashkëpunuar në vazhdimësi). Nisur nga detyrat funksionale (Shërbime të ndërmjetësimit, Shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme dhe punëdhënësit; Shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimit për punësim a vetëpunësim për punëkërkuessit; Shërbim e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë; Financim të punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar; Nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi; Formimin dhe rifomimin profesional për punëkërkuessit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë; Kryerja e studimeve të autorizuara të tregut të punës, etj.), gjatë vitit mbi bazën e planit të treguesve të monitorueshëm nga Drejtoria Përgjithshme, është hartuar plani i veprimeve për realizimin e treguesve.

Është përmirësuar niveli i bashkëpunimit me institucionet qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlen të vlerësohet bashkëpunim me;

- Bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror për referimin e skedave nga kategoria Ndihmë Ekonomike dhe kategoria PAK
- Bashkëpunim me Shërbimin Social në bashkinë Shkodër në kuadër të referimit të rasteve të veçanta.
- Bashkëpunim me Universitetet në kuadër të përfshirjes në PNP, VKM 17/2020, i ndryshuar “Praktika Profesionale”, të studentëve që kanë përfunduar ciklin e studimeve Bachelor ose Master.
- Bashkëpunim me shkollat e mesme profesionale në kuadër të aplikimit online për regjistrimin e maurantëve si punëkërkuës të papunë në zyrën e Punës (shkollat e mesme profesionale “Hamdi Bushati”, “Arben Broci” dhe “Kolë Margjini”).
- Bashkëpunim me OJF-të e qarkut Shkodër si: Caritas, Code Partners, CDP, Projekti Shpresë, Save the Children, FSHDPAK.
- Bashkëpunim me Bashkitë: Shkodër, Vau Dejës, Pukë, Fushë Arrëz dhe Malësi e Madhe. Në kuadër të zbatimit të PNP-ve, VKM 535/2020, i ndryshuar “Punë në Komunitet”, VKM 17/2020, i ndryshuar “Praktika profesionale” etj.

Në vitin 2025, numri i punëkërkuësve të papunë që kanë arritur të punësohen është 1873 nga 1697 që ka qenë objektivi. Në fund të vitit janë regjistruar punëkërkuës të papunë që ndjekin kurset e formimit profesional 1078 nga 1101 që kane qenë një vit më parë.

Gjatë vitit janë punësuar 1873 pu.pa (nga 1,697 që ka qenë objektivi vjetor), nga të cilët:

- Me ndërmjetësime direkte 432 pu.pa.
- Gjete punë vetë 1,174

Në total ka pasur 84 kërkesa të ardhura gjatë vitit 2025, nga të cilat 14 janë shtetas, 13 subjekte private dhe 57 subjekte publike. Të gjitha kërkesat kanë marrë zgjidhje.

#### **IV.1.6. Drejtoria Rajonale e Ofrimit Formimit Profesional Publik**

Formimi profesional luan një rol kyç në përgatitjen e fuqisë punëtore dhe përmbushjen e kërkesave të tregut të punës. Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, nevojat për formim profesional janë identifikuar përmes një procesi të strukturuar, duke përfshirë analizën e të dhënave nga Zyrat e Punësimit, kërkesat e subjekteve private dhe aplikimet e individëve të interesuar për zhvillim profesional. Bazuar në këtë analizë, është hartuar një planifikim i kurseve afatshkurtra, me synimin për të përfshirë në mënyrë të veçantë punëkërkuësit e papunë dhe shtresat vulnerabel, duke kontribuar kështu në rritjen e mundësive të punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grupeve në nevojë.

Mbi këtë bazë është bërë planifikimi i zhvillimit të kurseve afatshkurtra të formimit profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke u fokusuar në përfshirjen e punëkërkuësve të papunë me prioritet shtresat vulnerabel.

Gjatë vitit 2025 janë hapur 16 lloje kursesh nga të cilat 13 prej tyre profesionale dhe 2 kurse Aftësi digjitale dhe Aftësi për punësim duke realizuar 935 regjistrime punëkërkuësish të papunë, 564 prej të cilëve në kurset profesionale dhe 371 në kurset Aftësi Digjitale dhe Aftësi

për punësim.

Bazuar në objektivat dhe treguesit e monitorueshëm për vitin 2025, rezulton përmbushja e tyre për :

- Punëkërkues të papunë që ndjekin kurse profesionale, realizuar në masën 103% (550 objektivi, realizuar 564);
- Punëkërkues të papunë që ndjekin kursin aftësi digjitale, realizuar në masën 105% (175 objektivi, realizuar 188);
- Punëkërkues të papunë që ndjekin kursin aftësipër punësim, realizuar në masën 232% (79 objektivi, realizuar 132);
- Romë/Egjiptian, realizuar në masën rreth 33% (4 objektivi, realizuar 12);
- P.A.K., realizuar në masën rreth 157% (7 objektivi, realizuar 11);
- Ndihma ekonomike, realizuar në masën rreth 122% (50 objektivi, realizuar 61) ;

Kursantë nga shtresat vulnerabël gjatë viteve 2024 dhe 2025

Shtresat vulnerabël	Viti 2024	Viti 2025
<b>Romë &amp; egjiptjan</b>	19	7
<b>Emigrantë të riatdhesuar</b>	4	7
<b>Persona me aftësi të kufizuar</b>	14	41
<b>Ndihma ekonomike</b>	63	118
<b>TOTALI</b>	<b>100</b>	<b>173</b>

Siç shihet nga të dhënat e tabelës me sipër, numri i personave që i përkasin shtresave vulnerable të cilët janë përfshirë në kurse profesionale dhe joprofesionale gjatë vitit 2025 është më i madh krahasuar me atë të vitit 2024.

Në përmbushjen e detyrave funksionale gjatë vitit ka patur një bashkëpunim të mirë me institucionet vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

#### IV.1.7. Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (Seksioni i Ekstensionit Bujqësor Shkodër)

Drejtim kryesor i këtij i veprimtarisë është rritja e efektivitetit të shërbimeve të ekstensionit për këshillim, trajnim dhe sigurim informacioni në Qendrat e Informacionit Bujqësor e më gjerë, nëpërmjet realizimit cilësor të programeve dhe aktiviteteve të planifikuara, në përputhje me prioritetet dhe tendencat e zhvillimit të bujqësisë, politikave dhe strategjive të MBZHR.

Sektorët strategjikë :

- a. Prodhimi dhe grumbullimi i BAM-ve
- b. Prodhimi i pemëve frutore dhe perimeve
- c. Prodhimi dhe përpunimi industrial i fruta perimeve
- d. Prodhimi dhe përpunimi industrial i produkteve të qumështit dhe mishit
- e. Prodhimi i drithërave të bukë
- f. Prodhimi dhe tregtimi i bimeve dekorative

SEB duke qenë një ndër vepruesit kryesorë dhe me një eksperiencë disa vjecaree, ka qenë i orinetuar drejt sistemeve bujqësore në zhvillim. Përvoja e deri tanishme krijon premisë që ky shërbim të zhvillojë aktivitetin e tij në të ardhmen jo si një shërbim i izoluar, por një shërbim kompleks ku përfshihet i gjithë sistemi i gjenerimit, transformimit, përhapjes dhe përdorimit të informacionit dhe njohurive në fushën e bujqësisë.

Në qarkun e Shkodrës janë kontaktuar për të aplikuar 2.000 fermer për Skemat Mbështetëse të IPARD, nga 5 aplikime i kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionet e duhura në AZHBR Tiranë. Për vitin 2025 raporti i aplikimeve me përfituesit në masa të ndryshme të skemave kombëtare është si më poshtë:

1.Gjelle	415 fermer.
2.Te imta	345 fermer.
3.Bletari	356 fermer.
4.Sera	15 fermer.
5.BAM	840 fermer
6.Ferma organike	19 fermer
7.Çertifikimi Global GAB	4 fermer

Për punime të mekanizuar (nafte) në qarkun Shkodër kanë aplikuar 3.194 fermer dhe për periudhën 12-mujore kanë përfituar 2.900 ferma bujqësore që kultivojnë bimë të ndryshme bujqësore.

Në qarkun e Shkodrës janë pajisur me vertetim për nxjerrje NIPT për periudhën Janar-Dhjetor 853 fermer duke e çuar numrin total në 8.300 fermerë.. Është bërë regjistrimi i fermerëve në sistemin elektronik të regjistrimit të fermerit. Deri më tani janë autorizuar rreth 6.100 fermerë me Kod ferme dhe të dhëna bazë të fermës. Për kryerjen e veprimtarisë është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata dhe fermerë, bashkëpunim i cili ka qenë i mirë.

#### **IV.1.8. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Lezhë (Sektori Shkodër)**

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, në Qarkun Shkodër ka në administrim 151.1 km kanale të parë kullues, 63.9 km argjinatura mbrojtëse nga përmytjet, rrjet të parë ujitës me gjatësi 180 km si dhe një rezervuar për ujitjen e tokave bujqësore (rezervuari i Shtodrit)

Investimet kryesore gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 janë: “Mbrojtje bregu nga gerryerjet e lumit Drin në Bahcallek, Bashkia Shkodër (azhurnim 2024) faza I” me vlerë 195,911 mijë lekë dhe ”Rehabilitim i kanalit ujitës Shelqet-Pistull, L=4.555km” në bashkinë Vau Dejës me vlerë 51,518 mijë lekë.

Investimet të cilat janë në proces (2025-2026) janë: “Mbrojtje bregu nga gerryerjet e lumit Kir (ish fusha e Druve), Bashkia Shkodër me vlerë 102,802 mijë lekë dhe ”Rehabilitim i kanalit ujitës Shelqet-Pistull, faza II, P.K 102-166 L=1.7 km në bashkinë Vau Dejës me vlerë 19,505 mijë lekë.

#### IV.1.9. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë

Zyra e Administrimit të Basenit Lumor Drin-Bunë, gjatë vitit 2025, ka realizuar detyrat e saj në mbështetje të ligjit Nr.29/2024 “Për Burimet Ujore”, VKM nr.335 datë 19.06.2025 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, të VKM-së VKM-së Nr.319 datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me konçesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim të burimit ujor...”, në vendimin e K.K.U-së nr. 06 datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Lumor " si dhe të planeve të punës të hartuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025.

KBL Drin-Bunë gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 ka zhvilluar 6 mbledhje të Këshillit si më poshtë;

**1-Datë 20.02.2025**, ku janë miratuar; ku janë miratuar; 1- Leje "Për miratimin e Lejes për përdorim Burimi Ujor nëntokësor", për qëllime industriale, subjektit "Sabina 2020"shpk me vendodhje Beltojë, Nj.A.Bërdicë, Bashkia Shkodër dhe 1-Leje "Për miratimin e Lejes për përdorim Burimi Ujor nëntokësor", për qëllime industriale, subjektit "FLOROS"shpk me vendodhje Lagjia Shimaj, Nj.A. Bushat,Bashkia Vau i Dejës, Shkodër,.

**2-Datë 11.03.2025**, ku janë miratuar ; 2-Leje për përdorim Burimi Ujor sipërfaqësor", për prodhim hidroenergjetik, me vendodhje në përroin e Kasajve dhe Trezhinievës, degë e lumit Bushtricë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, Subjekti "Troijet Energy" shpk/ Hec Trojet (niveli 1) dhe Hec Trojet (niveli 2), 1-Vendim "Për miratimin e kërkesës për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin , rindërtimin apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave, veprave të mbrojtjes nga përmytjet, e veprave të tjera në brigje me vendodhje , lumi Drin, Bahçallëk, Shkodër, Bordi i Kullimit (Lezhë), 1-Vendim "Për miratimin e kërkesës për saktësimin e kordinatave dhe transferim të lejes miratuar me vendim nr.03 datë 27.07.2007, nga subjekti "Briland"shpk tek subjekti "Briland Kasemi"P.F.,

**3-Datë 08.07.2025**, ku janë miratuar ; 1-Vendim për miratimin e propozimit për z.Alban Preka, përfaqësues i bashkisë Shkodër si nën Kryetar i KBL Drin-Bunë, 1-Vendim "Për Miratimin e Lejes për Përdorim Burimi Ujor Nëntokësor për Ujë të Ambalazhuar”, me vendodhje Nj.A.Qelëz, Bashkia Pukë, 1-Vendim "Për Miratimin e kërkesës “Për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar në rastin kur përdorimi është për  $\leq 150$  shishe/orë,  $\leq 1$  l/sek”, të subjektit “Murana” sh.p.k, me vendndodhje: Fshati Vrrith, Njësia Administrative Qerret, Bashkia Pukë, 1-Vendim "Për miratimin e autorizimit për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim,me vendodhje deti Adriatik, Velipojë , Bashkia Shkodër, 11-Vendime "Për Revokimet e lejeve të miratuar nga KBU Drin-Bunë me datë 13.03.2013 “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike, Subjektit “TELEMANIA-ALB” sh.p.k/ për 11 Hec-e dhe 1-Vendim për shtyrjen për një shqyrtim të mëvonshëm të kërkesës për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, me vendodhje lumi Drin, Bashkia Vau-Dejës.

**4-Datë 13.08.2025**, ku është miratuar ; 1-Vendim "Për miratimin e autorizimit për veprimtari te tjera ne brigje dhe ne shtratin e burimit ujore për subjektin "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SH.A),"me vendodhje Përroi i Gomsiqes, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër.

**5-Datë 13.10.2025**, ku janë miratuar ; 1-Vendim "Për Miratimin e kërkesës për autorizim, për

përdorim burimi uJOR, për ndërtim, Rindërtim,apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve e veprave të tjera në brigje, me vendodhje lumi Drin, Bashkia Vau-Dejës, Subjektit "Bashkia Vau-Dejës.", 1- Vendim "Për Miratimin e kërkesës për autorizim, për përdorim burimi uJOR, për ndërtim, Rindërtim,apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave, veprave të mbrojtjes nga pëmblytjet, e veprave të tjera në brigje, me vendodhje lumi Kir, Bashkia Shkodër, Subjektit "Bordi i Kullimit Lezhë", 1- Vendim "Për Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit lidhur me rinovimin e lejes "Për leje për përdorim burimi uJOR nëntokësor për qellime turistike", subjektit "Luani A"shpk dhe 1- Vendim "Për korrigjimin e gabimit në vendimin nr. 13 datë 30.07.2024 dhe lejes me nr. Serial 000208 "Për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik", me vendndodhje: Përroi i Hetmit dhe Përroi i Sheshit të Vogël, Njësia Administrative Fushë-Bulqizë, Qarku Dibër". Subjektit "ERIM"shpk/ HEC SHYTAJ

**6-Datë 17.12.2025**, ku janë miratuar ; 2-vendim /leje për prodhim energjie, 1- vendim për miratimin e kërkesës për transferimin të lejes, 1-vendim "Për shfuqizimin e Lejes së përdorimit të ujit për prodhim energjie, 1-vendim për leje "Për miratimin e kërkesës për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi).

Viti 2025 "Mbledhjet KBL-së"

Nr	Data e mbledhjeve	Leje h/c	Teknologjik.	Te tjera	Inbotilim	UK	Akalkulture	Vepr. brigje	Blegtori	Transferim	Ndryshime leje	Pezullim/anullim/	Turistike	Vendim	Total.
1	20.02.2025	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
2	11.03.2025	2	0	0	0	0	0	1	0	1	0	0	0	0	4
3	08.07.2025	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	11	1	1	15
4	13.08.2025	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
5	13.10.2025	0	0	0	0	0	0	2	0	0	1	0	1	0	4
6	17.12.2025	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	2	4
<b>Totali</b>		<b>2</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>30</b>

➤ ZABL Drin-Bunë, për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar 197 kontrole dhe monitorime në subjektet që janë të pajisur me leje nga KBL Drin-Bunë për përdorim të burimeve Lumore në të gjithë basenin tonë;

- Monitorimet dhe kontrollet në subjektet që janë të pajisur me leje nga KBL Drin-Bunë për përdorim të burimeve Lumore në të gjithë basenin tonë detajon si vijon;

-116 monitorime në subjektet që janë të paisur me leje për prodhim prodhim hidroenergjie,

-81 monitorime në subjektet që përdorin ujin për veprimtari të ndryshme.

➤ ZABL Drin- Bunë ka marrë pjesë aktive në të gjitha seminarët dhe takimet e organizuara në rang qarku mbi problematikat e ndryshme në basenin tonë.

➤ ZABL Drin- Bunë nuk ka pasur çështje gjyqësore që i përkasin basenit Drin-Bunë për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

➤ Janë ndjekur në terren ankesat e ardhura nga institucione dhe individë. Janë hartuar relacionet përkatëse dhe përgjigjet brenda afateve ligjore.

➤ Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 janë prerë 232 fatura ku faturimet bëhen mbi procesverbalet e leximeve të matësave dhe nga deklaratimet e sjella nga subjektet.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ZABL Drin-Bunë ka planifikuar të realizojë të ardhurat nga subjekte që operojnë në basenin Drin-Bunë dhe që janë të pajisura me leje nga KBL –ja në vlerën **131,720,000lekë**. Gjatë vitit 2025, ZABL Drin- Bunë ka realizuar faturime në vlerën **95,126,744 lekë** ose **72.22%** e planifikimit. Po të bëjmë krahasimin plan/faturim kemi një zvogëlim të faturimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025 dhe kjo ka ardhur kryesisht nga subjekti KESH Sh.a nuk ka deklarimin për prodhimin e energjisë që nga muaji Korrik 2025 si dhe mos faturimi i HEC-ve private duke u bazuar në vendimin Kolegjtit Administrativ i Gjykatës së Lartë me date 28.05.2025 i cili ka shfuqizuar VKM nr.993, datë 09.12.2020 vetëm për sa i përket tabelës nr.1, pikës 6 “Përdorim burimi ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik kur përdoruesi është shoqëri private 2.3% e çmimit të shitur për çdo kë/orë të prodhuar”.

ZABL Drin -Bunë ka arkëtuar për periudhën Janar- Nëntor 2025 të ardhura në vlerën **52,855,955.lekë** (të ardhurat e muajit Dhjetor 2025 rakordohen në muajin Janar 2026) .

ZABL Drin-Bunë sipas rakordimeve që bën me subjektet pret rritjen e të ardhurave nga derdhjet e bëra gjatë periudhës në vazhdim dhe nga shlyerja e debive nga përdoruesit e ujit edhe nga prodhuesit e energjisë.

Evidenca e të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2025 .

Nr	Instiutucioni	Të ardhura Periudha Janar-Dhjetor 2025		
		Planifikimi për Janar- Dhjetor 2025	Faturime të bëra për Janar-Dhjetor 2025	Realizimi për Janar- Nëntor 2025
1	Zyra e Administrimit të Basenit Lumor Drin-Bunë Shkodër	131,720,000	95,096,388	52,855,955

Arkëtimi për periudhën Janar-Dhjetor 2025, rezulton në vlera të ulta në krahasim me faturimet e realizuara për arsye se subjekti KESH Sh.a nuk ka bërë likujdim të detyrimeve per periudhem Janar-Qershor 2025.Kjo ka sjelle edhe ulje e të ardhurave sepse është një ndër subjektet qe rrit ndjeshëm arkëtimin e të ardhurave sepse është edhe perdoruesi më i madh i burimit ujq për hidroenergji.

Gjithashtu një arsye e arkëtimeve të ulta për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është edhe vendimi Kolegjtit Administrativ i Gjykatës së Lartë me date 28.05.2025 i cili ka shfuqizuar VKM nr.993, datë 09.12.2020 vetëm për sa i përket tabelës nr.1, pikës 6 “Përdorim burimi ujq sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik kur përdoruesi është shoqëri private 2.3% e çmimit të shitur për çdo kë/orë të prodhuar”.

#### IV.1.10. Administrata e Zonave të Mbrojtura

Gjatë këtij viti (Janar – Dhjetor 2025) janë konstatuar disa raste dëmtimesh (dëmtime në fondin pyjor, ndotje, gjeuti e paligjshme, etj ) në Zonat e Mbrojtura të Qarkut Shkodër.

- Në Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” kemi pasur 19 (nëntëmbëdhjetë) procesverbale vlerësimi dëmi , 18(tetëmbëdhjetë) raste kundravajtje administrative dhe 1(një) rast kallëzim penal.
- Në Parkun Natyror “Lugina e Shalës” janë mbajtur 2(dy) procesverbale vlerësimi dëmi dhe 2(dy) raste vlerësimi dëmi.
- Në Peizazhin Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna – Velipojë” kemi pasur 9 (nëntë) raste, nga këta 1 (një) penal dhe 8 (tetë) kundravajtje administrative.
- Në RNM “Liqeni i Shkodrës“ është mbajtur 1(nje) procesverbal vlerësimi dëmi, rast administrativ.
- Në Parkun Natyror „Munelle“ janë mbajtur 2 procesverbale vlerësimi dëmi nga 2 kontatime, 1 (nje) rast është kallëzim penal ndërsa rasti tjetër është kundravajtje administrative.


Janë kryer monitorime të vazhdueshme për mbrojtjen e ZM-ve dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në ZM.

Administrata e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Shkodër ka zbatuar një sërë marrëveshesh dhe akteve bashkëpunimi me institucione vendore për mbrojtjen e zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit. Veprimtaritë kryesore përfshijnë marrëveshje dhe bashkëpunime:

1. **Me bashkitë e Qarkut Shkodër:** Bashki Shkodër, Malësi e Madhe, Vau Dejës, Fushë-Arrëz, Pukë, si dhe njësitë administrative brenda tyre.
2. **Me institucione arsimore:** Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë dhe Zyrat Vendore Arsimore Shkodër dhe Malësi e Madhe, për zhvillimin e edukimit mjedisor në shkolla, Brenda territorit të zonave të mbrojtura.
3. **Me Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër:** Për monitorime të përbashkëta për kundravajtjet e ndryshme në zonat e mbrojtura (gjueti, prerje, gërmime, etj.).
4. **Me njësitë administrative dhe zjarrfikëset:** Për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri dhe ngritjen e skuadrave zjarrfikëse.
5. **Me Prefekturën e Qarkut Shkodër:** Bashkëpunim për monitorimet kundër kultivimit të bimëve narkotike brenda territorit të zonave të mbrojtura dhe mbështetje logjistike e burime për Komitetet e Mbrojtjes Civile dhe Menaxhimit të Turizmit.

AdZM Shkodër ka treguar angazhim të vazhdueshëm për të rritur mbrojtjen mjedisore përmes bashkëpunimit të gjerë me institucionet vendore dhe rajonale, duke përmirësuar menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe duke sensibilizuar publikun për rëndësinë e tyre.

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e vizitorëve në Zonat e Mbrojtura (ZM) gjatë periudhës 2017-2025. Në këto vite, vërehet një rritje e vazhdueshme në numrin e vizitorëve, duke reflektuar interesin në rritje për këto zona.



Në periudhën kohore 2017-2020, numri i vizitorëve filloi nga 576,700 në vitin 2017 dhe arriti kulmin e parë në vitin 2019 me 849,000 vizitorë. Në vitin 2020, për shkak të pandemisë COVID-19, numri ra në 673,090. Pas vitit 2020, pati një rikuperim të ndjeshëm. Në vitin 2023, numri arriti në mbi 1 milion vizitorë (1,078,320) ndërsa në vitin 2024 me 1,277,267 vizitorë dhe për vitin 2025 ky numër raportohet 1,298,200 ndër të cilët 785,820 vizitorë vendas dhe 512,380 vizitorë të huaj.

Rritja e vizitorëve tregon një ndërgjegjësim dhe vlerësim të shtuar për rëndësinë e zonave të mbrojtura si destinacione natyrore dhe turistike. Kjo rritje lidhet me përmirësimin e infrastrukturës, edukimin mjedisor dhe përmirësimin e menaxhimit të këtyre zonave.

#### IV.1.11. Arsimi

Nga ana e bashkive në zbatim të detyrimeve ligjore dhe përbushjes së detyrave funksionale, në fillim të vitit shkollor 2025-2026, janë marrë masat për rikonstruksionin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe ambienteve shkollore, si dhe krijimin e kushteve infrastrukturore për fillimin, vijimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Gjendja e infrastrukturës së shkollave në prag të fillimit të procesit mësimor në përgjithësi paraqitej e mirë dhe plotësonte kushtet higjieno-sanitare dhe të sigurisë.

Janë realizuar dhe janë në proces të vazhdueshëm punime rikonstruksioni, përmirësim i ambienteve dhe infrastrukturës në objektet e shkollave. Sipas informacionit të dërguar pranë institucionit të Prefektit Shkodër janë kryer punimet e mirëmbajtjes dhe lysterjes së objekteve të shkollave në të gjitha bashkitë (*sistemim i ambienteve të brendshme dhe të jashtme; lysterje e ambienteve të brendshme; sistemim i rrjetit elektrik dhe atij hidraulik, riparime të detyrës dhe dritareve, të mobiljeve, pastrime oborresh, riparime të çatave, riparime të pompave të ujit, shërbimeve higjieno-sanitare, etj*).

Në lidhje me kushtet higjieno-sanitare, në fillim të vitit shkollor janë shpërndarë në të

gjitha shkollat e Bashkisë Shkodër materiale pastrami dhe higjeno-sanitare. Gjithashtu është bërë shpërndarje e materialeve të kancelarisë, si dhe shpërndarja falas e teksteve shkollore për nxënësit e arsimit bazë, kl. I-IX, dhe për kategoritë e veçanta në arsimin e mesëm, në zbatim të vendimit të qeverisë.

Nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit, në Bashkinë Shkodër, janë marrë masa për të mundësuar ngrohjen në të gjitha shkollat. Për rritjen e sigurisë dhe garantimin e shëndetit të nxënësve dhe personelit mësimor është bërë zëvendësimi nga ngrohja me gaz në sistem tjetër ngrohjeje (kaldajë, ose soba me dru zjarri),

Nga ana e Zyrave Vendore Arsimore dhe Bashkive janë marrë masa për plotësimin e shkollave me personelin mësimor dhe mbështetës, dokumentacionin e domosdoshëm, si dhe ofrimin e shërbimit të pastrimit, furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.

Nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë, AKU, IKMT dhe institucione të tjera, janë marrë masa me qëllim garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset shkollore dhe hapësirat përreth tyre. Janë marrë masa në vendosjen e sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale, vendosjen e kamerave të sigurisë dhe pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla, kontrolli i vazhdueshëm i kushteve të sigurisë ushqimore dhe pajisjen me licence të operatorëve të bizneseve ushqimore që veprojnë në perimetrin përreth shkollave.

Janë marra masa për shtimin e oficerëve të sigurisë, të cilët raportojnë çdo javë pranë Zyrave Vendore Arsimore të dhëna për raste konfliktuale të ndodhura në ambientet shkollore. Numri total i Oficerëve të Sigurisë është **17** (*Bashkia Shkodër 13, Bashkia Malësi e Madhe 3, Bashkia Vau Dejës 1*)

Nga ana e shërbimeve të policisë së DVP Shkodër janë marrë të gjitha masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, mbajtjen në kontroll të situatës në institucionet arsimore të Qarkut Shkodër. DVP Shkodër ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet arsimore duke zhvilluar takime dhe aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla. Janë marrë masa për funksionimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të numrave emergjentë.


Nga të dhënat e Zyrave Vendore Arsimore, në Qarkun Shkodër janë gjithsej **190 shkolla** publike/jo publike, dhe **4 shkolla profesionale** (94 në Bashkinë Shkodër, 25 në Bashkinë Vau i Dejës, 30 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 41 në Bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz.)

Institucioni Vartës	Numri i shkollave
ZVA Shkodër	94
ZVA Malësi e Madhe	30
ZVA Vau Dejës	25
ZVA Pukë – Fushë Arrëz	41

Numri i nxënësve në Qarkun Shkodër për vitin shkollor 2025-2026 është **19.504 nxënës** (14.459 nxënës në Bashkinë Shkodër, 1.962 në Bashkinë Vau i Dejës, 2.082 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 572 në Bashkinë Pukë dhe 429 në Bashkinë Fushë Arrëz). Ky numër rezulton të

jetë më i lartë sesa vitin e kaluar (16.394 nxënës), me një diferencë prej 3.110 nxënës më shumë, ose 19% më shumë.

BASHKIA	CIKLI 9-VJEÇAR	CIKLI MESËM	TOTAL
Shkodër	11.189	3.670	14.459
Malësi e Madhe	1.663	419	2.082
Vau Dejës	1.573	353	1.962
Pukë	448	124	572
Fushë Arrëz	344	85	429



Numri total i punonjësve mësimor dhe mbështetës për ciklin 9-vjeçar dhe të mesëm në shkallë qarku është **2.576**.

Pavarësisht masave të marra dhe punës së realizuar, akoma evidentohen problematika të cilat ndikojnë në ecurinë normale të procesit mësimor, si:

- Mungesë të sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në afërsi të shkollave, në zonat periferike të bashkive;
- Pajisja me kamerat e sigurisë në ambientet shkollorë dhe perimetrat rrethues të sigurisë (kryesisht bashkitë e vogla)
- Mungesa e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm kryesisht në zonat malore, si dhe kushtet higjieno-sanitare
- Sigurimi i shërbimit të transportit të nxënësve nga vendbanimi në shkollë.

- Mungesa e mureve rrethuese të oborreve të institucioneve arsimore

Në këtë kuadër, Prefekti i Qarkut Shkodër, në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale, është angazhuar në bashkërendimin e veprimtarsë me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore në nivel vendor dhe rajonal, inspektoratet përgjegjëse për monitorimin e kushteve higjieno-sanitare, shërbimit ushqimor dhe kontrollit të perimetrave rrethues të institucioneve arsimore, si dhe me Drejtorinë Vendore të Policisë. Ky koordinim është realizuar me qëllim zbatimin e detyrimeve ligjore përkatëse sipas fushave të përgjegjësisë, garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor, si dhe sigurimin e një informacioni të përditësuar në funksion të rritjes së sigurisë dhe parandalimit të kriminalitetit në mjediset shkollore dhe hapësirat përreth tyre, në kuadër të zbatimit të “*Paketës së Sigurisë në Shkollë*”.

Për sa më sipër, është monitoruar periodikisht informacionin i përcjellë në fillim të vitit shkollor 2025 (muaji shtator) dhe në vijim, me fokus të veçantë në nivelin e përmbushjes së standardeve dhe normave të sigurisë, konkretisht në aspekte të tilla si:

- Sinjalistika e plotë rrugore pranë çdo institucioni të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, privat dhe publik (*si dhe arsytën e mos plotësimin të tyre nëse ka*)
- Vendosjen e kamerave të sigurisë dhe pajisjeve për shuarjen e zjarrit (*si dhe arsytën e mos plotësimin të tyre nëse ka*)
- Plotësimin e kushteve të sigurisë ushqimore dhe pajisjen me licencë të operatorëve të bizneseve ushqimore, si dhe ndalimin e tregtimit të mallrave të dëmshëm apo të palejuara në afërsi të shkollave (*si dhe arsytën e mos plotësimin të tyre nëse ka*)
- Situatën aktuale të ndërtimeve të paligjshme dhe lirim të hapësirave publike të parashikuar në perimetrin e sigurisë së shkollave (*nëse ka raste, a janë referuar inspektoriateve përgjegjëse dhe çfarë masash janë marrë*)
- Të dhëna lidhur me Oficerët e Sigurisë në shkollë (*emër, mbiemër; kontaktet, shkolla/shkollat që mbulon*) si dhe çdo informacion tjetër mbi performancën e tyre në zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuar në VKM Nr.600, dt.9.10.2018 “*Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kritereve për oficerët e sigurisë*” si dhe Urdhërit Nr.413, dt.26.08.2025 të MAS për miratimin e “*Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë (rishikuar)*”
- Numrin e rasteve të konflikteve të ndodhura brenda ambjenteve apo perimetrave të sigurisë së shkollave, si dhe masat e marra në këto raste
- Çdo problematikë tjetër, të evidentuar gjatë inspektimeve, që kanë të bëjnë me garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset e shkollave dhe hapësirat përreth tyre.

Mbi bazën e vlerësimit të masave të ndërmarra, si dhe të analizës së gjendjes aktuale në institucionet arsimore parashkollore dhe parauniversitare, publike dhe jopublike, përfshirë edhe konviktet që funksionojnë në varësi të këtyre institucioneve, dhe në zbatim të normave dhe standardeve ligjore në fuqi, me qëllim garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset shkollore dhe në hapësirat përreth tyre, Prefekti ka lënë detyra

konkrete institucioneve ligjzbatuese, dhe afate kohore në përmbushje të:

- **Rritjes së nivelit të angazhimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional** ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve arsimore, Drejtorisë Vendore të Policisë dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, me qëllim zbatimin korrekt dhe në kohë të detyrimeve ligjore, si dhe bashkërendimin efektiv të veprimeve në kryerjen e detyrave të përbashkëta në fushën e arsimit, veçanërisht në aspektet që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.
- **Marrjen e masave të nevojshme nga bashkitë**, për plotësimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të të gjithë elementëve të sigurisë, si *kamera sigurie, pajisje për shuarjen e zjarrit, impiante elektrike dhe elementë të tjerë të domosdoshëm*, në përputhje me kushtet dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për të gjitha institucionet arsimore, pavarësisht nga numri i nxënësve të regjistruar dhe që ndjekin procesin mësimor, brenda territorit të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore. Për këtë qëllim, të parashikohen fonde të posaçme buxhetore gjatë vitit kalendarik, në mënyrë që të sigurohet zbatimi në kohë dhe efektiv i procedurave përkatëse.
- **Janë evidentuar raste sporadike të prezencës së kamerave** në oborret e institucioneve arsimore ose brenda perimetrave të sigurisë, për të cilat drejtuesit e shkollave deklarojnë mungesë informacioni lidhur me administrimin dhe funksionimin e tyre. Në këtë kuadër, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për verifikimin e këtyre pajisjeve nga organet kompetente dhe, në varësi të konstatimeve të kryera, ndërmarrja pa vonesë e veprimeve të nevojshme administrative dhe ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- **Marrjen e masave të nevojshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore**, për garantimin e furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm, si dhe për sigurimin dhe përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare në të gjitha institucionet arsimore. Po ashtu, të sigurohet pajisja e këtyre institucioneve me çertifikatë D.D.D., si dhe me Akt-Miratimin Higjieno-Sanitar, në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
- **Marrjen e masave të menjëhershme nga Inspektoratet e Mbrojtjes së Territorit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore**, për zgjidhjen përfundimtare të problematikës së portave hyrëse/dalëse të familjarëve brenda perimetrave rrethues të sigurisë së institucioneve arsimore, në përputhje me sinjalizimet dhe konstatimet përkatëse. Gjithashtu, të sigurohet informimi i Prefektit të Qarkut mbi ecurinë dhe fazat e zgjidhjes së kësaj problematike, deri në përfundimin e plotë të saj.
- **Marrjen e masave të duhura nga institucionet arsimore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë**, në bashkëpunim edhe me komunitetin lokal, për garantimin e rendit dhe sigurisë në shkolla. Këto masa përfshijnë organizimin periodik të takimeve me bordet mësimore, prindërit dhe nxënësit, me qëllim rritjen e

ndërgjegjësimit, koordinimin e veprimeve dhe parandalimin e situatave që mund të çenojnë sigurinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.

- **Marrjen e masave nga strukturat e policisë**, përmes Policisë së Qarkullimit Rrugor, grupeve të patrullimit dhe strukturave të tjera të përfshira, për disiplinimin e trafikut në afërsi të institucioneve arsimore, me një vëmendje të veçantë gjatë orarit të fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor. Kur është e mundur, të vendosen sinjalizime detyruese për devijimin e trafikut në orare të caktuara, veçanërisht për shërbimet e urgjencës. Këto veprime të zhvillohen sipas një plani të bashkërenduar me policinë bashkiake, duke marrë parasysh sinjalizimet nga institucionet arsimore dhe burime të tjera informacioni, dhe duke realizuar patrullime të shtuar në zonat e identifikuara si “problematike”.
- **Përcjelljen dhe sinjalizimin e informacionit në kohë reale** nga Drejtoritë e shkollave, si dhe nga Oficerët e Sigurisë dhe shërbimet policore, për çdo problematikë që lidhet me garantimin e rendit dhe sigurisë në institucionet arsimore. Po ashtu, të kryhet verifikimi i zbatimit të funksioneve të Oficerëve të Sigurisë, sipas përcaktimeve të Urdhërit Nr. 413, datë 26.08.2025 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për miratimin e “Udhëzuesit për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë (rishikuar)”, në mënyrë që të sigurohet funksionimi efektiv i këtij mehanizmi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të sigurisë në shkolla.
- **Kushtimi i vëmendjes së veçantë “Instrumentëve Matës”**, përmes përdorimit të pyetësorëve sipas formateve të përcaktuara në ANEKSIN I, si një element kyç në realizimin e detyrave funksionale të Oficerëve të Sigurisë, me qëllim garantimin e nivelit të lartë të sigurisë në ambjentet e shkollave. Për kryerjen e matjeve të përcaktuara për qëllime profesionale, të sigurohet bashkëpunim i ngushtë me shërbimin psiko-social pranë institucioneve arsimore, në mënyrë që të analizohet dhe të interpretohet informacioni i mbledhur dhe të merren masat përkatëse për përmirësimin e sigurisë.
- **Vazhdim të programimit dhe kryerjes së kontrolleve dhe inspektimeve të rregullta nga Dega Rajonale e ISHSH**, gjatë gjithë vitit shkollor, në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike, për verifikimin e plotësimit të kushteve higjieno-sanitare në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara. Po ashtu, të vijojë monitorimi i subjekteve tregtare në afërsi të shkollave, me qëllim zbatimin e ligjit Nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, si dhe të ligjit Nr. 9518, datë 18.04.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit dhe produkteve të tjera të dëmshme”. Këto veprime kanë për qëllim garantimin e një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm për nxënësit dhe personelin mësimor
- **Hartimin e një plani pune të përbashkët ndërinstitucional**, me detyra të qarta dhe të specifikuar për çdo aktor, duke përfshirë inspektime dhe verifikime në terren, si pas sinjalizimeve të marra, ashtu edhe në mënyrë periodike. Plani duhet të ketë fokus të veçantë në fushat që janë identifikuar si më problematike, në mënyrë që të sigurohet

një koordinim efektiv ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe të rritet niveli i sigurisë dhe rendit në ambientet shkollore dhe në hapësirat përreth tyre.

- **Raportim periodik mbi ecurinë e zbatimit të detyrave të përcaktuara**, nga ana e bashkive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, të dërgohet rregullisht tek Institucioni i Prefektit, brenda afateve të përcaktuara. Ky raportim duhet të jetë i hollësishëm dhe i detajuar, duke pasqyruar progresin, masat e ndërmarra, si dhe çdo vështirësi të konstatuar gjatë zbatimit të detyrave, në mënyrë që të mundësohet monitorim i vazhdueshëm dhe ndërhyrje e shpejtë kur është e nevojshme.
- **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)** të mbetet i angazhuar për ndërhyrje të menjëhershme në rastet kur evidentohen problematika që përbëjnë rrezik për shëndetin e konsumatorëve, veçanërisht për fëmijët, bazuar në ankesa, sinjalizime apo njoftime nga institucionet përkatëse. Me rifillimin e plotë të aktivitetit të AKU-së, monitorimi i subjekteve ushqimore pranë institucioneve arsimore të jetë një nga prioritetet kryesore, me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

#### IV.1.12. Shërbimi Shëndetësor

Veprimtaria e institucioneve shëndetësore për zbatimin e detyrimeve ligjore është ofrimi i shërbimit shëndetësor nëpërmjet kujdesit shëndetësor dhe spitalor Drejtoria Rajonale e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Shkodër përfshin qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës.

Gjatë vitit 2025, DROSHKSH ka pasur në fokus monitorimin periodik të qendrave shëndetësore, duke përfshirë pajisjet, medikamentet dhe shërbimet, për të garantuar kujdes parësor cilësor.

Shërbimi spitalor në nivel qarku ofrohet nga Spitali rajonal Shkodër, Spitali Ditor Malësi e Madhe dhe Qendra Spitalore Pukë. Numri total i shtretërve për qarkun është 478 në spitalin Rajonal Shkodër dhe 68 në Qendren Spitalore Pukë, Spitali Ditor Malësi e Madhe funksionon vetëm si Urgjencë, nuk ofron shërbim me shtretër dhe nuk aplikon asnjë nga treguesit e aktivitetit spitalor.

Spitali Rajonal Shkodër është i organizuar dhe ofron shërbime të kategorisë së spitalit të përgjithshëm me një numër total të përgjithshëm prej 478 shtretërisht dhe me një personel shëndetësor prej 106 mjekësh dhe 343 personel teknik të shkencave mjekësore. Aktualisht nuk ka mungesa të burimeve njerëzore në asnjë specialitet. Shërbimet shëndetësore në spitalin rajonal të Shkodrës janë të organizuara në nivele të ndryshme dhe të kategorizuara si shëndetësore me shtretër, shërbime pa shtretër si dhe shërbime ndihmëse.

Qendra Spitalore Pukë mbulon me shërbime spitalore një popullsi prej rreth 20,000 banorë me një personel shëndetësor prej 8 mjekë dhe 100 personel teknik të shkencave mjekësore. Shërbimet spitalore mbulojnë nga 68 shtretër në të gjithë spitalin dhe janë të tipit të shërbimeve të nivelit bashkiak.

Spitali Ditor Malësi e Madhe është parashikuar të mbulojë me shërbime spitalore një popullsi prej 32,000 banorësh me paketën e shërbimeve të një spitali ditor. Në këtë spital ka 3 mjek të

punësuar dhe 13 personel teknik i shkencave mjekësore.

Në zbatim të planit vjetor të monitorimit për spitalet në qark janë kryer gjithsej 8 monitorime përfshirë edhe Njësine e Trajtimit me Metadonpranë Poliklinikës së Spitalit Rajonal Shkodër.

Gjatë vitit 2025 në sistemin me shtretër vlen të theksohet si risi fakti që me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Spitali Rajonal Shkodër do mbulojë ofrimin e Shërbimit të angiografisë koronare dhe angioplastikës koronare, 24 orë në 7 ditë të javës për pacientë me nevoja urgjente dhe të planifikuara sipas indikacioneve klinike.

Përsa i përket Sezonit turistik, këtë vit janë hapur gjithsej 10 (dhjetë) pika verore në të gjithë rajonin e varësisë, nga këto 5 (pesë) përfshihen në Qarkun Shkodër si Velipoje; Rrjoll, Theth, Tamarë, Razëm si dhe qendra e re e hapur këtë vit për herë të parë në Bogë. Aktiviteti i QSH-ve verore këtë vit ka qënë më i lartë këtë vit në krahasim me vitin e kaluar. Rritja e numrit të vizitave ka ndodhur për arsyen e rritjes së numrit të pushuesve që kanë frekuentuar pikat tona turistike si dhe si rezultat i gatishmërisë që ka paraqitur stafi mjeksor dhe infermjeror në ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor dhe në kohë ndaj pushuesve nëpër QSH-të respektive si dhe vala e virozave që kaluam gjatë gjithë sezonit veror.

Nga DROSHKSH Shkodër me qëllim menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor janë rekrutuar për vitin 2025, 25 mjekë dhe 97 infermiere.

#### **IV.1.13. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**

Drejtoria Rajonale ISHPSHSH Rajoni V Shkodër, për kryerjen e veprimtarisë së saj ka bashkëpunuar me keto institucione: Drejtoria Rajonale Tatimore, Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, AKU, Drejtoria Rajonale e Shërbimi Kombëtar të Punësimit, Spitalin Rajonal Shkodër, Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 jane kryer **399 inspektime** nga të cilat;

1. Subjekte të Programuara	275 inspektime
2. Subjekte Rastësore	10 inspektime
3. Subjekte Aksidente	12 inspektime
4. Subjekte Ankese	18 inspektime
5. Subjekte me urdhër të posacem	79 inspektime
6. Subjekte per punesim të miturish	5 inspektim

Në total me një numër punëmarrësish prej 5124, nga të cilët 144 punëmarrës të padeklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore, të cilët u futen në skemë brenda afatit të procedurës së inspektimit.

Për shkeljet e legjislacionit të punës, të gjetura nga inspektimet e kryera, janë marrë masa:

- Masa urgjente për marrëdhëniet e punës	20
- Masa urgjente për sigurinë dhe shëndetin në punë	7
- Paralajmërim në punë	11
- Vendosje gjobë	13

Drejtoria rajonale e ISHPSHSH gjatë vitit 2025 ka trajtuar 18 ankesa të ardhura nga sli.gov.al dhe nga bashkëqeverisja, ku shumica e të cilave janë zgjidhur në favor të punëmarrësve.

#### **IV.1.14. Dega Rajonale e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore (Ligji Nr. 10433 datë 16.11.2011 “Për inspektimin në RSh”; Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semuindjeve infektive”, me ndryshime; Nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM Nr. 241, datë 27.03.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e ISHSH”, arritjes së objektivave, për rritjen e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit nga rrisqet dhe kërcënimet e mundshme dhe planeve të hartuara e miratuara, sipas çështjeve me tematikat, janë ushtruar në total **2.120 inspektime** ndër të cilat 1.945 inspektime dhe 175 ri-inspektime.

- 1.959 inspektime sipas programit të inspektimit
- 161 inspektime jashtë programit të inspektimit (95 inspektime dhe 66 ri-inspektime)

Janë kryer 1.469 inspektime në qendrat e kujdesit të fëmijeve, në qendrat e kujdesit të moshuarve, tregtimi i kozmetikës, duhanit dhe alkoolit, arsim, subjekte akomodim, farmaci, pishina, bare, restorante dhe shëndeti në punë. Janë kryer 490 inspektime shëndetësore në shërbimet spitalore publike dhe jopublike dhe 161 inspektime jashtë programit të inspektimit.

Gjatë vitit 2025 trupat inspektuese të ISHSH, dega rajonale Shkodër kanë vendosur në total 36 masa administrative prej të cilave:

- 7 gjoba me vlerë 630,000 leke;
- 3 vendime të ndërmjetme dhe
- 26 Paralajmërime të specifikuara në fushat përkatëse.

Kërkesat pranë ISHSH kanë të bëjnë më së shumti me kërkesat për tu pajisur me Akt-miratim Higjeno-sanitar dhe kërkesa për akreditim. Që nga muaji maj 2022, ky shërbim ofrohet vetëm online nëpërmjet portalit e-Albania. Shqyrtimi i tyre është realizuar në kohë. Për vitin 2025 janë lëshuar në total **156 Akt-miratime higjeno-sanitare** nga të cilat 84 me kërkesë të subjektit. Gjithashtu janë realizuar dhe 3 inspektime me kërkesë për akreditimin dhe disa denoncime/ raste flagrante të përmendura në fushat përkatëse.

#### **IV.1.15. Drejtoria Rajonale e IKMT**

Në zbatim të detyrimeve ligjore Drejtoria Rajonale e IKMT gjatë vitit 2025, ka përmbushur detyrat institucionale për:

Spektori i Inspektimit të Territorit për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar gjithsej **46 inspektime** në territor, duke përfshirë kontrolle në zona urbane dhe rurale si Velipoja, Thethi, Bogë, Hani i Hotit, Muriqani, zona e Komanit dhe vijën bregdetare. Janë evidentuar dhe dokumentuar ndërtime pa leje, në Velipojë dhe disa subjekte në Bogë, Theth, dhe zona të tjera. Mbështetje e IKMT Qendër në ekzekutimin e vendimeve të prishjes së objekteve të kundërligjshëm të konstatuara në akset rrugore Paçram-Harku I Bërdicës dhe 5 heronjtë (Dobraç-Hani Hotit). Janë mbajtur procesverbale për shkelje të ndryshme dhe janë ndërmarrë masa ligjore për prishjen e objekteve pa leje, shpesh në bashkëpunim me IKMT Qendër dhe IMT Bashkia Shkodër. Mbështetje e IKMT Qendër në ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme në Shirokë. Janë realizuar kontrolle në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për evidentimin e strukturave të paligjshme dhe ndërhyrje në terren në Liqenin e Shkodrës. Janë trajtuar gjithsej 47 ankesa nga qytetarët dhe institucionet.

Shumica e ankesave lidhen me ndërtime pa leje, dhe shumë prej tyre janë adresuar te IMT Bashkia Shkodër për kompetencë.

Janë realizuar kontrolle në lidhje me projekte infrastrukturore, për shembull rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe monitorimi i objekteve që preken nga ky projekt.

Në bashkëpunim me sektorë të tjerë, janë zbatuar masa për sigurinë në shkolla dhe mbrojtjen e mjedisit.

Janë ndërmarrë masa konkrete ndaj shkelësve, duke përfshirë pezullime ndërtimesh dhe prishje të ndërtimeve pa leje. Janë zhvilluar inspektime të përsëritura për të monitoruar progresin e zbatimit të masave.

Spektori i Inspektimit të Pyjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka realizuar gjithsej 146 inspektime, duke përqendruar aktivitetin në parandalimin dhe goditjen e ndërhyrjeve të paligjshme në fondet pyjore dhe kullimore, si dhe në transportin e paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore.

Inspektimet kanë adresuar problematika të lidhura me gjuetinë e paligjshme dhe ndërhyrjet në fond pyjor, duke mbuluar një gamë të gjerë të territorit të Qarkut Shkodër. Janë kryer masa parandaluese dhe hetime të hollësishme për të reduktuar veprimtaritë e paligjshme në fondet pyjore dhe kullimore. Ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me administratën e Zonave të Mbrojtura Shkodër mbi ndërhyrjet e paligjshme në zonat e mbrojtura si: gërmime, zënie, pushtim, prerje të paligjshme dhe gjueti. Kjo periudhë ka shënuar një përpjekje të vazhdueshme për të mbrojtur dhe menaxhuar burimet pyjore në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

Spektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave ka realizuar një sërë aktivitete dhe ndërhyrjesh në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe ujërave në Qarkun Shkodër gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, duke përfshirë inspektime, trajtim ankesash dhe monitorime të vazhdueshme.

Gjatë vitit janë realizuar 49 inspektime në total, duke përfshirë:

Kontroll mbi menaxhimin e mbetjeve urbane, mbetjeve inerte dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Angazhim në largimin e strukturave ndërtimore të Dajlanit të vendosur në gjerësinë e shtratit të Lumit Buna në bashkëpunim me IKMT Qendër.

Monitorimin e zonave të ndjeshme si plazhi i Velipojës, brigjet e lumenjve Kir, Buna dhe Drin, si dhe në pika strategjike urbane dhe rurale.

Zbatimi i urdhrave specifike për ndërhyrjet e kundërligjshme përgjatë autostradave dhe rrugëve interurbane.

Gjatë vitit janë marrë disa masa administrative, përfshirë gjopa ndaj subjekteve që nuk përmbushin kriteret ligjore. Janë dhënë **të paktën 3 masa me gjobë**.

Monitorimi i shkollave dhe siguria në perimetrin e tyre

Në zbatim të paketës së sigurisë, janë realizuar inspektime të shumta në shkolla për të garantuar pastërtinë dhe sigurinë në perimetrin e tyre.

Gjatë periudhës janë administruar gjithsej **6 ankesa**, që lidhen kryesisht me:

- Menaxhimin e mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza.
- Ndotjen mjedisore nga fabrika dhe aktivitete industriale dhe përdorimin e mbetjeve per nivelim të nje hapësire publike.
- Denoncimet për ndërhyrje të paligjshme në brigjet e lumenjve dhe përdorimin e hapësirave publike.

Kontrolli dhe menaxhimi i zonave turistike dhe mjedisore

U ndërmorën veprime për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e plazhit Velipojë dhe lumenjtë kryesorë të qarkut.

Mbështetje e IMT Bashkia Shkodër dhe IKMT Qender në ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve të kundërligjshme në zonën e Thethit.

#### **IV.2 Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim**

Gjatë vitit janë evidentuar 2392 vepra penale. Si rezultat i organizimit të veprimtarisë hetimore, janë arritur të mblidhen fakte dhe prova, duke zbuluar dhe dokumentuar autorësinë e 1758 prej tyre, me një zbulueshmëri 73.5%. Është dokumentuar implikimi i 1834 autorëve të dyshuar të veprave penale. Nga studimi i kriminalitetit rezulton se në vitin 2025 krahasuar me vitin e kaluar ka pësuar rritje në masën 28% ose 528 vepra penale më shumë.

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2025 e 2024, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

	<b>Emërtimi</b>	Njësia	<b>Viti 2025</b>	<b>Viti 2024</b>
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në Prokurori	Numër	2392	1864
2	Vepra penale për të cilët janë zbuluar autorët	Numër	1758	1655
3	Persona të implikuar	Numër	1834	1741
4	Nga të cilët			
	U është privuar liria (arrestuar)	Numër	326	315
	Janë ndaluar	Numër	74	89
	Janë ndjekur në gjëndje të lirë	Numër	1360	1239
	Janë shpallur në kërkim (janë larguar, apo i fshihen drejtësisë)	Numër	74	98

## Rekomandime për përmirësimin e punës

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (Degët Territoriale), duke krijuar struktura (grupe ndërinstitucionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Kontrollin efektiv të territorit, me qëllim parandalimin e;

- Ndërtimeve pa leje;
- Krimeve mjedisore (ndotja e mjedisit nga mbetjet, me vemendje të shtuar brigjet dhe shtratin e lumenjve, liqenin e Shkodrës dhe ato të HEC-ve, rrugët kombetare, destinacionet turistike; prerja e paligjshme dhe dëmtimi i pyjeve, etj);

- Kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre. Në luftën goditëse ndaj bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e rreptë dhe e vazhdueshme në Menaxhimin e burimeve njerëzore, që merret me aktivitetin e paligjshëm të bimëve narkotike, sipas periudhave (Në periudhën përgatitore dhe kultivimit, që nga punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm) dhe njësitë administrative e fshatrave (Ato Nj. A, fshatra, zona dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike);

- Ndotjes akustike, me vemendje të shtuar ndotjen nga zhurma e automjeteve (ndërhyrjet dhe modifikimi i mjeteve, përfshi edhe motorët, të cilët gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara dhe të besdishme për qytetarët);

- Aksidenteve rrugore e disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësitë të vetëqeverisjes vendore (vendosjen e sinjalistikës rrugore dhe përcaktimin e vendqendrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve)

b. Evidentimin dhe goditjen e individëve/grupeve të ndryshëm, të cilët kryejnë aktivitetin kriminal të trafikimit të personave dhe shfrytëzimit të të miturve (për kryerje vepra kriminale, punë të detyruar, lypje në rrugë, etj) me qëllim parandalimin e trafikimit të personave, me vemendje të shtuar komunitetin rom e egjiptian, si dhe fëmijët e rrugës

c. Hartimin e planeve të përbashkëta operationale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella lidhur me:

- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe realizimin e mbrojtjes civile, për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore e të mjedisit;

- Marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme (kulturore, sportive, etj), tubimeve, apo në raste festash kombëtare e lokale;

- Marrjen e masave për parandalimin dhe goditjen e krimit ekonomik-financiar e kibernetik;

- Marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik

2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Zyrat Vendore të Arsimit, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por edhe jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i rrishtuar.

### IV.3. Grupet ndërinstitucionale të punës (task-forcat)

Prefekti i qarkut ka drejtuar grupet ndërinstitucionale (task forcen vendore), duke qenë pjesë përbërëse e tyre, për:

Koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, si dhe monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025”; Ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të mekanizmave ligjor, për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor; Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore; Menaxhimin dhe përballimin e situatave emergjente në qark, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore;

#### IV.3.1. Task Forca Vendore Antikanabis

1. Task Forca Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”, e ngritur nga Prefekti i Qarkut, në zbatim të planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, gjatë periudhës veprimtarinë e ka përqendruar kryesisht në koordinimin e veprimtarisë së institucioneve dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për zbatimin e plan veprimit antikanabis, si dhe realizimin e bashkëpunimit të të gjithë institucioneve ligjzbatuese për ndjekjen në dinamikë, marrjen e masave parandaluese

2. Nga ana e Prefektit, në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive, në cilësinë edhe të drejtuesit të Task Forcës Vendore;

- a. Është zhvilluar takimi i Task Forcës Vendore Antikanabis, lidhur me realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin (sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit), goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit (Takim datë 11 Shkurt), takim në të cilin përveç anëtarëve të Task Forcës kanë marrë pjesë edhe drejtues të institucioneve rajonale dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe administratorë të Nj.A territori i të cilave është me rrisht në kultivimin e bimëve narkotike
- b. Në takimet me drejtuesit e Degëve Territoriale dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore, të organizuara për çështje të tjera, janë trajtuar çështjet të cilat kanë të bëjnë me veprimet antikanabis (veçanërisht masat parandaluese) me objektivin e vetëm moskultivimit të kanabisit

- c. Nga strukturat e policisë vendore, të njëjive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore, pjesë e Task Forcës vazhdojnë takimet sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike

**3. Kontrollat e ushtruara dhe gjetjet e rezultuara**

Gjatë vitit 2025 nga strukturat e policisë vendore dhe strukturat e tjera e njësitë e vetëqeverisjes vendore (pjesë e Task Forcës Vendore Antikanabis) nga 27,010 kontrolle (nga të cilat nga strukturat e policisë vendore 25,346 kontrolle), të ushtruara me 2,126 grupe (nga të cilat 1,974 grupe nga strukturat e policisë vendore) në të cilat janë angazhuar 7,244 punonjës (duke 64,180 orë shërbimi) dhe 2,069 automjete, **janë evidentuar 462 raste të kultivimit të 193,986 bimëve narkotike (185,304 bimë dhe 8,682 kubik) në 1,368 parcela, nga të cilat 71,594 bimë/rrënjë (262 raste), ose 37 % i përkasin territorit të bashkisë Shkodër; 67,193 bimë/rrënjë (137 raste), ose 34.6 % i përkasin territorit të bashkisë Vau Dejës; 53,032 bimë/rrënjë (57 raste), ose 27.3 % territorit të bashkisë Malësi e Madhe; 1,488 bimë/rrënjë (3 raste), ose 0.8 % territorit të bashkisë Pukë dhe 519 bimë/rrënjë (3 raste), ose 0.3 % territorit të bashkisë Fushë Arrëz; Gjetje të cilat sipas bashkive paraqiten:**

Nr.	Gjetjet e rezultuara nga kontrollet				
	Bashkia	Numri i bimëve narkotike			Numri vendkultivimit (parc.amb.)
		Gjithsej	Bimë	Kubik/ Fidan	
1	Malësi e Madhe	<b>53,032</b>	50,792	2,240	91
2	Shkodër	<b>71,754</b>	70,193	1,561	749
3	Vau Dejës	<b>67,193</b>	62,382	4,811	514
4	Pukë	<b>1,488</b>	1,418	70	8
5	Fushë Arrëz	<b>519</b>	519	0	6
<b>Qarku</b>		<b>193,986</b>	<b>185,304</b>	<b>8,682</b>	<b>1,368</b>

**Për 462 rastet e evidentuar janë referuar materialet në prokurori**

Numri i grupeve, punonjësve, mjeteve, orët e angazhimit, si dhe numri i kontrolleve të ushtruara nga struktura ligjzbatuese, pjesë e Task Forcës Vendore antikanabis, gjatë periudhës paraqitet;

Nr.	Struktura	Numri i grupeve, punonjësve, mjeteve dhe orët e angazhimit në kontrolle			
		Grupe	Punonjës	Automjete	Orë shërbimi
1	Kom. Pol. Shkodër	698	2,562	697	24,073
2	" M.Madhe	344	1,117	343	9,092
3	" V.Dejës	457	1,518	448	13,408
4	" Pukë	253	764	251	6,278
5	Stac. Pol. F.Arrëz	141	475	141	3,796
<b>DVP</b>		<b>1,893</b>	<b>6,436</b>	<b>1,880</b>	<b>56,647</b>

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

6	Sektori ZMPKT Shkoder	DVKM	0	0	0	0
7	Stac.Pol.Kuf.Shkodër		27	95	28	464
8	" Bajzë		37	138	37	716
9	" Grabom		17	60	17	338
	<b>DVKM</b>		<b>81</b>	<b>293</b>	<b>82</b>	<b>1518</b>
I	<b>Shuma (str.policisë)</b>		<b>1,974</b>	<b>6,729</b>	<b>1,962</b>	<b>58,165</b>
1	F.A (Seksioni i PU Shkodër dhe Rep. 1010 Vau i Dejës)		48	192	48	528
2	AdZM Shkodër		64	128	59	611
3	AREB (Sektori Shkodër)		0	75	0	438
4	Bashkia Shkodër		0	0	0	0
5	Bashkia Malësi e Madhe		0	0	0	0
6	Bashkia Vau i Dejës		8	16	0	3,120
7	Bashkia Pukë		0	0	0	0
8	Bashkia Fushë Arrëz		32	104	0	1,318
II	<b>Shuma (str. e tjera)</b>		<b>152</b>	<b>515</b>	<b>107</b>	<b>6,015</b>
	<b>Totali</b>		<b>2,126</b>	<b>7,244</b>	<b>2,069</b>	<b>64,180</b>



Nr.	Struktura	Numri i kontrolleve të ushtruara, sipas objekteve							ish parc. në të cilat janë kult. bimë nark. 2016-2025
		Gjithsej	Sera e minisera	Magazina e objekte	Ish objekte Ushtarake	Shtëpi të braktisura	Stane e stalla	Ambiente të hapura	
1	Kom. Pol. Shkodër	8,053	547	1,048	499	676	33	4,569	681
2	" M.Madhe	5,480	156	342	92	595	19	4,216	60
3	" V.Dejës	6,128	1,621	222	148	62	1	3,926	148
4	" Pukë	3,123	51	94	130	637	23	2,178	10
5	Stac. Pol. F.Arrëz	1,767	3	159	28	287	4	1,251	35
	<b>DVP</b>	<b>24,551</b>	<b>2,378</b>	<b>1,865</b>	<b>897</b>	<b>2,257</b>	<b>80</b>	<b>16,140</b>	<b>934</b>
6	Sek. ZMPKT DVKM	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Stac.Pol.Kuf.Shkodër	134	25	3	11	28	1	66	0
8	" Bajzë	349	0	34	15	24	4	267	5
9	" Grabom	312	0	12	13	7	0	273	7
	<b>DVKM</b>	<b>795</b>	<b>25</b>	<b>49</b>	<b>39</b>	<b>59</b>	<b>5</b>	<b>606</b>	<b>12</b>
I	<b>Shuma (str.policisë)</b>	<b>25,346</b>	<b>2,403</b>	<b>1,914</b>	<b>936</b>	<b>2,316</b>	<b>85</b>	<b>16,746</b>	<b>946</b>
1	F.A (Kom. e Rep. 1010 dhe Seks. i PU)	816	0	0	816	0	0	0	0
2	AdZM Shkodër	64	0	0	0	0	0	64	0
3	AREB (Sektori Shkodër)	594	163	0	0	125	100	206	0
4	Bashkia Shkodër	0	0	0	0	0	0	0	0
5	Bashkia M. Madhe	0	0	0	0	0	0	0	0
6	Bashkia Vau i Dejës	24	0	0	0	0	0	24	0
7	Bashkia Pukë	0	0	0	0	0	0	0	0

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

8	Bashkia Fushë Arrëz	166	0	0	0	0	0	166	0
II	<b>Shuma (str. e tjera)</b>	<b>1,664</b>	<b>163</b>	<b>0</b>	<b>816</b>	<b>125</b>	<b>100</b>	<b>460</b>	<b>0</b>
	<b>Totali</b>	<b>27,010</b>	<b>2,566</b>	<b>1,914</b>	<b>1,752</b>	<b>2,441</b>	<b>185</b>	<b>17,206</b>	<b>946</b>

Krahasuar me vitin e kaluar ku janë ushtruar 17.955 kontrolle dhe janë evidentuar evidentuar **524 raste** të kultivimit të **315,696 bimëve** narkotike, rezulton se gjatë këtij vitit janë ushtruar 27.010 kontrolle dhe evidentuar **462 raste** (*62 raste më pak*), me **193,986 bimë/rrënjë** narkotike.

**Numri i rasteve, parcelave dhe bimëve narkotike të gjetura dhe të asgjësuar gjatë viteve 2016-2025 (ku nuk janë evidentuar raste të kultivimit të bimëve narkotike), në formë grafike paraqitet;**



#### IV.3.2. Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave

Janë zhvilluar takimi i Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (I krijuar me Urdhër Nr. 6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo Qark”) , i ndryshuar (Urdhër Nr. 94 date 27.06.2025”Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale Antitrafikim”), (6 Mars , 9 Tetor 12 Nëntor 2025) dhe Tryezës Teknike (të ngritur me Urdhër Nr. 21, datë 02.03.2023, të Prefektit/Kryetarit të Komitetit Rajonal (të ndryshuar), (12 Mars 2025, 2 Qershor 2025).

Është hartuar e miratuar plan veprimi i luftës kundër trafikimit të personave për vitin 2025 i KRAT, plan i cili është hartuar mbi bazën e planeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, institucioneve vendore, organizatave të SHC-pjesë e KRAT-it. Nga ana e KRAT-it është miratuar programi (kalendari) i aktiviteteve që do të organizohen gjatë muajit Tetor dhe dërguar Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, program i cili është hartuar mbi bazën e programeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve, pjesë e Komitetit.

Kështu: Është organizuar takimi i KRAT-it, lidhur me miratimin e programit (kalendari) dhe organizimin e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere në parandalimin e trafikimit të personave për muajit Tetor 2025, si dhe celja në mënyrë simbolike. Me sloganin “**Nga ndergjegjesimi ne veprim Bashkohuni ne luften kunder Trafikimit !**” është bere prezantimi i fushatës për muajin e Luftës kundër Trafikimit të Personave”, nëpërmjet ngritjes se tryezave informuese ne te gjitha shkollat, njësitë e vetëqeverisjes vendore-Qendrat Komunitare “Për Familjen”, Institucione vendore dhe organizatat të shoqërisë civile, tryeza qe kane qëndruar te hapura gjate gjithë muajit

Janë ngritur këndet informuese më broshura e fletëpalosje ne njësitë e vetëqeverisjes vendore (Nj. A, bashki) dhe në shkolla brenda territorit të qarkut, sipas njësisve të vetëqeverisjes vendore (sipas një grafiku kalendarik te përcaktuar), kënde të cilat kanë patur qëllim informimin e publikut për parandalimin e fenomenit të trafikimit të personave, si dhe Mënyrën e Raportimit për rastet e identifikuar të dhunës dhe trafikimit (Linja Kombëtare 116006 dhe aplikacioni “Raporto! Shpëto!”)

Gjate periudhës jane intervistuar 9 shtetas. 5 prej tyre shtetas minoren, dhe 4 të rritun. Gjate intervistimit nga keto : 2 nuk rezultuan si V.T. apo V.M.T.,; 2 shtetase të huaja (kineze) SH.J dhe Y.P. dyshohet si potencial V.M.T. , ndersa 3 shtetase të mitura , shtetësja K.P. , V. D. Dhe A.D.rezultuan V.T, shtetesja e rritur G.J. dyshohet se eshte potencial V.M.T. Te 4 shtetasit me dëshirëm e tyre janë akomoduar në Qëndren Rehabilituese të Antitrafikimit ku dhe vazhdojne aktualisht.

Nga shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit ju është refuzuar hyrja 86 shtetasve te huaj (pa vizë hyrje) në kufi. Janë kapur në kufi 780 shtetas të huaj (651 shtetas për herë të pare, nga te cilet per 645 eshte nxjerr urdher largimi vullnetar, dhe 129 shtetas përsëritës), dhe 45 i janë kthyer autoriteteve malazeze ne zbatim të Marrëveshjes së Ripranimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi..Gjatë periudhës është ulur tendenca për dalje nga R. Sh e shtetasve shqiptar kryesisht mosha te reja qe kalojnë nëpërmjet PKK Muriqan e Hani i Hotit për te shkuar ne vendet e Evropës Perëndimore, me qëllim kërkesën për azil, kjo falë edhe masave dhe rritjes së kontrollit në PKK dhe kufirin e gjelbër. Ju është refuzuar dalja

nëpërmjet PKK 129 shtetasve shqiptar, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, për të udhëtuar apo kanë shkelur rregullat e hyrjes e qëndrimit në vendet e BE.

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 nuk është evidentuar asnjë rast të VT/VMT.

Vazhdon të trajtohet me statusin e VT/VMT 1 rast që vazhdon të përfitoje pagesen e VT për këte periudhe nën moshën 18 vjeç.

Janë identifikuar 99 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian

Janë trajtuar me ndihmë ekonomike, përfshi edhe familjet e trajtuara nga skema me fondin 6 %, 3377 familje në qark, nga të cilat 368 me kryefamiljar gra dhe gra të divorcuara, 35 familje të komunitetit rom dhe egjiptian. Nga skema e ndihmës ekonomike trajtohen 62 viktima të dhunës.

Kanë përfituar nga skema e PAK 5299 persona dhe kujdestari 1445 persona, nga të cilët 33 persona të komunitetit rom dhe egjiptian

Janë identifikuar dhe evidentuar nga bashkia Shkodër 22 raste të fëmijëve të rrugës, ndërsa nr total i rasteve të menaxhuara për këtë periudhe është 37, për të cilat së bashku me familjet janë: Hartuar planet e ndërhyrjes për integrimin; Mbështetur me ndihma ushqimore, veshmbathje e medikamente për fëmijët, të cilët kanë patur probleme shëndetësore; Mbështetur me paketa (ushqimore, veshmbathje, higjieno-sanitare, etj.) familjet e fëmijëve rom/ egjiptian dhe familjet me veshitësi social-ekonomike; Mbështetur nga ana psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedurat administrative, punësim, ndihmë ekonomike, etj. Numri i punëkërkuesve të papunë ka qenë gjithsej 4611 (femra 2,446), nga të cilët të komunitetit rom dhe egjiptian 140.

#### **IV.3.3. Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**

Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Qarkun Shkodër funksionon si një mekanizëm kolegjal koordinues, i ngritur me qëllim bashkërendimin institucional ndërmjet strukturave qendrore, degëve të tyre territoriale dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore, në trajtimin e çështjeve që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Veprimtaria e tij mbështetet në kuadrin ligjor dhe aktet administrative në fuqi, duke reflektuar prioritetin kombëtar për garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Komiteti është krijuar me Urdhrin e Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 121, datë 29.12.2023, dhe drejtohet nga Prefekti i Qarkut, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit të Ministrave në nivel vendor. Në përbërje të tij janë përfshirë strukturat kryesore ligjzbatuese dhe institucionale në nivel qarku, përfshirë Drejtorinë Vendore të Policisë, strukturat e menaxhimit të kufirit, shërbimet informative, institucionet e vuajtjes së dënimit penal, Shërbimin e Provës, si dhe drejtoritë rajonale me përgjegjësi në fushën e arsimit, shëndetësisë, financave publike dhe inspektimeve përkatëse. Kjo përbërje garanton një qasje të integruar dhe

shumëdisiplinore në adresimin e fenomenit.

Misioni i Komitetit konsiston në identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të individëve apo grupeve në rrezik radikalizimi, si dhe në monitorimin e situatave që mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë publike. Njëkohësisht, Komiteti mbikëqyr zbatimin e masave parandaluese dhe rehabilituese në nivel qarku, përfshirë proceset e riintegritimit dhe risocializimit të shtetasve të kthyer nga zonat e konfliktit, në përputhje me politikën dhe udhëzimet e Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm. Në këtë kuadër, ai shërben edhe si mekanizëm ndërmjetësues për adresimin e nevojave sociale dhe ekonomike të rasteve të identifikuara, duke promovuar një qasje parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, veprimtaria e Komitetit është zhvilluar në përputhje me Planin e Masave të miratuar për vitin 2025, i cili ka përbërë dokumentin orientues të punës vjetore. Në këtë plan janë përcaktuar objektiva konkrete, masa të detajuara dhe përgjegjësi institucionale, me fokus në forcimin e ndërgjegjësimit publik, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional.

Institucionet anëtare kanë paraqitur dhe harmonizuar planet e tyre të veprimit, duke identifikuar aktivitete specifike për rritjen e ndërgjegjësimit në komunitet, veçanërisht në mesin e të rinjve. Në këtë kuadër, janë zhvilluar fushata sensibilizuese në institucione arsimore parauniversitare dhe universitare, si dhe aktivitete informuese në komunitet, me synim promovimin e kulturës së tolerancës, respektit për diversitetin dhe refuzimin e narrativave ekstremiste. Këto aktivitete janë shoqëruar me materiale informuese dhe diskutime të hapura me nxënës, studentë dhe prindër, duke synuar ndërtimin e një mjedisi social rezistent ndaj radikalizimit.

Një drejtim tjetër i rëndësishëm i veprimtarisë gjatë vitit 2025 ka qenë forcimi i kapaciteteve profesionale të strukturave përgjegjëse. Janë organizuar trajnime të specializuara për efektivat e policisë dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, me fokus në identifikimin e hershëm të shenjave të radikalizimit, analizën e riskut dhe menaxhimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm. Trajnimet kanë synuar garantimin e një reagimi të koordinuar, proporcional dhe në përputhje me standardet ligjore dhe të të drejtave të njeriut.

Në bashkëpunim me bashkitë dhe institucionet vendore, i është kushtuar vëmendje e veçantë mbështetjes së familjeve të individëve në rrezik radikalizimi. Përmes këshillimit psikosocial, referimeve në shërbimet përkatëse dhe programeve sociale, është synuar reduktimi i faktorëve të riskut dhe forcimi i rolit të familjes si strukturë mbështetëse në procesin e parandalimit. Kjo qasje ka reflektuar nevojën për ndërhyrje të hershme dhe të koordinuara, duke kombinuar dimensionin e sigurisë me atë social dhe edukativ.

Gjatë vitit 2025 është thelluar bashkëpunimi ndërinstitucional përmes mbledhjeve periodike të Komitetit, shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të masave konkrete në rastet e identifikuara. Ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e efektivitetit të mekanizmave

ekzistues dhe në përmirësimin e reagimit institucional ndaj çdo rasti potencial. Në të njëjtën kohë, është forcuar komunikimi me strukturat qendrore dhe është siguruar raportimi i rregullt mbi ecurinë e masave të ndërmarra.

Në përfundim, vlerësohet se gjatë vitit 2025, Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Qarkun Shkodër ka përmbushur funksionet e tij në përputhje me objektivat e përcaktuara, duke kontribuar në forcimin e sigurisë publike dhe në konsolidimin e një qasjeje të integruar parandaluese. Vijimësia e masave të ndërmarra, përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional dhe thellimi i bashkëpunimit me komunitetin mbeten prioritetet për periudhën në vijim, me synim garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm për qytetarët e qarkut.

#### **IV.3.4. Këshilli Vendorë i Sigurisë Publike dhe Këshilli Konsultativ Treplësh Rajonal**

**Këshilli Vendorë i Sigurisë Publike** - Në kuadër të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës dhe koordinues të Prefektit të Qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel vendor, është ndërmarrë procesi i monitorimit të ecurisë së ngritjes dhe funksionimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP) në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut, për periudhën Janar–Dhjetor 2025. Për këtë qëllim, është adresuar kërkesë zyrtare për informacion, me synim evidentimin e nivelit të zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi, identifikimin e fazës procedurale në të cilën ndodhen strukturat përkatëse, si dhe vlerësimin e funksionalitetit të tyre në praktikë.

Nga informacioni i administruar rezulton se në nivel qarku procesi i ngritjes dhe konsolidimit të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike ka njohur zhvillime progresive, megjithëse me ritme të ndryshme në varësi të kapaciteteve organizative dhe procedurale të secilës njësi vendore. Një pjesë e njësive kanë përfunduar procedurat formale të krijimit të KVSP-ve, përmes miratimit të akteve përkatëse nga organet vendimmarrëse, si dhe përcaktimit të përbërjes së tyre në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Përbërja e këtyre këshillave pasqyron një qasje ndërinstitutionale, duke përfshirë drejtues të njësive vendore, përfaqësues të strukturave të Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake, arsimit parauniversitar, emergjencave civile, si dhe institucioneve të tjera me rol në garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Në disa raste, ndonëse këshillat janë krijuar dhe përbërja e tyre është formalizuar, problematikat e evidentuara në territor janë adresuar në mënyrë operative nga strukturat përgjegjëse, pa qenë e nevojshme thirrja formale e mbledhjeve të KVSP-ve gjatë periudhës së raportimit. Kjo situatë tregon ekzistencën e një niveli bashkëpunimi funksional ndërmjet institucioneve lokale, por njëkohësisht evidencon nevojën për konsolidimin e praktikës së mbledhjeve periodike, me qëllim garantimin e një qasjeje të strukturuar dhe të dokumentuar në trajtimin e çështjeve të sigurisë publike.

Ndërkohë, në një pjesë të njësive të tjera vendore, procesi i ngritjes së KVSP-ve ka qenë

në fazë përgatitore dhe procedurale. Janë ndërmarrë hapa konkretë për përcaktimin e anëtarësisë përfaqësuese sipas strukturave institucionale, hartimin e projekt-akteve përkatëse dhe përgatitjen e rregulloreve të funksionimit. Në përputhje me parimet e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit, janë parashikuar dhe/ose zhvilluar procedura konsultimi publik, përfshirë dëgjesa me aktorë lokalë dhe përfaqësues të komunitetit, përpara miratimit përfundimtar të akteve nga organet vendimmarrëse vendore. Këto procese pritet të përmbillen me miratimin përfundimtar të strukturave dhe nisjen e funksionimit të plotë të këshillave.

Në tërësi, konstatohet se gjatë vitit 2025 janë hedhur baza të qëndrueshme institucionale për funksionalizimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike në nivel qarku, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Progresi i arritur reflekton angazhimin e strukturave vendore për të institucionalizuar mekanizma bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor, strukturave ligjzbatuese dhe komunitetit, me qëllim identifikimin e hershëm dhe adresimin efektiv të problematikave që cenojnë rendin dhe sigurinë publike.

Megjithatë, nga analiza e informacionit të raportuar, evidentohet nevoja për thellimin e mëtejshëm të funksionalitetit praktik të këtyre këshillave, përmes garantimit të mbledhjeve periodike, hartimit të planeve vendore të veprimit, dokumentimit të problematikave të trajtuara dhe përmirësimit të mekanizmave të raportimit. Gjithashtu, mbetet prioritet forcimi i rolit të komunitetit në këto struktura, duke rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes lidhur me çështjet e sigurisë në komunitet.

Në këtë kontekst, roli koordinues dhe mbikëqyrës i institucionit të Prefektit do të vijojë të orientohet drejt monitorimit sistematik të ecurisë së KVSP-ve, ofrimit të asistencës institucionale dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet strukturave vendore dhe atyre qendrore, me synim konsolidimin e një sistemi efektiv, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sigurisë publike në nivel qarku.

**Këshilli Konsultativ Treplësh Rajonal (KKTR)**, si mekanizëm institucional i dialogut social në nivel qarku, është konceptuar për të siguruar bashkëpunim të strukturuar ndërmjet përfaqësuesve të punëdhënësve, punëmarrësve dhe institucioneve shtetërore vendore. Në territorin e Qarkut Shkodër, ky forum ushtron një funksion të rëndësishëm këshillimor dhe koordinues, duke trajtuar çështje me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, tregun e punës dhe mirëqenien sociale.

Në përputhje me legjisllacionin në fuqi, KKTR kryesohet nga Prefekti i Qarkut, i cili garanton drejtimin institucional, mbarëvajtjen procedurale dhe respektimin e parimeve të ligjshmërisë, përfaqësimit të barabartë dhe transparencës. Në këtë cilësi, Prefekti siguron zhvillimin e mbledhjeve në një klimë dialogu konstruktiv, duke nxitur bashkërendimin ndërmjet palëve dhe orientuar procesin drejt vendimmarrjes konsensuale dhe efikase.

Veprimtaria e Këshillit përfshin zhvillimin e konsultimeve, miratimin e qëndrimeve dhe formulimin e rekomandimeve që, sipas kompetencës territoriale, i përcillen organeve të

qeverisjes vendore në nivel qarku dhe bashkie. Vendimmarrja realizohet nëpërmjet votimit të anëtarëve, ndërsa vlefshmëria e mbledhjeve kushtëzohet nga plotësimi i kuorunit, i përcaktuar si pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së përfaqësuesve të secilës palë përbërëse.

Çështjet e trajtuara në KKTR përfshijnë, ndër të tjera, politikat e punësimit, formimin profesional, mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, sigurinë dhe higjienën në punë, si dhe problematika që lidhen me prodhimin, arsimin, zhvillimin ekonomik rajonal dhe mbrojtjen sociale. Struktura e Këshillit përbëhet nga pesëmbëdhjetë anëtarë dhe pesëmbëdhjetë zëvendësues, me përfaqësim të baraspeshuar nga organizatat sindikale, organizatat e punëdhënësve dhe organet e vetëqeverisjes vendore, duke garantuar një mekanizëm funksional dhe gjithëpërfshirës.

Roli drejtues i Prefektit në krye të KKTR përbën një element thelbësor për forcimin e koordinimit institucional dhe për konsolidimin e dialogut social në nivel rajonal, duke kontribuar në adresimin e problematikave konkrete dhe në formulimin e rekomandimeve të qëndrueshme në interes të zhvillimit afatgjatë të qarkut.

### **Ngritja dhe konsolidimi i KKTR**

Në ushtrim të kompetencave të përcaktuara nga Ligji nr. 107/2016 dhe në zbatim të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 551, Prefekti i Qarkut Shkodër ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për ngritjen dhe funksionalizimin e Këshillit në përputhje me standardet ligjore dhe institucionale.

Krijimi i KKTR është formalizuar me Urdhrin përkatës të Prefektit, duke garantuar një përbërje të balancuar dhe përfaqësuese nga organizatat e punëdhënësve, organizatat sindikale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky konfigurim synon të sigurojë përfaqësim real të interesave të palëve dhe një proces vendimmarrjeje të mbështetur në dialog, bashkëpunim dhe konsensus.

Paralelisht, pranë Institucionit të Prefektit është ngritur Sekretariati Teknik i KKTR, i përbërë nga administrata përkatëse, me funksione organizative, mbështetëse dhe koordinuese. Ky strukturë garanton përgatitjen dhe administrimin e mbledhjeve, dokumentimin e veprimtarisë, ndjekjen e zbatimit të vendimeve dhe ruajtjen e vazhdimësisë institucionale. Në funksion të rregullimit të brendshëm të punës, është hartuar dhe miratuar rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit dhe të Sekretariatit Teknik, e cila përcakton parimet, procedurat dhe mekanizmat operativë. Miratimi unanimit i këtij dokumenti në mbledhjen e parë konstituive përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt garantimit të funksionimit të rregullt, transparent dhe efektiv të këtij organi konsultativ.

Angazhimi institucional në drejtimin e KKTR dëshmon për rolin koordinues dhe garantues të ligjshmërisë në nivel qarku, si dhe për përkushtimin në forcimin e dialogut social dhe adresimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin ekonomik, punësimin dhe mirëqenien e qytetarëve në Qarku Shkodër.

### **Konkluzione dhe rekomandime**

Funksionimi i Këshillit Konsultativ Trepalësh Rajonal ka si qëllim trajtimin e çështjeve që lidhen me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, sigurinë dhe higjienën në punë, prodhimin, arsimin, mirëqenien sociale dhe problematika të tjera ekonomike me interes rajonal. Në kuadër të agjendave të takimeve, anëtarët shqyrtuan dhe diskutuan temat e parashtruara paraprakisht, duke reflektuar nevojat dhe shqetësimet konkrete të sektorëve përfaqësues.

Gjatë këtyre diskutimeve u identifikuan problematika me ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e punës dhe zhvillimin ekonomik të Qarkut Shkodër. Anëtarët kontribuan me qëndrime, rekomandime dhe propozime konkrete, të cilat shërbyen si bazë për forcimin e dialogut social dhe për orientimin e ndërhyrjeve institucionale në funksion të adresimit të çështjeve me interes rajonal. Mes çështjeve kryesore evidentohen: largimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore, veçanërisht nga zonat rurale, drejt vendeve të Bashkimit Evropian, i cili krijon boshllëqe në tregun lokal të punës dhe cenon qëndrueshmërinë e sektorëve prodhues; punësimi i të rinjve dhe përfshirja e tyre në sektorët bazë përmes politikave aktive të punësimin dhe arsimit profesional; niveli i lartë i informalitetit, duke përfshirë bizneset online, që ndikon negativisht në konkurrencën e ndershme dhe të ardhurat fiskale; si dhe vështirësitë lidhur me mobilitetin urban, rrethqytetas dhe ndërqytetas, që kufizon qasjen e fuqisë punëtore në vendet e punës. Problematika të tjera lidhen me infrastrukturën mbështetëse dhe sfidat e përditshme të biznesit të vogël, që nxisin nevojën për ndërhyrje të koordinuara dhe masa mbështetëse konkrete. Bazuar në këto shqetësime, nxirren rekomandime me karakter prioritar, të cilat synojnë përmirësimin e klimës së punës, formalitetin në aktivitetin ekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal. Mes tyre përfshihen:

- Zbatimi rigoroz i të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësve dhe punëmarrësve sipas Kodit të Punës, duke garantuar respektimin e kontratave, pagat minimale, orët shtesë dhe të drejtat e tjera të punëmarrësve.
- Krijimi i një task-force ose drejtorie të posaçme për monitorimin e bizneseve informale dhe atyre online, që të promovojë konkurrencën e ndershme, formalizimin e aktiviteteve dhe mbrojtjen e biznesit të rregullt.
- Rishikimi i planit ekzistues të transportit për të përmirësuar mobilitetin rrethqytetas dhe ndërqytetas, duke lehtësuar qasjen e punonjësve nga zonat periferike dhe rurale drejt vendeve të punës.
- Mbështetja e sipërmarrjes së re dhe e biznesit të vogël përmes shërbimeve konsultative falas në aspektin formal, ligjor dhe teknik, duke fuqizuar qëndrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të komuniteteve lokale.
- Realizimi i studimeve mbi zinxhirin e prodhimit dhe tregut, për identifikimin e boshllëqeve, mundësive për vlerë të shtuar dhe planifikimin e ndërhyrjeve strategjike.
- Matja e performancës së arsimit dhe formimit profesional për të siguruar përshtatjen e

programeve mësimore me nevojat reale të tregut të punës, duke përgatitur të rinjtë për kontributin në sektorët kyç ekonomikë.

Këto rekomandime synojnë të ndërthurin përpjekjet ndërinstitucionale dhe bashkëpunimin mes sektorëve publik dhe privat, duke krijuar një platformë të koordinuar për adresimin e sfidave socio-ekonomike të Qarkut Shkodër.

Prefekti i Qarkut Shkodër, në rolin e drejtuesit të KKTR-së, vazhdon të luajë një rol kyç në koordinimin institucional, garantimin e zbatimit të objektivave të dialogut social dhe për formulimin e rekomandimeve konkrete në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm rajonal.

#### **IV.4. Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat**

Në zbatim të ligjit nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, si dhe në vijim të detyrave të deleguara nga MM, dhe AKMC, gjatë vitit 2025, puna dhe veprimtaria e sektorit të PPECK është përqendruar në planifikimin e situatave të pritshme emergjente (Është hartuar plani vjetor i punës; Plan i Inspektimit/Monitorimit; plani i gadishmërisë me skenar-përmbytjet, izolimin nga dëbora dhe zjarret; Planit të përballimit të EC).

Veprimtaria e sektorit është fokusuar në monitorimin e vazhdueshëm të situatës, koordinimin ndërinstitucional, ngritjen e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhimin operacional të emergjencave civile në territorin e Qarkut Shkodër.

Sektori PPECK ka garantuar komunikim dhe raportim të përditshëm me strukturat e Mbrojtjes Civile të bashkive të qarkut, duke përmbledhur informacionin dhe duke informuar AKMC-në për situatën në nivel qarku.

Në cilësinë e Sekretariatit Teknik të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut Shkodër, janë organizuar mbledhje periodike dhe takime konsultative me strukturat vendore, me fokus:

- analizimin e kapaciteteve logjistike dhe burimeve njerëzore;
- gatishmërinë për sezonet me risk të shtuar (veror dhe dimëror);
- përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe kryesisht me strukturat vendore.

Gjatë vitit 2025, sektori PPECK ka marrë pjesë në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në projekte rajonale dhe ndërkufitare, me fokus:

- vlerësimin e nevojave pas fatkeqësive;
- menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë;
- përdorimin e bazave të të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë;
- forcimin e reagimit të integruar në emergjenca civile dhe shëndetësore.

Këto aktivitete kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e aftësive profesionale të stafit dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me AKMC-në, Forcat e Armatosura, ARRSH-në, Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Gjatë vitit 2025 janë raportuar gjithsej **1.111 raste zjarresh** në nivel qarku.

- **Pjesa dërrmuese e rasteve është përballuar nga strukturat vendore të MZSH, Mbrojtjes Civile të bashkive dhe përmes koordinimit të drejtpërdrejtë nga Prefekti i Qarkut Shkodër dhe sektori PPECK.**
- **Vetëm në tre raste zjarresh,** për shkak të përmasave të mëdha dhe ezaurimit të kapaciteteve vendore, është kërkuar mbështetje nga AKMC, duke u aktivizuar forca shtesë, mjete logjistike dhe ndërhyrje nga ajri.
- Bashkëpunimi ndërmjet njësive vendore, në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 45/2019, ka rezultuar eficient dhe ka parandaluar përshkallëzimin e situatave emergjente.

Ky tregues dëshmon gatishmëri dhe kapacitete operacionale të konsoliduara në nivel vendor. Gjatë sezonit të reshjeve, sektori PPECK ka koordinuar përballimin e situatave të krijuara nga përmytjet, rrëshqitjet e dherave dhe daljet nga shtrati të lumenjve dhe përrojeve.

Janë kryer verifikime në terren, është bashkërenduar puna me strukturat vendore, ARRSH-në dhe institucionet përgjegjëse, si dhe është realizuar monitorimi dhe evidentimi i dëmeve.

Gjatë vitit 2025, sektori PPECK në bashkëpunim me NJQV-të ka koordinuar procesin e evidentimit të **hotspotëve konkrete** që paraqesin risk të lartë emergjence në territorin e Qarkut Shkodër.

#### **Hotspote kryesore të evidentuara:**

##### **Ura dhe vepra arti me dëmtime strukturore:**

- Ura e Ded Hilit, fshati Bleran – Bashkia Shkodër.
- Ura e Brashtës, aks Toplanë–Lekbibaj – zona e Dukagjinit.
- Ura në qendër të fshatit Bushat – Bashkia Vau Dejës.
- Ura lidhëse e qytetit të Fushë-Arrëzit me aksin nacional.
- Ura e fshatit Flet – Bashkia Fushë-Arrëz.

##### **Segmente rrugore me risk të lartë:**

- Aksi Tamarë–Vermosh (Gropat e Selcës) – rrezik nga shkarja e masivit shkëmbor.
- Aksi Theth–Ndërlyaj – rrëshqitje të vazhdueshme inertesh.
- Aksi Bugjon–Gralisht – rrëshqitje e trupit të rrugës në rreth 200 m linearë.
- Aksi Bardhet–Iballë – deformime progresive dhe rrezik degradimi total.
- Segmente rurale në bashkitë Pukë dhe Malësi e Madhe me shembje dherash dhe vërshime ujërash.


Këto hotspot-e paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për izolimin e komuniteteve dhe kërkojnë Janë evidentuar problematikat kryesore si më poshtë:

1. Infrastrukturë rrugore dhe ura të amortizuara.
2. Kapacitete të kufizuara logjistike dhe teknike kyesisht në përballimin e emergjencave dimërore.
3. Nevojë për rritjen e kontrollit dhe monitorimit të territorit me risk të shtuar.

4. Vështirësi në vlerësimin e riskut në situata konkrete emergjente.
5. Mungesë e koordinimit ndërmjet drejtuesit operacional dhe strukturave operacionale në disa raste.
6. Raste të përsëritura të zjarrvënies së qëllimshme ose nga pakujdesia.
7. Vonesa në hartimin dhe përditësimin e dokumenteve strategjike të Mbrojtjes Civile.

Numri i zjarreve në nivel qarku për periudhën **Janar – Dhjetor 2025 është 1.111 raste** të raportuara nga drejtoria/sectorët MZSH dhe sektoret MC të bashkive të qarkut Shkodër, i ndarë sipas sipas bashkive është si më poshtë:

6. Bashkia Shkodër **572 raste zjarresh.**
7. Bashkia Malësi e Madhe **295 raste zjarresh.**
8. Bashkia Vau Dejës **176 raste zjarresh.**
9. Bashkia Puke **52 raste zjarresh.**
10. Bashkia Fushe Arrëz **16 raste zjarresh.**



## V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në mënyrë qoftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nënligjore.

Është bashkëpunuar për ushtrimin e funksioneve të transferuara nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës sektoriale) për

kryerjen e këtyre funksioneve. Po kështu është bashkëpunuar mbi zbatimin e detyrimeve ligjore në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, përfshirë edhe shërbimin e furnizimit me ujë të konsumatorëve dhe largimin e ujrave të ndotura.

### **V.1. Kryerja e funksioneve të transferuara njësisive të vetëqeverisjes vendore**

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten e pakushtëzuar sektoriale) për kryerjen e këtyre funksioneve, për:

#### ***1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin***

Janë kryer shpenzime me vlerë 182,184 mijë lekë (Bashkia Shkodër 65,099 mijë lekë, Bashkia M.Madhe 39,498 mijë lekë; Vau i Dejës 19,011 mijë lekë; Pukë 34,707 mijë lekë dhe Fushë Arrëz 23,869 mijë lekë), nga 201,001 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2025 dhe të trashëguara) ose 90.6 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 18,817 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2026.

#### ***1.2. Sistemin e ujitjes dhe kullimit***

Janë kryer shpenzime me vlerë 32,758 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 12,859 mijë lekë; Vau i Dejës 14,422 mijë lekë; Pukë 1,173 mijë lekë dhe Fushë Arëz 4,304 mijë lekë), nga 53,653 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2025 dhe të trashëguara) ose 61 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 20,895 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2026..

#### ***1.3. Pyjet dhe kullotat publike***

Janë kryer shpenzime me vlerë 76,999 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 19,846 mijë lekë; Vau i Dejës 8,222 mijë lekë; Pukë 19,303 mijë lekë dhe Fushë Arëz 29,628 mijë lekë), nga 83,625 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2025 dhe të trashëguara) ose 92% e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 6,626 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2026.

#### ***1.4. Rrjetin e rrugëve rurale***

Janë kryer shpenzime, me fondet e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve, me vlerë 8,382 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 6,048 mijë lekë; Vau i Dejes 2,334 mijë lekë), nga 8,382 mijë lekë të programuara (fonde të programuara nga buxheti për bashkitë në formën e transfertës pakushtëzuar sektoriale, për menaxhimin e mbetjeve), ose 100 % e shpenzimeve të programuara.

#### ***1.5. Menaxhimi i Mbetjeve***

Janë kryer shpenzime, me fondet e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve, me vlerë 8,382 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 6,048 mijë lekë; Vau i Dejes 2,334 mijë lekë), nga 8,382 mijë lekë të programuara (fonde të programuara nga buxheti për bashkitë në formën e transfertës

pakushtëzuar sektoriale, për menaxhimin e mbetjeve), ose 100 % e shpenzimeve të programuara.

**1.6. *Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar***

Janë kryer shpenzime me vlerë 666,095 mijë lekë (Bashkia Shkoder 349,983 mijë lekë, Bashkia M.Madhe 105,048 mijë lekë; Vau i Dejës 74,006 mijë lekë; Pukë 86,982 mijë lekë dhe Fushë Arrëz 50,076 mijë lekë), nga 810,778 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2025 dhe të trashëguara) ose 82 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 144,683 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2026.

**1.7. *Mbrojtja sociale***

Janë kryer shpenzime me vlerë 194,397 mijë lekë (Bashkia Shkoder 65,099 mije leke, Bashkia Puke 106,347 mijë lekë dhe Bashkia Vau i Dejes 18,817 mijë lekë), nga 192,507 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2025 dhe të trashëguara) ose 99 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 1,890 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2026.

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera sektoriale), përmbljedhëse dhe sipas bashkive

**Përmbljedhëse**

*Në mijë lekë*

Nr.	Bashkia	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet. familjare e individ		Investime		Shuma	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	M.Madhe	154,072	148,836	27,968	26,809	26,681	18,647	11,332	5,088	11,052	441	231,106	199,821
2	Shkodër	338,020	283,817	66,299	54,892	95,645	70,515	48,452	43,041	54,124	5,858	554,088	415,082
3	Vau Dejës	111,879	111,879	18,692	18,684	15,847	11,159	-	-	-	-	146,418	141,722
4	Pukë	129,711	107,477	18,121	17,971	24,792	13,728	111,486	109,711	19,566	7,358	325,842	285,875
5	F. Arrëz	120,004	103,421	20,318	16,898	12,347	10,539	46	40	-	(-20)	152,715	130,899

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

**1. Bashkia Malësi e Madhe**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxh familj. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap	Prog.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujitj. dhe Kullimit	1	4240	7,488	7,266	1,250	1,213	8,674	4,249	373	131	7,500	0	25,285	12,859
Administrimi i pyjeve	1	4260	15,480	15,480	2,585	2,585	2,597	1,774	738	7	2,097	0	23,497	19,846
Rrugë Rurale	1	4520	12,813	12,813	3,710	3,526	0	0	1,050	183	0	0	17,572	16,522
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100	0	0	0	0	6,048	6,048	0	0	0	0	6,048	6,048
Arsimi bazë (përf.parash.)	1	9120	82,932	79,458	13,850	13,264	0	0	2,281	1,315	0	0	99,063	94,038
Arsimi mesëm, Konvikti	1	9230	8,719	8,131	2,124	1,931	948	948	536	0	0	0	12,327	11,010
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	26,641	25,688	4,449	4,289	8,415	5,627	6,354	3,451	1,455	441	47,314	39,498
<b>Totali</b>			<b>154,072</b>	<b>148,836</b>	<b>27,968</b>	<b>26,809</b>	<b>26,681</b>	<b>18,647</b>	<b>11,332</b>	<b>5,088</b>	<b>11,052</b>	<b>441</b>	<b>231,106</b>	<b>199,821</b>

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

**2. Bashkia Shkodër**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet famil.individ e të brendshme		Investime		Shuma	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Menaxhim Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Administrimi i pyjeve	1	4260	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Rrugë rurale	1	4520	-	-	21	-	-	-	-	-	29,496	-	<b>29,517</b>	-
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	287,722	233,519	57,392	46,794	88,491	63,812	-	-	23,623	5,858	<b>457,228</b>	<b>349,983</b>
Arsmi i mesëm (përgjith.)	1	9230	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Përkujdesi social	1	10430	-	-	-	-	-	-	48,452	43,041	-	-	-	-
Shërbimi i MZSh-së dhe MC	1	3280	50,298	50,298	8,886	8,098	7,154	6,703	-	-	1,005	-	<b>67,343</b>	<b>65,099</b>
<b>Totali</b>			<b>338,020</b>	<b>283,817</b>	<b>66,299</b>	<b>54,892</b>	<b>95,645</b>	<b>70,515</b>	<b>48,452</b>	<b>43,041</b>	<b>54,124</b>	<b>5,858</b>	<b>554,088</b>	<b>415,082</b>

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

**3. Bashkia Vau i Dejës**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familjar e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	8,231	8,231	1,374	1,374	4,817	4,817					14,422	14,422
Administrimi i pyjeve	1	4260	6,788	6,788	1,134	1,134	300	300					8,222	8,222
Rrugë rurale	1	4520	5,755	5,755	963	961	527	527					7,246	7,243
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100					2,334						2,334	
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	52,580	52,580	8,781	8,781							61,361	61,361
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	2,583	2,583	431	431							3,015	3,015
Arsimi (konviktet)	1	9240	8,252	8,252	1,378	1,378							9,630	9,630
Shërbimi i MZSh-së dhe MC	1	3280	16,290	16,290	2,721	2,721							19,011	19,011
Administrimi i Qend.Sociale	1	10430	11,398	11,398	1,909	1,903	7,869	5,515					21,176	18,817
<b>Totali</b>			<b>111,879</b>	<b>111,879</b>	<b>18,692</b>	<b>18,684</b>	<b>15,847</b>	<b>11,159</b>					<b>146,418</b>	<b>141,722</b>

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

**4. Bashkia Pukë**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familjare e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	1,105	1,002	218	167	846	2			6,352		8,521	1,173
Administrimi i pyjeve	1	4260	15,294	15,294	2,974	2,970	1,181	969	70	70			19,519	19,303
Rrugët rurale	1	4520	7,241	7,241	962	962	2,197	1,933					10,400	10,136
Arsimi bazë (përf. parash.)	1	9120	46,615	45,628	7,527	7,525	9,521	3,944	257	257			71,886	59,755
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	19,556	18,167	3,081	3,039	7,516	4,609	290	290			33,758	27,227
Arsimi (konvikti Pukë)	1	9240	19,558								3,315	1,122	33,758	27,227
Mbrojtje sociale	1	10430							108,122	106,347			108,122	106,347
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	20,342	20,145	3,359	3,308	3,531	2,271	2,747	2,747	9,899	6,236	39,878	34,707
<b>Totali</b>														

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

**5. Bashia Fushë Arrëz**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familj. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujit dhe Kullimit	1	4240	1,300	1,049	207	175	3,918	3,080					5,425	4,304
Administrimi i pyjeve	1	4260	25,005	23,511	4,488	4,061	2,894	2,056					32,387	29,628
Rrugët rurale	1	4520	19,473	17,673	3,142	2,948	2,367	2,361	46	40		-20	25,028	23,022
Arsimi bazë(përf. parash.)	1	9120	48,286	37,943	8,311	6,263							56,597	44,206
Arsimi i mesëm	1	9230											5,913	5,870
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	20,897	18,220	3,300	2,606	3,168	3,043					27,365	23,869
<b>Totali</b>			<b>120,004</b>	<b>103,421</b>	<b>20,318</b>	<b>16,898</b>	<b>12,347</b>	<b>10,539</b>	<b>46</b>	<b>40</b>		<b>-20</b>	<b>152,715</b>	<b>130,899</b>

## V.2. Per verifikimin e ligjshmerise se vendimeve, urdhrave dhe urdheresave me karakter normativ te organeve te veteqeverisjes vendore 2025

Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër (në sekretari-arkiv) gjatë vitit 2025, nga 6 njësi të qeverisjes vendore- 5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër si njësi e dytë e qeverisjes vendore-, janë depozituar gjithsej **277** akte, nga të cilat **263** akte normative kanë qenë në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore, ndërsa për **14** akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm sipas argumentave ligjor.

**Akte jo normative** nga NJQV për 2025 janë depozituar **62**.

Akte të pakonfirmuara kanë konsistuar kryesisht si: mungesa e çertifikatës së pronësisë, moszhvillimi i seancave të konsultimit mbi buxhetin, sistemin fiskal, rishpërndarja e fondeve buxhetore, trajtimi financiar i familjeve të dëmtuara të cilat duhet të trajtohen sipas ligjit të posaçëm Nr.45/2019 dhe VKM-së Nr.329/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Dokumentacioni nga KB është depozituar sipas Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”.

### Akti i depozituar shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- Procesverbali i mbledhjes së këshillit,
- Procesverbali i dëgjësës publike, në ato raste kur kërkohet nga ligji,
- Relacioni përkatës që shpjegon respektimin e procedurës ligjore.
- Projektvendim
- Çertifikatën e pronësisë në mungesë të saj statusin juridik nga ASHK-ja (në vendimmarrjet e pronave),
- Pasqyrat përkatëse (në rastin e vendimmarrjes me karakter financiar),
- Dokumentacionin përkatës sipas standardit të kërkuar (në rastin e vendimmarrjes për emergjencat civile), akte bashkëshoqëruese për çdo vendim të KB gjatë trajtimit.

Në rast se mungon ndonjë dokument është detyrim i yni t’i kërkohet plotësimi i aktit zyrtarisht. Sektori juridik shqyrton akte normative të miratuara nga organet kolegjiale, këshillat bashkiak referuar funksioneve vendore ( sipas programeve buxhetore të klasifikuara) dhe dispozitatave 23-29 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i përditësuar.

Disa këshilla bashkiak paraqesin problem mbi mosmbledhjen e komisioneve të KB për shqyrtim të projektvendimeve të propozuara, nuk ka gjurmë, nuk ka gjurmë bashkëpunimi mes KB dhe qytetarëve që kanë ankesa ndaj bashkisë apo vetë KB.

**Problematikë:** Fondi i kushtëzuar, fond i dedikuar për mbrojtjen civile në zbatim të ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ka paraqitur problematikë derisa është bërë detajimi i dy

programeve të ndryshme buxhetore për përdorim; njëri për familjet e prekuara nga fatkeqësitë natyrore dhe tjetri për investime të ndryshme në fushën e EC sipas VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “*Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile*”. Ky problem është përmirësuar tashmë.

**Problemantikë:** Mosshlyerja e detyrimeve të prapambetura, rasti i B.Pukë. I është lënë afat deri me 14.02.2026 të gjej mënyrën/formën e likuidimit sipas Ministrisë së Financave.

**Problemantikë:** Një gjë me risk është në rastet kur organi kolegjal nuk respekton zhvillimin e seancave të këshillimit me publikun parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.139/2015, ligjit Nr.146/2014 “*Për njoftimin & konsultimin publik*” dhe rregulloret e KB të miratuara nga vetë ata.

Vazhdon të jetë me risk kjo problemantikë dhe ndeshet presion nga KB apo organi ekzekutiv. Rast i suksesshëm bashkia Vau Dejës.

**Problemantikë:** Një gjë me risk është në rastet kur organi kolegjal nuk respekton procedurën që parashikoj vetë rregullorja e KB, e miratuar nga vetë ata për situata që duhet të jenë të qarta tashmë pas trajnimeve të zhvilluara edhe nga Helvetas.

**Problemantikë:** Sipas rekomandimit të KLSH, në mungesë të çertifikatës së pronësisë, i është kërkuar statusi juridik për pyje/kullota, element që ka sjellë pakënaqësi për bashkitë dhe vonesa për procedurat në vazhdimësi. Ka pasur përmirësim gjatë këtij viti.

**Përmirësim:** Ka qenë praktikë mjaft pozitive kërkesa për çertifikatën e pronësisë për dhënie në përdorim të pronës publike duke shmangur probleme ligjore mbi pronën. Ky vendim merret nga KB në respekt të nenit 9, pika 1.2, gërma “c” e ligjit Nr.139/2015, në të cilin citohet.....e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli..... pra në rolin e pronarit.

**Përmirësim:** janë trajtuar vendimarrje me Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Drin Bunë sipas ligjit të posaçëm “*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore*” referuar VKM Nr.864/2014 “*Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore*”- situatë e përmirësuar

**Përmirësim:** Referuar ligjit Nr. 9693, datë 19.03.2007 “*Per fondin kullor*” i ndryshuar neni 17 shprehet “Dhenia ne perdorim e siperfaqes se kullotave dhe livadheve, në radhë të parë lejohet për ndërtime të përkohshme, si depo qendra të staneve, qendra të përpunimit të bulmetit, për mullinj, për shtëpi të përkohshme verimit për blegtorët, gjithnjë në përputhje me funksionin themelor të saj si kullotë. Sipërfaqe të caktuara dhe toka të fondit kullor, pronë shtetërore, mund të jepen në përdorim, për të zhvilluar ne to veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike.....

**Risi, përmirësim:** miratimi i ligjit Nr.111/2024, datë 31.10.2024 me të cili lejohet ushtrimi i veprimtarive që lidhen me prodhimin e energjisë së rinovueshme (prioritet i Qeverisë Shqiptare), fakt të cilin institucioni ynë e ka adresuar te Ministria e linjës.

## **PROÇESI I VERIFIKIMIT NË VEND**

Sektori juridik gjatë vitit 2025 ka kryer procesin e verifikimit në të gjitha NJQV sipas Urdhërit të Prefektit. Ky proces i ndihmon të gjitha palët për të korrigjuar gabimet qoftë në terminologji, qoftë kur keqinterpretohen kompetencat ligjore, e cila mund të vijë për shkak se jo çdo akt është azhurnuar plotësisht.

Ky proces ka qenë me riskt këtë vit për shkak të situatës së krijuar në sektor.

## **PROÇESET GJYQËSORE**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 “Për Prefektin”, ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i përditësuar, vazhdon të jetë pjesë e proceseve gjyqësore, kryesisht si palë e tretë.

Prefekti rezultoi palë e fituar sipas padisë së bërë nga Bashkia Pukë, meqë Prefekti nuk lejoi përdorimin e fondit të emergjencave për një familje në gjendje të rëndë financiare, jo sipas kritereve ligjore në fuqi.

## **VIT ZGJEDHOR**

**ZGJEDHJET:** Viti 2025 ishte vit zgjedhor. Zgjedhjet parlamentare u zhvillohen me datën 11 maj 2025. Referuar ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, i ndryshuar sipas nenit 94 është bërë propozimi pranë KQZ-së (si organ vendimarrës) e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut për vendet e numërimit të votave që përmbushin kushtet referuar nenit 93 pika 1 & 2 e Kodit Zgjedhor, duke pasur në konsideratë zgjedhjet e fundit.

Prefekti ka pas vëmendje të theksuar moslejimin apo mospërdorimin e fondeve publike gjatë periudhës zgjedhore në respekt të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 5, gërma “d” e ligjit Nr.68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, me përjashtim të rasteve të përlligjura.

## **OBJEKTIVAT 2026**

Gjatë shqyrtimit të akteve normative për 2026 do të vazhdojmë ti referohemi vetëm parimeve të rëndësishme në zbatim të shtetit të së drejtës:

- ligjshmërisë
- mbrojtjes së interesit publik
- barazisë dhe proporcionalitetit
- drejtësisë dhe paanësisë,
- bashkëpunimit dhe të përgjegjshmërisë,
- eficiensës
- të sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit

**Evidencë e verifikimit të Ligjshmërisë së Aktet Normative  
të Organeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Janar-Dhjetor 2025**

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve te organeve te njësive të vetëqeverisjes vendore						
NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE	Akte të hyra në Institucionin e Prefektit		Të bazuara ne ligj		Jashte objektit te shqyrtimit	
		Progr.		Progr.		Progr.
Këshilli i Qarkut		17		17		0
Bashkia Shkodër		75		75		0
Bashkia Vau Dejës		55		50		5
Bashkia Puke		39		37		2
Bashkia Fushë Arrëz		41		38		3
Bashkia Malesi e Madhe		50		46		4
<b>Totali</b>		<b>277</b>		<b>263</b>		<b>14</b>

**V.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor**

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organeve të tyre. Njësive të vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjore (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve; U është rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë organizuar takime të shumta për: Zhvillimin e territorit; Menaxhimin e mbetjeve; Mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën e rendit dhe qetësisë publike; Përballimin e situatave emergjente; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e garantimit të sigurisë ushqimore; Përmirësimi i shërbimit shëndetësor, të furnizimit me energji elektrike e ujë të pijshëm; Krijimi i kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, përfshirë sigurimin e ngrohjes në shkolla dhe sigurinë në shkolla; etj.

## **VI. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE**

### **VI.1. Shërbimet sociale**

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, janë realizuar kontrolle mbi zbatimin e legjislacionit dhe pagesve për Ndhimën Ekonomike dhe Personat me aftësi të kufizuar në njësitë vendore të qarkut Shkodër. Për vitin 2025 në lidhje me NE janë realizuar 7 kontrolle të plota dhe 10 kontrolle tematike (sipas orientimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH). Për PAK janë realizuar 16 kontrolle të plota.

Gjatë vitit 2025 në qarkun e Shkodrës janë regjistruar 46,171 aplikime për përfitimin e NE, ndërkohë në vitin 2024 janë regjistruar 49,313 aplikime dhe për vitin 2023 janë regjistruar 51,859 aplikime. Po të bejmë një krahasim shohim që për vitin 2025 janë bërë 3142 aplikime më pak se në vitin 2024 (ose 6.4% më pak), ndërsa gjatë vitit 2024 janë 2546 familje përfituese më pak se në vitin 2023 (ose 5% më pak).

Gjatë vitit 2025 në Qarkun Shkodër kemi një ulje të fondit të shpërndarë me 83,019,390 lekë më pak se në vitin 2024 (ose 18% më pak), ndërsa gjatë vitit 2024 kemi një rritje të fondit të shpërndarë me 59,286,330 lekë më shumë se në vitin 2023 (ose 12.8% më shumë). Gjatë vitit 2025 në Qarkun Shkodër janë 3953 familje përfituese të NE më pak se në vitin 2024 (ose 8.4% më pak), ndërsa gjatë vitit 2024 janë 1831 familje përfituese më pak se në vitin 2023 (ose 3.8% më pak).

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nëpërmjet inspektimeve të ushtruara në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe verifikimeve në familje, për numrin e rasteve të trajtuara në shkelje të ligjit, ka një administrim dhe mirë menaxhim të fondeve të buxhetit për shtresat në nevojë

Janë shqyrtuar, duke kthyer përgjigje 23 kerkesë/ankesa të ardhura nga qytetar, nëpërmjet platformës së bashkëqeverisjes, SHSSH, avokatit të populli, bashkitë dhe qytetarët.

Gjatë vitit 2025 DRSHSSH Shkodër në bashkëpunim me Shoqatën The DOOR, ka shpërndarë 672 personave me PAK paisje të ndryshme ndihmëse dhe mjete lëvizëse, gjithashtu janë shpërndarë 597 kuti me ndihma materiale, konkretisht:

- veshje + këpucë – 362 kuti në familje në nevojë në Qarkun Shkodër, si dhe për fëmijët e shoqatës së jetimëve
- kuti krishlindjesh me veshje-67 kuti në kopeshtin Xixëlloja, shkollen Liria dhe 3 familje në vështirësi ekonomike.
- Dyshek për personat me aftësi të kufizuar – 168 në familje me persona me PAK.

Në kryerjen e veprimtarisë gjatë vitit është bashkëpunuar me subjekte publike e jo publike; Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrveshjeve të bashkëpunimit; DR të AKPA; QOFPP; DRAP Lezhë; ISHPSHSH; Shoqatën “The Door”, Qendren YEA, YËCA of Albania, “Motrat e Nënë Terezës”, “Projekti Shpresa”, Caritas Dioqezan, “Madonina del Grappa”, “Komunitetit

Papa Xhovani XXIII”, “Vëllezrit e Nënë Terezës” e Shoqata të tjera, të cilat zhvillojnë aktivitetit e tyre në qark.

## VI.2. Zhvillimi i territorit

Për zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur probleme të ndryshme të territorit si strehimi, pronësie dhe mjedisi. Jane ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara për zbatimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë e qarkut, duke rekomanduar bashkërendimin e punës në të gjitha etapat me qëllim zbatimin sa më eficient të ketyre planeve, në përputhje me ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zvillimin e teritorit”. zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, shqyrtimi i ndërtimeve pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi, probleme me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse, si rezultat i aktiviteteve tregtare. Janë shqyrtuar vendimet e organeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore në fushën e ndërtimit dhe burimeve ujore. Po kështu është kërkuar nga bashkitë në bashkëpunim me policinë vendore dhe institucionet e tjera, të kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme i gjithë territori i Qarkut Shkodër, sipas njësisive administrative dhe fshatrave, për parandalimin e çdo paligjshmërie në zënien dhe përdorimin e territorit, hedhjen e mbeturinave, shfrytëzimin e shtretërve të lumenjeve, mbrojtjen e pyjeve e sidomos në zonat e mbrojtura. janë realizuar mbledhjet e komitetit teknik të zonave të mbrojtura Po ndiqet dhe po mbeshetet puna e Task-Forcës për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike të dëmshme, Kemi marrë pjesë në grupin Ndërinstitucional për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025. Puna e këtij grupi është fokusuar kryesisht në plazhin e Velipojës ku janë organizuar disa takime me institucionet perkatëse për kontrollin në terren.

Është bërë konfirmimi i genplaneve për objektet si më poshtë:

- Genplani të objektit, “Ish-Hoteli i Ushtarakeve”, Puke.
- Objekti nr.1 me emertim ish- bar kafe, ish- dyqan veshmbathje, ish- dyqan ushqimor – Theth
- Objekti nr.2 me emertim ish- zyra e administrimit -Theth
- Objekti nr.3 me emertim ish magazinë për Rezervat Dimërore - Theth
- Objekti nr.4 me emertim ish -Pika e Grumbullimit të Bimeve Medicinale - Theth

Kemi marrë pjesë në disa projekte si ai për kalimin e liqenit të Shkodrës si rezervë biosferë në mbrojtjen e UNESCO. Me GIZ kemi marrë pjesë në takimet e organizuara në kuadrin e projektit për një system të sinjalizimit të hershëm për mbrojtjen rreziqet natyrore.

Po ashtu kemi qenë pjesë e takimeve të organizuara nga Instituti i Ndërtimit dhe AKMC për marrjen e masave për vlerësimin e qëndrueshmërisë së ndërtesave menjëher pas tërmeteve.

Në bashkëpunim me adzm janë organizuar mbledhjet e Komitetit Teknik të zonave të mbrojtura Në bashkëpunim me ZABU janë organizuar mbledhjet e Këshillit të basenit Drin Bunë

### VI.3. Zhvillimi i turizmit (*sezoni turistik Maj-Nëntor*)

Kontributin më të madh në mirëqënien ekonomike në nivel qarku, vazhdon ta ketë sektori turistik, i cili edhe këtë vit shënon një rritje gjatë 9-mujorit të parë krahasuar me vitet paraardhëse.

Sezoni turistik 2025, ka shënuar një sukses në këndvështrimin e menaxhimit të sektorit të turizmit, i cili ka ardhur edhe falë masave të qeverisë për kryerjen e investimeve publike dhe orfrimin e shërbimeve në destinacioniut turistike

Objektivat e sezonit turistik veror 2025, të parashikuara në politikat rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm, ashtu edhe në ato në nivel strategjie sektoriale, megjithë problematikat e hasura, në tërësinë e tyre janë tejkaluar;

Kështu, gjatë sezonit është:

- Garantuar siguria publike në zonat turistike. Është ruajtur qetësia dhe rendi, janë parandaluar aktet kriminale; Është mirëmenaxhuar trafiku, duke garantuar sigurinë rrugore; Si rezultat i kontrolleve dhe masave të marra ka patur një menaxhim të mirë të mjeteve ujore, duke mos shënuar asnjë problem; Janë marrë masa parandaluese ndaj zhurmave, duke eliminuar ndotjen akustike dhe duke krijuar qetësi tek pushuesit; Ka patur një menaxhim më të mirë dhe përpunim të shpejtë të turistëve dhe mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar.
- Nga shërbimet policore të DVP Shkodër, në mënyrë të pandërprerë, janë kryer kontrole në lokalet e natës duke motitoruar respektimin e orarit të përcaktuar për mbylljen e aktivitetit dhe të muzikës gjatë orëve të vona të mbrëmjes, ku janë kontrolluar me pajisjet matëse të ndotjes akustike, dhe nuk është konstatuar asnjë rast i ndotjes akustike. Rëndësi i është kushtuar ndjekjes së telefonatave të ardhura nga komuniteti, ku gjatë kësaj periudhës ka patur edhe **142 telefonata** nga turistët e huaj, me kërkesën për ndihmë apo për humbje personash dhe shërbimet e DVP-së janë përgjigjur menjëherë, duke afruar shërbimin policor në kohë.
- Rritur numri i turistëve vendas dhe të huaj të cilët vizitojnë destinacionet turistike në qark, për rrjedhojë janë rritur të ardhurat nga turizmi. Është rritur numri i subjekteve (të regjistruar në organet tatimore) që ushtrojnë veprimtari biznesi dhe numri i të punësuarve. Nga të dhënat tatimore, raportohet se një numër i konsiderueshëm i subjekteve akomoduese në qark, kanë bërë deklarinimin për kapacitetin dhe nivelin e shfrytëzueshmërisë për vitin 2025, bazuar në VKM Nr.160, dt.12.03.2025 “Për përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit të nivelit minimal të kapacitetit të shfrytëzimit të strukturave akomoduese”
- Ka një përmirësim të ndjeshëm të nivelit të bashkëpunimit dhe veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive për këtë sektor;
- Është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendrat shëndetësore me personelin e duhur, por duke qëndruar në gatishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike; NJVKSH Shkodër, duke filluar nga data 01.06.2025 ka monitoruar aktivitetin e Qendrave Shëndetësore verore (Velipojë, Rrjoll dhe Theth) çdo javë (2 herë në javë). Përveç monitorimeve fizike është bërë komunikimi i vazhdueshëm çdo ditë me telefon me personelin e QSH Verore mbi mbarëvajtjen dhe problematikat gjatë procesit të punës. Sigurimin

dhe prezencën gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve të sinjalistikës orientuese, afishimin e numrave të emergjencës dhe të masave parandaluese për kontrollet e infeksioneve.

- Personeli shëndetësor i Qëndrave Shëndetësore verore, ka qënë gjithmonë prezent në vendin e punës çdo herë që janë kryer monitorime.
- Qendra Shëndetësore është e pajisur me sinjalistikën orientuese, numri i urgjencës i afishuar në hyrje të QSH.
- Kushtet higjieno-sanitare të QSH janë të mira dhe janë marrë të gjitha masat për parandalimin e infeksioneve. Vendi i punës i paster dhe i rregullt.
- Jane furnizuar të treja QSH Verore me rapid teste.
- Jane pasqyruar në regjister të gjitha vizitat
- Raportimi javor është realizuar në kohë

Respektimin e orareve/grafikët të përcaktuar të shërbimeve të stafeve Mjek/Infermier si dhe stafit ndihmës të punësuar pranë QSH-re/Pikave. Oraret dhe grafiku i shërbimit të stafit mjekësor është respektuar. Grafiku javor i shërbimit është i afishuar në vend të dukshëm në të tre QSH Verore.

➤ Është përmirësuar infrastruktura rrugore drejt zonave turistike, përfshi edhe vendosjen e sinjalistikës. Nga ana e ARRSH janë kryer ndërhyrje për rikonstrukcione të pjesshme dhe mirëmbajtja e akseve rrugore me destinacion turizmin; Konkretisht në aksin “Shkodër-Velipoje” janë kryer punime rehabilituese si: riveshje me shtresa asfaltike, rinfreskim i sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Në aksin “Qafë Mali-Fierzë”, krahas mirëmbajtjes rutinë janë kryer po ashtu punime rehabilituese, riveshje asfaltike, ndërtim muresh mbajtëse dhe pritëse. Në mirëmbajtjen rutinë, në të gjitha akset, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pjesës së vegjetacionit, nivelimit të bankinave, etj.

➤ Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të shpejtë në lëvizjen e shtetasve të huaj e shqiptar (hyrje e dalje) në pikat e kalimit kufitar (Muriqan, Hani i Hotit, Grabom dhe Vermosh) si dhe për përdorimin e mjeteve motorike lundruese argëtuese (*Si rezultat i masave të marra nga shërbimet e policisë kufitare, në stacionet e plazhit, nuk është shënuar asnjë incident nga mjetet lundruese argëtuese*); po ashtu janë marrë masa për kontrollin e të gjithë vijës bregdetare të plazhit te Velipojës, Baks-Rrjoll dhe Shirokë, me shërbime shtesë; janë bërë patrullime të vazhdueshme me mjetet lëndruese të DVKM Shkodër dhe sa herë që janë hasur veprime që klasifikohen kundravajtje administrative, janë marre dhe masat përkatëse.

➤ Nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, gjatë sezonit turistik janë kryer **1.041** inspektime nga ku **599 inspektime** sipas planit të sezonit turistik dhe **442** inspektime jashtë planit të sezonit turistik (biznese të reja). Inspektimet dhe kontrollet, kanë patur për qëllim zbatimin e detyrimeve ligjore, në plotësimin e kushteve dhe standardeve ushqimore, si dhe mbrojtjen e konsumatorit; Nga inspektimet e realizuara janë marrë 4 masa adminsitartive “Paralajmërim”, **32 Gjoha** me vlerë totale **3.050.000 lekë** dhe 23 raste bllokim.

➤ Nga ana e organeve tatimore janë marrë masa kundër informalitetit, goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike. Janë dërguar emaile informues dhe telefonuar **340 biznese** të regjistruara rishtazi. Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet turistik, të tilla si, struktura

akomoduese, bar-restorante, guida turistike, kampingje, etj., është **522 subjekte**, me një qarkullim total të këtyre strukturave prej **624.320 mijë lekë**.

➤ Nga ana e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, në zbatim të plan-veprimit për menaxhimin e sezonit turistik 2025, janë inspektua subjekte akomoduese, qendra shëndetësore (përfshire ato në zonat turistike) si dhe subjekte të lidhura me ofrimin e shërbimeve turistike (pishina, etj)

➤ Nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes energjisë elektrike dhe Sh.A Ujësjellës-Kanalizime, nëpërmjet masave të marra është siguruar furnizim pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë sezonit; (*në plazhin e Velipojës, furnizimi me ujë të pishëm është siguruar nga ora 06.00-23.00*)

### **Nga ana e Prefektit të qarkut, në cilësinë e drejtuesit të KRZHT;**

➤ Është ngritur Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, mbështetur në pikën 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin” dhe Udhëzimin Nr. 8502 datë 24.10.2016 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” (pika 2.1, 2.2, 2.3 e kap. II), Komiteti i cili drejtohet nga Prefekti dhe ka në përbërje përfaqësuesit e institucioneve dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore

➤ Është hartuar e miratuar plani i veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025” (Urdhëri i Prefektit Nr.41, dt.29.05.2025) duke u mbështetur në planet e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë turistike

➤ Është organizuar takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, në të cilën janë ftuar të gjithë drejtuesit e Institucioneve dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, takim në të cilin është analizuar dhe vlerësuar veprimtaria e Komitetit dhe Institucioneve dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, problemet e hasura gjatë sezonit të kaluar si dhe rekomandimet për sezonin në vazhdim.

➤ Është ngritur grupi ndër-institucional për monitorimin e plani-veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2025”, si dhe janë zhvilluar takime me qëllim analizimin dhe zbatimin e masave të marra nga institucionet sipas plan-veprimit.

➤ Është bërë hapja zyrtare e sezonit turistik (Në bashkinë Shkodër, Në bashkinë Malësi e Madhe; Në bashkinë Vau i Dejës, Në bashkinë Pukë, Në bashkinë Fushë-Arrëz, në promovimin e vlerave në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit). Është publikuar kalendari i festave lokale dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme të qarkut, sipas njësisive të vetëqeverisjes vendore. Janë ngritur strukturat menaxhuese të dedikuara për sektorin e turizmit.

➤ Në funksion të menaxhimit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik veror, zhvillimit të këtij sektori me peshë të konsiderueshme në rritjen ekonomike, janë organizuar takime të herëpashershme me drejtuesit e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe për raste të konstatimit të problemeve, takime me drejtues të

atyre institucioneve në të cilat janë shfaqur, për zgjidhjen e tyre

➤ Nga ana e Prefektit, është monitoruar dhe koordinuar veprimtaria e Bashkive, Institucioneve Shtetërore Rajonale, Agjencive dhe Inspektorateve për zbatimin e plan veprimit dhe detyrimeve ligjore, sipas fushave dhe përgjegjësi, për mbarëvajtjen e sezonit turistik;

➤ Kanë funksionuar gjatë gjithë sezonit, zyrat e informacionit turistik në Shkodër, Velipojë dhe Theth, duke i shërbyer si vizitorëve, ashtu edhe marketingut të destinacioneve turistike.

➤ Është bërë promovimi i destinacioneve, ofertave turistike nëpërmjet organizimit të panairove dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe të traditës, sipas bashkive dhe njësive administrative të këtyre bashkive

➤ Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përgjate gjithë kohëzgjatjes së sezonit, ka qenë i angazhuar në largimin e strukturave ndërtimore të vendosura në mënyrë të plaigjshme, si në territor (tokë), ashtu edhe në brigjet e lumenjve/liqenit, në bashkëpunim me IKMT Qendër. Gjate muajit Korrik 2025 dhe më pas, në një aksion të koordinuar nga Drejtoria Qëndrore, ka patur ndërhyrje për prishjen e ndërtimeve pa leje në Parkun Kombëtar të Thethit (bashkia Shkodër).

➤ Në funksion të mbarëvajtjes dhe zhvillimit të turizmit, në zonat e mbrojtura të qarkut:

- Janë vendosur tetë tabela informuese dhe tre tabela orinetuese në Bogë, Theth, pjesë e Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” si dhe në Shalë, pjesë e Parkut Natyror “Lugina e Shalës” të financuar nga VIS Albania të cilat ju vijnë në ndihmë vizitorëve turistëve dhe vizitorëve.
- Po ashtu, Organizata PONT ka financuar tre tabela informuese në Theth, pjesë e Parkut Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” të cilat ju vijnë në ndihmë vizitorëve turistëve dhe vizitorëve.
- Është bërë rikonstrukcion i jashtëm i godinës së Info Point (Theth) financuar nga Fondi Shqipëtar i Zhvillimit.
- Është financuar nga Bashkimi Europian pajisja pastrimit për pastrimin e Liqenit të Shkodrës, konkretisht në zonën e Shirokës e cila do të shërbejë për mbajtjen pastër të mjedisit ujor dhe mos përhapjen e barërave të këqinj apo vegjetacionit ujor, duke ruajtur kështu parametrat cilësore të ujit.
- Organizata PONT ka punësuar punonjës (si kordiantor, roje mjedisore, etj) me afat 1- vjeçar për Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”.

➤ **Gjatë Sezonit 2025:**

- Nga pikat kufitare të Qarkut, të dhënat statistikore vetëm gjatë muajit Qershor 2025, paraqiten si më poshtë:

<i>Hyrje Shtetas te huaj</i>	184.696 shtetas
<i>Dalje Shetas te Huaj</i>	171.330 shtetas
<i>Hyrje shtetas Shqiptare</i>	69.488 shtetas
<i>Dalje Shtetas Shqiptare</i>	70.709 shtetas

- Numri i vizitorëve në kalanë “*Rozafa*” **gjatë sezonit** ka qenë mbi **131.090** vizitorë (vendas dhe të huaj), me një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2024, dhe 37% krahasuar me vitin 2023.
- Numri i vizitorëve në Muzeun Kombëtar të Fotografisë “*Marubi*” **gjatë sezonit** veror 2025 është **10.929** vizitorë, duke gjeneruar **8.607.220** lekë të ardhura
- Numri i vizitorëve në zonat e mbrojtura **gjatë sezonit** është:

Emërtimi i Zonës së Mbrojtur	Gjithsej	Vendas	Të huaj
Peisazhi Ujor Tokësor i Mbrojtur “Lumi Bunë - Velipojë”	377.160	243.930	133.230
Parku Kombëtar “Alpet e Shqipërisë”	519.190	299.690	5.3800
Rezervati Natyror i Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”	198.810	115630	83.180
Parku Natyror “Lugina e Shalës”	137.750	80.550	57.200
Parku Natyror i Munellës	795	505	290
<b>Totali</b>	<b>1.233.705</b>	<b>740.305</b>	<b>493.400</b>

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer **1.041 inspektime** e kontrole në terren (restorante, fastfoode, furra buke) në zonat turistike, si dhe nga laboratorit për mostra. Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara (*Tregtim në kushte të pa përshtatshme higjieno-sanitare; Mungesë e sistemit të gjurmueshmërisë së ushqimeve, etj.*) janë marrë **55 masa** administrative “Paralajmërim, për ndërprerje të aktivitetit; gjobë, etj.”.
- Nga ana e organeve tatimore, sipas planit operacional të punës, janë marrë masa, për goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike; si rezultat i të cilave janë regjistruar subjekte të reja, duke u aktivizuar me përgjegjesi tatimore TVSH subjekte, është rritur numri i të punësuarve persona dhe për rrjedhojë janë rritur të ardhurat gjatë sezonit turistik. Fokusi kryesor ka qënë komunikimi me bizneset që ushtrojnë aktivitetet si struktura akomoduese, për të bërë regjistrimet e të gjithë prenotimeve të kryera nëpërmjet platformave online si “Booking” dhe “AirBNB”.
- Nga ana e Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë kryer inspektimet

lidhur me zbatimin e kushteve higjieno-sanitare, inspektime mbi parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive dhe inspektime në Q.Sh për plotësimin e kushteve të shërbimit) dhe riinspektime; monitorime, për zbatimin e ligjit "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e duhanit" dhe "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit"; Në përfundim të të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara, janë marrë masa administrative (Gjobë)

- Nga ana e Inspektoratit shtetëror të punës dhe shërbimeve shoqërore janë ushtruar kontrolle **në 162 subjekte**; Nga kontrollet dhe inspektimet e ushtruara janë evidentuar **113 punëmarrës** informal, të cilët janë përfshinë menjëherë në skemen e sigurimeve shoqërore. Për shkeljet e konstatuara gjatë kontrolleve dhe inspektimeve, janë marrë masa urgjente në **19 subjekte** (Lidhur me marrë dhëniet e punës në 17 dhe sigurinë në punë 2), si dhe masa administrative (gjobë) në **5 raste me vlerë 2.840.000 lekë**
- Në 3 vitet e fundit Bashkia Shkodër ka përjetuar një transformim të jashtëzakonshëm në fushën e turizmit. Nga një potencial i njohur prej dekadash, gjatë vitit 2025 është kthyer në një realitet ekonomik dhe social që ndikon drejtpërdrejt në mirëqënien financiare të qytetarëve.





Të dhënat më të fundit janë të qarta dhe shumë domethënëse:

- Në vitin **2022** në bashkinë Shkodër u regjistruan rreth **264 mijë** netë akomodimi, ndërsa në vitin **2025 ky numër ka arritur rreth 560 mijë** – një dyfishim(+47%) brenda katër vitesh.
- Vetëm deri në fund të gushtit 2025, numri i netëve të qëndrimit ka tejkaluar shifrën e gjithë vitit 2024 së bashku.
- Kanë ushtruar veprimtarinë e biznesit gjatë sezonit **272 subjekte**, nga të cilat në zonën e Velipojës **195 subjekte**
- Të dhënat e INSTAT tregojnë se qarku i Shkodrës është ndër dy qarqet me përqindjen më të lartë të rritjes së bizneseve në turizëm në dy vitet e fundit, duke performuar më mirë se shumica e qarqeve të Shqipërisë.

Edhe pse një pjesë e këtij realiteti mbetet i pa-dokumentuar plotësisht për shkak të informalitetit ende të pranishëm, nuk ka asnjë dyshim se numri real i vizitorëve është edhe më i lartë. Po kështu, të dhënat mbi vizitat në sitet kulturore e muzeale konfirmojnë një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme.

Rritja turistike është e shpërndarë në të gjithë territorin, por me tipare të ndryshme sipas zonave:

- Velipoja mbetet gjeneratori kryesor i volumit, me një sezon të përqendruar në korrik-gusht, por tashmë me rritje të dukshme edhe në qershor dhe shtator.
- Thethi në Alpe ka përjetuar një zgjerim të jashtëzakonshëm, duke shumëfishuar netët e akomodimit falë aksesit më të mirë dhe promovimit ndërkombëtar.
- Qyteti i Shkodrës po kthehet në stabilizuesin e ekonomisë së turizmit: një aktivitet i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, me rritje të fortë në muajt e pranverës dhe të vjeshtës, falë rolit si qendër kulturore, ekonomike dhe portë hyrëse për bregdetin dhe Alpet.



### Probleme të hasura, me ndikim në mbarëvajtjen e sezonit turistik veror dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2025

- Mos zbatimi rigoroz i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit” (miratuar në VKM 649, datë 16.10.2024, me ndryshime), në stacionet e plazhit. (mungesa e bovave sinjalizuese, mungesa e rojeve bregdetare (de facto), mos respektimi i distancave ndërmjet çadrave dhe hapësirës nga bregu i detit, mos respektimi i vendosjes së koridoreve hyrese-dalese për mjetet lundruese sipas koordinatave të përcaktuara në hartën “për stacionet e plazhit”, devijimi nga perimetrat e sigurisë, interpretim jo i saktë i elementëve të hartës së miratuar për stacionet e plazhit, etj)
- Lidhja me vonesë e kontratave (në disa raste të evidentuara) për përdorimin e hapësirës publike nga ana e njësisve vendore me subjektet që do të ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të plazhit. Bazuar në VKM Nr.168, datë 12.03.2025, neni 14, pika 6, afati për depozitimin e dokumentacionit nga ana e subjekteve është brenda muajit Qershor 2025. Në zbatim të VKM 649, datë 16.10.2025, i ndryshuar, nei 7, pika 12, Prefekti i Qarkut ka kërkuar NjVV, kopje të

proçesverbaleve të dorëzimit të parcelave në përputhshmëri me kontratat e nënshkruar dhe hartën e miratuar.

- Mungesa e rojeve bregdetare (vrojtuesve të çertifikuar) dhe shërbimit të vrojtimit, mungesë që sjell probleme në kryerjen e shërbimit në të gjithë zonën e plazhit, me rrisht të sigurinë e pushuesve; Si dhe mungesa e kryerjes së shërbimit të vrojtimit (mungesa e vrojtuesve) në kohë dhe orë me numer të reduktuar pushuesish dhe jo gjatë gjithë kohës kur stacioni i plazhit është i hapur.
- Përcaktimi i zonës së notimit, konturimi me bova në një distancë 200 m.
- Mungesa e shenjave notuese në koridoret e lëvizjes së mjeteve lundruese argëtuese,
- Nevoja për përmirësim i shërbimit të transportit publik (orare të përcaktuara nisjeje) drejt dhe në pikën turistike Theth/Razëm/Velipoje, etj., problematikë edhe e sezoneve të kaluara për lëvizjen e turistëve të huaj dhe jo vetëm
- Ushtrimi i veprimtarisë nga agjenci me guida turistike të paliçensuara.
- Problematika e lypjes në rrugë.
- Ofrimi i standarteve në plazhet publike, veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik (Tabelizimi i të gjitha hapsirave publike, Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapsirave publike me vrojtues të certifikuar; Sigurimi i pastrimit të hapsirave publike; Pajisja e hapsirave publike me shërbime higjienike; Markimi i zonës së notimit) .
- Prezenca e shitësve ambulant në hapësirat në mes vijës ujore e stacioneve të plazhit.
- Prania e strukturave akomoduese, të cilat nuk janë të rregjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke krijuar kushte të pabarabarta të konkurrencës (apartamente në formën e AIR B&B)
- Mungesa e shërbimit të sigurisë fizike në site, për shkak të kostove të papërbalueshme nga institucionet përgjegjëse. Plotësimi me këtë shërbim, do i bënte sitet më të sigurt dhe të afta për të reaguar në kohë para problematikave të ndryshme që mund të shfaqen.
- Grupet turistike të cilat paraqiten pranë siteve të DRTK me guida të pa çertifikuara nga instancat shtetërore shqiptare.
- Mungesa e një parkingu të dedikuar për autobuzët, me rikualifikimet e nevojshme urbane, në pjesën e ulët të Parkut Arkeologjik Shkodër.
- Mungesa e shërbimit të tualeteve në të dy Parqet. Gjatë këtij sezoni, falë bashkëpunimit me Bashkinë Shkodër është bërë e mundur vendosje e disa tualeteve portative, zgjidhje që ngelet provizore, vetëm për periudhën e sezonit turistik.
- Sa i përket menaxhimit të mbetjeve, krahas plazhit të Velipojës në të cilin kanë operuar dy kontraktorë të alternuar në 24 orë shërbim, në zonat e tjera turistike ndeshen problematika. Në zonat e mbrojtura janë kontenierë për hedhjen e mbeturinave, por problem qëndron tek frekuenca e pastrimit të tyre, i cili është i rrallë, krahasuar me nevojën që kërkohet, si dhe shtimi i kontinierëve (edhe pse janë vendosur struktura druri që futen koshat brenda) aty ku mungojnë. AdZM ka ndërmarrë disa aktivitete pastrimi me qëllim jo vetëm sensibilizimin por edhe heqjen e sasive të konsiderueshme me mbetje në zonat e mbrojtura. Mbetjet urbane përbëjnë një tjetër problem të cilat në Zonën e Mbrojtur “Lugina e Shalës” nuk menaxhohet nga NjVV, ndërsa zonat Theth, Bogë, Kelmend kanë problem në frekuencën e ulët të tërheqjes së mbetjeve. Ka pika të nxehta dhe në RNM Liqeni i Shkodrës, PUTM Lumi Buna- Velipojë, etj.

- Mungesa e mbulimit me sinjal telefonik/internet në zonat e thella malore të qarkut Shkodër, gjë e cila vështirëson komunikimin me shtetasit vendas dhe të huaj, të cilët për shkaqe të ndryshme mund të kërkojnë ndihmën e policisë në zonat e thella malore.

### REKOMANDIME

- **Zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit”** (miratuar në VKM 649, datë 16.10.2024, me ndryshime), në stacionet e plazhit
- **Monitorim i vazhdueshëm i respektimit të kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren me qëllim garantimin e sigurisë fizike të pushesëve në plazhe.**
- **Përmiresim i ofrimi i shërbimit të transportit publik** drejt dhe në pikat turistike (Licensimin e subjekteve, nënshkrimin e marrëveshjeve për kryerjen e shërbimit, caktimi i stacioneve të nisje-mbërritjeve dhe kontaktet e tyre në vende të dukshme me tabela fizike dhe aksesueshëm në internet-faqet Eëb të Bashkisë Shkodër; AdZM Shkodër; Si dhe pranë zyrave të informacionit turistik etj. Si dhe vendosjen e orareve të nisjes);
- **Bashkëpunimi njëjësive vetëqverisjes vendore me institucionet qendrore** në marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi pasurinë në zonat turistike, në menyrë të veçantë në zonën turistike Theth, mbi ndikim në zhvillimin e turizmit dhe jo vetëm.
- **Marrjen e masave si dhe hartimin e një plan investimi** në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në plazhin e Velipojës për furnizimin me ujë të pishëm gjatë 24 orëve.
- **Kontrolle të vazhdueshme nga ana e NjVV dhe forcave të rendit**, dhe marrjen e masave kundër zënies së hapësirave publike dhe shfrytëzimin e tyre për qëllime përfitimi ekonomike (*parking me pagesë, etj*)
- **Krijimi i kushteve adequate të aksesueshmërisë në sitet arkeologjike** me frekuencë të lartë fluksesh turistike (parking, mbrojtje nga dielli pranë biletarive, etj.) si dhe ofrimi i shërbimeve higjieno-sanitare.
- **Mbulimi me sinjal telefonik në zonat e thella malore**, me qëllim gjurmueshmërinë e turistëve në rastet e devijimeve nga itineraret e përcaktuara apo fatkeqësite (*të ripërsëritura*)
- **Marrjen e masave nga ana e Drejtorisë Tatimore Rajonale, Hetimit Tatimor Rajoni Verior, DVP seksioni i Krimin Ekonomik dhe Bashkia Shkodër**, për goditjen e informalitetit dhe paligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së biznesit në zonën e plazhit Velipojë dhe në zonat e tjera turistike gjatë gjithë sezonit (Identifikimin dhe evidentimin e subjekteve private të parregjistruara dhe subjekteve të cilat kanë ndërprerë/pezulluar përkohësisht veprimtarinë, të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi; Evidentimin e detyrimeve tatimore dhe shlyerjen e tyre, nga subjektet që ushtrojnë veprimtari, pavarësisht nëse janë regjistruar apo jo, si dhe për ato të cilat e kanë të ndërprerë por vazhdojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre), si dhe strukturat akomoduese të cilat ushtrojnë aktivitet në informalitet të plotë nëpërmjet platformave të ndryshme (apartamente me qera ditore)
- **Gjurmimi i flukseve turistike**, mbajtja e regjistrave të standartizuar me të dhënat përkatëse, nga strukturat akomoduese, jo vetëm me qëllim garantimin e sigurisë fizike të pushesëve dhe detyrimeve ligjore, por edhe si një aset i çmuar statistikor.
- **Hartimi i strategjive rajonale/lokave të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit afatgjatë**, bazuar në strategjite kombëtare, me qëllim harmonizimin e politikave sektoriale dhe

bashkërendimin e punës ndër-institucionale dhe partneritetin me sektorin privat dhe atë akademik.

- **Krijimi i kushteve të përshtatshme/nënshkrimi i marrëveshjeve të përbashkëta ndërkombëtare**, në PKK gjatë sezonit turistik veror, por jo vetëm, me qëllim shmangien e rradhëve si pasoje e kohëzgjatjes së procesit të përpunimit të të dhënave në hyrje/dalje (*pikat hyrëse kufitare Hani Hotit dhe Muriqan*)

#### VI.4. Shërbimi i gjendjes civile

Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile ka grumbulluar, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar certifikata përkatëse (sipas kërkesave të shtetasve apo institucioneve të ndryshme), të gjendjes civile, për dokumentacionin që administrojnë vetë zyra, duke u bazuar në regjistrat themeltarë si dhe në aktet e tjera.

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësive administrative pjesë përbërëse e këtyre bashkive, duke bërë verifikimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme.

Është bashkëpunuar me zyrat e Gjendjes Civile të njësive të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave në shqyrtimin e kërkesave, për gabimet në regjistra dhe korrigjimin e tyre.

### VII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS

#### VII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër”, të ndryshuar me urdhrin nr.121 datë 17.07.2024), me një organikë prej 27 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i Përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi E Madhe Dhe Pukë)	2
4.	Spektori i Monitorimit Të Kompetencave Vendore Dhe Funksioneve Të Deleguara	6
5.	Spektori i Zhvillimit Urban	3

Prefekti i Qarkut Shkodër  
Raport për veprimtarinë e kryer gjatë vitit 2025

6.	Sektori i Planifikimit, Përballimit Të Emergjencave Civile Dhe Krizave	3
7.	Sektori Juridik	3
8.	Sektori i Financës Dhe Shërbimeve Mbështetëse	7

Gjendjet civile Shkoder, Malësi e madhe e Pukë nga 1 përgjegjës secila.

Për gjatë gjithë vitit 2025, administrata ka pasur ndryshime në funksionimin e saj. Është larguar sekretari i përgjithshëm me dorëheqje. Në këto momente pozicioni SP është në faza zhvillimi me DAP. Po ashtu janë larguar po me dorëheqje specialisti i sektorit juridik dhe specialistja e sektorit të monitorimit. Akoma nuk kemi të shpallura procedura rekrutimi për to nga DAP. Nga ana tjetër përgjegjësi i sektorit të emergjencave civile ka dalë në pension që në muajin prill 2025. Procedura e rekrutimit është mbyllur pa fitues.

Buxheti i institucionit të Prefektit Qarku Shkodër është një buxhet simbolik, ku pothuajse pjesa më e madhe e tij shkon për shpenzime personeli dhe shpenzime utilitare. Investimet e vitit 2025 kanë qenë 1 milion lek. Të detajuara për blerje kompjuterash e printerash- , blerje kondicionerë Buxheti total për të dy programet (1160 dhe 1170) për vitin 2025 ka qenë: 53,454,310 lek nga i cili 90% i takon administratës së prefektit dhe 10% funksionit të deleguar të gjendjes civile.

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 38,271,636 lek për administratën e prefektit , ndërsa për zyrat e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 5,225,702 lekë.

Në total për të dy programet (1160 dhe 1170) për vitin 2025 janë shpenzuar 43,497,338 lek ose 81.4% e planit të përgjithshëm të buxhetuar.

Programimi dhe përdorimi i fondeve sipas programeve në nivel artikulli paraqitet si më poshtë:

**Evidenca e realizimit të shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2025**

Artikujt	Emertimi	Permbledh. e Programit Detajim viti 2025	Prefektura Shkoder Detajim viti 2025	Gjendja Civile Detajim viti 2025	progresivi financiar 31.12.2025	
					Prefektura	Gj.civile
600	Paga, shperblime dhe te tjera shp personeli	39,564,539	34,988,000	4,576,539	27,932,622	4,477,899
601	Kontribute per Sig Shoqerore dhe Shendetesore	6,560,571	5,760,000	800,571	4,623,435	747,803
602	Mallra dhe sherbime te tjera	6,135,000	6,135,000	0	4,669,279	0
602.0	Materiale dhe shërbime zyre dhe të përgjithshme	740,000	740,000	0	405,036	0
602.1	Materiale dhe shërbime speciale	210,000	210,000	0	184,900	0
602.2	Shërbime nga të tretet	2,680,000	2,680,000		2,443,381	0
602.3	Shpenz. transporti	1,425,000	1,425,000	0	1,052,842	0
602.4	Shpenz. udhëtimi	300,000	300,000	0	114,890	0
602.5	Shpenz. per mirembajtje te zakonshme	340,000	340,000	0	306,980	0
602.9	Shpenz. te tjera operative	440,000	440,000	0	161,250	0
606	Transferta për Buxhete Familjare dhe Individe	194,200	194,200		194,200	0
231	Inventar ekonomik	1,000,000	1,000,000		852,100	
	Totali	53,454,310	48,077,200	5,377,110	38,271,636	5,225,702

Plani i investimeve me ndryshime

Entiteti Qeveris	Min Linjes	Emer Institucioni	Kap	Llogaria Ekonomike	Kodi i D. Thesarit	Kod Projekti	Titulli I Projektit	Buxheti 2025	fakti 2025
001	16	Prefektura e Qarkut Shkoder	01	2310000	3333	18AS509	Pajisje kompjuterike dhe elektronike	555,680	488,980
001	16	Prefektura e Qarkut Shkoder	01	2310000	3333	18AS509	Orendi zyre	184,320	184,320
001	16	Prefektura e Qarkut Shkoder	01	2310000	3333	18AS509	Blerje kondicionerere	260,000	178,800
							totali	1,000,000	852,100

## VII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisje vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga Prefekti janë nxjerrë **90 Urdhra**, me problematika të ndyshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara.

Administrata ka zbatuar në të gjitha rastet urdhërat e nxjerrë, duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

## VII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë

### Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësive nga ana e prefektit janë zhvilluar rreth **22 takime** të cilat në formë të përmbledhur, sipas çështjeve të trajtuara, paraqiten:

- Takim i komitetit të Zonave të Mbrojtura Qarku Shkodër Analiza vjetore e institucionit të Prefektit Shkodër
- Mbi analizën vjetore të Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkoder. Gjatë prezantimit të analizës vjetore u raportua mbi punën e institucioneve vendore të qarkut Shkoder si dhe të 5 bashkive.
- Takimi i Taskë Forces Anti Cannabis për Qarkun Shkodër. Paraqitja e rezultateve të deritanishme dhe masat prandaluese në vazhdim.
- Mbledhja e Këshillit të Bazenit Drin-Buna
- Takim me teme mbi zbatimin e detyrimeve që dalin nga Paketa e Sigurisë në Shkollë për Qarkun Shkodër.
- Takimi i Komitetit Antrafikim i Qënieve Njerzore për Qarkun Shkodër

- Takimi i komisionit të Emergjenceve Civile të qarkut Shkodër “përmbledhje e situatës së kaluar vjeshte-dimër 2024-2025 dhe marrjen e masave për përballimin e situatave të pritshme të zjarreve për verën 2025 .
- Takim me teme “mbi bashkëpunimin e shoqatës Gruja tek Gruaja me disa bashki të qarkut Shkodër.
- Takim me teme “Mbi marrjen e masave për përballimin e sezonit të zjarreve 2025. KMC ne qarkun Shkodër
- Takim i Këshillit Konsultativ Trepalës për qarkun Shkodër
- Takim mbi marrjen e masave parandaluese të sëmundjes së murtajes së Ruminantëve të Vegjël.
- Mbledhja e Këshillit të Bazenit Drin-Buna.
- Takim i Komisionit të Mbrojtjes Civile në Qarkun Shkodër për analizimin e situatës së zjarreve në qarkun Shkodër.
- Takimi mbi marrjen e masave për fillimin e vitit shkollor 2025-2026 të sistemit parauniversitar në Qarkun Shkodër .
- Takim mbi njohjen dhe zbatimin e ligjit mbi bashkëpronësisë dhe ashensoret në pallate.
- Takim i Komitetit Antritrafikim i Qënieve Njerzore për Qarkun Shkodër .
- Takim i rradhës i Këshillit Konsultativ Trepalës për qarkun Shkodër.
- Takim i Komisionit të Mbrojtjes Civile në Qarkun Shkodër mbi marrjen e masave për sezonin vjeshtë- dimër 2025-2026 .
- Takim i Komitetit Antritrafikim i Qënieve Njerzore për Qarkun Shkodër .
- Takim i Komisionit të Mbrojtjes Civile në Qarkun Shkodër pas rreshje të diteve të fundit dhe problematikave të krijuar në disa bashki të qarkut Shkodër.
- Takim mbi problematikën e gurores në fshatin Domën NjA. Postrisë, bashkia Postrisë.
- Takim mbi zbatimin e detyrimeve që dalin nga Paketa e Sigurisë në Shkollë për Qarkun Shkodër. Shqyrtimi i rastit shkollës “Shejnaze Juka”
- Takime periodike të Prefektit me drejtues të Bashkive dhe të Institucioneve Vendore që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e bashkisë si dhe drejtues e përfaqësues të institucioneve rajonal lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore sipas fushave të përgjegjësisë e kryerjen e detyrave të përbashkëta për realizimin e programit dhe objektivave të qeverisë, ofrimin dhe rritjen e nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve dhe përmirsimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës së tyre

#### **VII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve**

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë vitit 2025 në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje **79 kërkesa** dhe ankesa të qytetarëve, të cilat sipas problematikës paraqiten:

- Për çështje në lidhje me vendimet e këshillave bashkiak 8;
- Per emergjencat civile 5;
- Për gjendjen civile 20;

- Për prona 15;
- Për probleme me mjedisin 7;
- Të tjera (punësim, praktike, page dhe takime) 24;

#### **VII.5. Veprimtaria e N/Prefektit**

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e qarkut*”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka ushtruar detyrat funksionale, përcaktuar në detyrat e administratës së Prefektit (miratuar me Urdhrin Nr. 21, datë 05.02.2025, të Kryeministrit) dhe në Rregulloren Organizative të Brendshme të Institucionit, Kështu;

Ka bashkëpunuar me institucionet qendrore në nivel vendor, duke kërkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre,;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre institucioneve me bashkitë, janë organizuar takime gjatë vitit, sipas problemeve të dala; përballimin e situatave të emergjencave të krijuar nga reshjet gjatë periudhës dimrit dhe nga zjarret gjatë periudhës verore; mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, menaxhimin e mbetjeve, etj.

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre;

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punjonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe Nj.A pjesë përbërëse e bashkive (Malësi e Madhe; Pukë dhe Fushë Arrëz), si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve;

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

### **VIII. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT**

a. Shqyrtimi i masave administrative plotësuese, për kundravajtjet administrative, të leje të drejtimit të shtetasve të huaj

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “*Për Kundravajtjet Administrative*”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “*Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor*”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë në 3 raste, duke marrë vendimet përkatëse.

b. Legalizimi i dokumentëve për përdorim jashtë vendit  
Mbështetur në aktet ligjore e nënligjore dhe në zbatim të Urdhrit të Prefektit gjatë vitit është

bërë legalizimi (vërtetimi) i 5971 dokumentëve (Nga sektori i Shërbimeve Mbështetëse 5540, nga N/Prefekti Malësi e Madhe 283 dhe N/Prefekti Pukë 148), të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (Çertifikatë, Vërtetim), për përdorim jashtë vendit, me një rënie të ndjeshme nga vitet e kaluara që ka ardhur si rezultat e marrjes së shërbimit online nëpërmjet portalit e-albania.

c. Projekte të financuara

Prefekti i Qarkut Shkodër, gjatë vitit 2025, ka marrë angazhime si Partner i Asociuar në 2 projekte të financuara nga donatorë të huaj, të cilët kanë si objektiv të përbashkët përmirësimin e mjedisit dhe mirëqënies sociale të territorit dhe banorëve të qarkut Shkodër.

Po ashtu, në kuadër të thirrjeve IPA dhe INTERREG, të financuara nga BE, institucioni ka aplikuar sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi, me qëllim përthithjen e fondeve dhe kontribuimin në përmirësimin e infrastrukturës logjistike të ekipeve të mënaxhimit të Emergjencave Civile, sikurse ngritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë. Gjithashtu, zhvillimi i produkteve inovative në fushën e turizimit kanë qënë prioritet I aplikimeve të sipërcituara.

## IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

Në kuadrin e reformës së qeverisë në administratën publike, ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qënë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

**1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku** (*Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit*)

**2. Përballimi i situatave emergjente** të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, apo nga faktor të tjerë (*Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente*)

**3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale**, i fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën, si dhe sigurimi i rendit publik (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese*)

**4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve**, nëpërmjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (*Bashkëpunimin dhe koordinimi i punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim*)

**5. Pastrimi i territorit të qarkut**, sipas njësisve të vetëqeverisjes vendore, nga mbetjet dhe krijimi i një mjedisi të pastër (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile, shoqata mjedisore*)

**6. Zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit”** (miratuar në VKM 649, datë 16.10.2024, me ndryshime), në stacionet e plazhit

**7. Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të transportit publik** drejt dhe në pikat turistike (*Licensimin e subjekteve, nënshkrimin e marrëveshjeve për kryerjen e shërbimit, caktimi i stacioneve të nisje-mbërritjeve dhe kontaktet e tyre në vende të dukshme me tabela fizike dhe aksesueshëm në internet-faqet Eëb të Bashkisë Shkodër; AdZM Shkodër; Si dhe pranë zyrave të informacionit turistik etj. Si dhe vendosjen e orareve të nisjes*);

**8. Garantimi i sigurisë publike dhe pastërtisë në zonat turistike**, marrjen e masave si dhe hartimin e një plan investimi në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në plazhin e Velipojës për furnizimin me ujë të pishëm gjatë 24 orëve.

**9. Ngritja dhe funksionimi në të gjitha NJVV-te e qarkut e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike**, sipas detyrimeve ligjore të parashikuara në VKM Nr.678, dt.30.10.2024 “Për Përbërjen, Rregullat Më Të Hollësishme Të Organizimit Dhe Funksionimit Të Këshillave Vendorë Të Sigurisë Publike Dhe Këshillit Kombëtar Për Sigurinë Në Komunitet”. Në këtë kontekst, roli koordinues dhe mbikëqyrës i institucionit të Prefektit do të vijojë të orientohet drejt monitorimit sistematik të ecurisë së KVSP-ve, ofrimit të asistencës institucionale dhe nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet strukturave vendore dhe atyre qendrore, me synim konsolidimin e një sistemi efektiv, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sigurisë publike në nivel qarku.

## X. BAZA LIGJORE

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit” me ndryshime
- Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës

*së Shqipërisë”*

- Ligjin Nr. 9131, date 08.09.2003 “*Per rregullat e etikes se administrates publike*”
- Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”
- Ligjin Nr.9970, datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”
- Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003 “*Per arkivat*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”
- Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008 “*Për Proçedurat Tatimore në RSh*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9632 datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “*Për inspektimin financiar publik*”
- Ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr.9482, datë 06.02.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “*Për mbrojtjen e biodiversitetit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “*Për mbrojtjen e mjedisit*”
- Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “*Për lejet e mjedisit*”
- Ligjin Nr.10463 datë 22.09.2011 “*Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 57/2020 “*Për Pyjet*”;
- Ligjin Nr.10 120, datë 23.4.2009, “*Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore*”;
- Ligjin nr. 5/2016 “*Për shpalljen e Moratoriumit në pyje*”;
- Ligjin Nr. 45/2019 “*Për mbrojtjen Civile*”;
- Ligjin Nr. 10129 date 11.05.2009 “*Per gjendjen civile*”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 8951 datë 10.10.2002 “*Për numrin personal të shtetasve*”, me ndryshime;

- Ligjin Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime;
- Ligjin nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;
- Ligjin Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Ligjin Nr. ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në R. Sh”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, me ndryshime;
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve;
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit